



Bashkimi Evropian
MISIONI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE

KOSOVË 2025

Raporti përfundimtar

Zgjedhjet Parlamentare

9 shkurt 2025



Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
KOSOVË* 2025
ZGJEDHJET PARLAMENTARE

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

*“Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve janë të pavarura nga institucionet e Bashkimit Evropian.
Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht politikën dhe qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian.*

*Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me RKS KB 1244/1999 dhe mendimin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
II.	HYRJE	11
III.	KONTEKSTI POLITIK.....	12
IV.	ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË MËPARSHME TË EU EOM	13
V.	KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR.....	14
a.	Ligji për zgjedhjet	14
b.	Sistemi zgjedhor.....	15
VI.	ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	15
a.	Struktura dhe përbërja e administratës zgjedhore	15
b.	Administrimi i zgjedhjeve.....	18
c.	Aranzhime të veçanta të votimit	19
d.	Edukimi i votuesve.....	20
VII.	REGJISTRIMI I VOTUESVE	21
a.	E drejta për të votuar	21
b.	Procedurat e regjistrimit të votuesve.....	21
c.	Regjistrimi për votim jashtë Kosovës	23
VIII.	CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE DHE I KANDIDATËVE	23
a.	E drejta për të kandiduar	23
b.	Certifikimi i kandidatëve	24
IX.	AMBIENTI I FUSHATËS	25
X.	FINANCIMI I FUSHATËS.....	27
XI.	KONTESTET ZGJEDHORE.....	28
a.	Parashtresat dhe ankesat dhe forumet përkatëse	28
b.	Parashtresat dhe ankesat para zgjedhjeve	29
c.	Parashtresat dhe ankesat pas zgjedhjeve	29
d.	Veprat penale në lidhje me zgjedhjet.....	30
XII.	MEDIAT	30
a.	Mjedisi mediatik	31
b.	Korniza ligjore për media	32
c.	Gjetjet e monitorimit të mediave	34
XIII.	MEDIAT SOCIALE	35
a.	Ambienti në rrjetet sociale	35
b.	Korniza ligjore për mediat sociale	36

c.	Gjetjet e monitorimit të mediave sociale	36
XIV.	PJESËMARRJA E GRAVE	37
XV.	PJESËMARRJA E TË RINJVE	39
XVI.	PJESËMARRJA E KOMUNITETEVE JOSHUMICË.....	40
XVII.	PJESËMARRJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA.....	41
XVIII.	VËZHGESIT VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË.....	43
XIX.	VOTIMI, NUMËRIMI DHE TABELIMI I REZULTATEVE	43
a.	Hapja dhe votimi.....	44
b.	Mbyllja, numërimi dhe dorëzimi i materialit zgjedhor	45
c.	Verifikimi i rezultateve të subjekteve politike dhe numërimi i votave preferenciale	45
d.	Numërimi i votave nga jashtë Kosovës, të votimit me kusht dhe mobil	46
e.	Tabelimi dhe publikimi i rezultateve paraprake	47
XX.	REZULTATET DHE AMBIENTI PASZGJEDHOR.....	48
a.	Publikimi i rezultateve	48
b.	Ankesat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve	48
c.	Zhvillimet paszgjedhore.....	49
XXI.	REKOMANDIMET.....	51
XXII.	ANEKSI 1 – REZULTATET E ZGJEDHJEVE.....	74
XXIII.	ANEKSI 2 – REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE	75
XXIV.	ANEKSI 3 – REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE SOCIALE	86

LISTA E SHKURTESAVE

AAK-NISMA	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – Nisma Socialdemokrate
AGK	Asociacioni i Gazetarët të Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
DLDI	Departamenti i Lëshimit të Dokumenteve të Identifikimit
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
EOM	Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
BE	Bashkimi Evropian
GINP	Nisma Qytetare Drejtësi Kombëtare
ICCPR	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
IRDK	Iniciativa e Re Demokratike për Kosovën
JGP	Partia Unike Gorane
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KDTP	Partia Demokratike e Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LFPP	Ligji për Financimin e Subjekteve Politike
LZP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
LKPM	Ligji për Komisionin e Pavarur për Media
LPB	Lëvizja për Bashkëveprim
LMPDIKP	Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të interesave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
QKN	Qendra komunale e numërimit
KKZ	Komisioni Komunal Zgjedhor
MP	Deputet i Kuvendit
NDS	Partia e Re Demokratike

"Zyra"	Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike
JK	Jashtë Kosovës
ORK	Opre Roma Kosova
AP	Administrata pensionale
PAI	Partia e Ashkalinjve për Integrim
PDAK	Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PKS	Partia e Serbëve të Kosovës
PREBK	Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
KVV	Këshilli i Vendvotimit
VV	Vendvotim
LPV	Lista preliminare e votuesve
PAK	Personat me aftësi të kufizuara
RTK	Radiotelevizioni i Kosovës
GJS	Gjykata Supreme
SD	Demokracia Serbe
SDU	Unioni Social Demokrat
LS	Lista Serbe
SNP	Lëvizja Kombëtare Serbe
SPO	Për liri drejtësi dhe mbijetesë
YTHP	Partia Turke e Lëvizjes Novatore

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 në Kosovë ishin të qeta dhe konkurruese, dhe u zhvilluan sipas një kornize të re ligjore që synon rritjen e transparencës dhe besimit. Dita e zgjedhjeve në përgjithësi u zhvillua mirë, megjithatë, pjesë kritike të procesit u ndikuan nga organizimi i dobët nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), duke shkaktuar edhe vonesa kritike në shpalljen e rezultateve të vendotimeve dhe atyre përfundimtare. Fushata ishte dinamike, megjithëse u njollos nga retorika e ashpër dhe keqpërdorimi i resurseve publike. Në aspektin pozitiv, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) trajtoi me shpejtësi një numër të konsiderueshëm të rasteve, duke rezultuar në gjoba të konsiderueshme për shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike. Në zonat me shumicë serbe të Kosovës, kushtet sociale mbeten të rënda, duke krijuar hapësirë për Serbinë dhe *Listën Serbe* (SL) që të ushtrojnë presion të papërshtatshëm mbi votuesit. Edhe pse liria e medias është pranuar gjerësisht, paralizimi i Komisionit të Pavarur të Medias (KPM) në javët para ditës së zgjedhjeve i la pa adresuar shkeljet e mediave. Megjithatë, votuesit dhe aktorët kryesorë në proces demonstruan qëndrueshmëri dhe një përkushtim të fortë ndaj parimeve demokratike.

Zgjedhjet u zhvilluan pas mandatit të plotë qeveritar të *Lëvizjes Vetëvendosje* (LVV) të kryeministrit Albin Kurti, gjatë së cilës partitë opozitare mbajtën pozita të forta komunale. Qeveria u përball me kritika për polarizimin politik dhe marrëdhëniet e tensionuara me komunitetin serb të Kosovës. Procesi zgjedhor u karakterizua me përpjekje për politizimin e institucioneve kyçe nga partia në pushtet, veçanërisht KQZ-së dhe KPM-së. KQZ-ja u ngatërrua në mosmarrëveshje politike dhe i politizoi disa aspekte teknike të procesit zgjedhor. Përpjekja nga anëtarët e emëruar të LVV-së në KQZ për të parandaluar certifikimin e Listës Serbe (LS), dhe bllokimi i disbursimit të fondeve publike për partitë politike, vuri presion të konsiderueshëm mbi institucionin.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 ishin të parat që u mbajtën sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të miratuar në vitin 2023, i cili solli një varg risish që synonin të rrisnin besimin e palëve të interesuara dhe të rrisnin transparencën e procesit zgjedhor. Kuadri ligjor ofron një bazë të shëndoshë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, zbatimi i kuadrit të ri ligjor solli në pah aspekte të ligjit që kërkonin sqarime të mëtejshme për të zvogëluar paqartësitë e mundshme dhe për të forcuar sigurinë ligjore. Është për t'u habitur që përkundër njoftimit të mjaftueshëm paraprak, zbatimi i ligjit të ri për zgjedhjet dhe organizimi i përgjithshëm i zgjedhjeve u karakterizua nga përgatitja joadekuate.

Një numër i konsiderueshëm i rasteve janë parashtruar në PZAP, po ashtu duke çuar në shqiptimin e gjobave substanciale për shkelje të kodit të mirësjelljes. Ligji përcakton afate të qarta kohore dhe hapa të artikuluar mirë për shqyrtimin e kontesteve zgjedhore. Megjithatë, procesi mund të përmirësohet po të ketë më shumë qartësi. Gjatë procesit zgjedhor, disa raste arritën në Gjykatën Supreme, ku shumica e vendimeve konfirmuan vendimet e PZAP-it.

Fushata ishte dinamike pa incidente të mëdha. Megjithatë, retorika negative, sulmet e ashpra verbale dhe gjuha nxitëse ishin të përhapura gjatë ngjarjeve të fushatës. Përveç kësaj, fushata ishte subjekt i ndërhyrjes së jashtme nga Serbia dhe administrata e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gratë kandidatë iu nënshtruan sulmeve verbale seksiste, kishin më pak resurse se kolegët e tyre meshkuj dhe kishin më pak mbulim mediatik. Nuk pati debate kuptimplota ndërmjet kandidatëve kryesorë.

Vëzhguesit dhe bashkëbiseduesit e EU EOM-së raportuan raste të keqpërdorimit të resurseve publike nga disa subjekte politike gjatë fushatës, me disa raste që rezultuan me

ndëshkime. Mungesa e mekanizmave të fortë të monitorimit ngre shqetësime lidhur me efektivitetin e rregulloreve për financimin e fushatës. Subjektet politike nga komunitetet e vogla joshumicë u përballën me sfida financiare, gjë që krijoi kushte të pabarabarta gjatë fushatës.

Peizazhi politik në komunitetin serb të Kosovës u karakterizua nga një rritje e perceptuar e pluralizmit politik, me gjashtë subjekte politike që garuan në zgjedhje. LS mbeti dominuese brenda komunitetit serb të Kosovës, duke pasur përkrahjen e Presidentit të Serbisë Aleksandar Vuçiq dhe duke e mbështetur fushatën e saj në mediat e Serbisë dhe mediat e vogla serbe të Kosovës. Përveç kësaj, u raportua për presion ndaj votuesve që vareshin nga ndihma sociale dhe punësimi i Serbisë. Në përgjithësi, në komunat e Kosovës me shumicë serbe pati një fushatë relativisht të zbehtë krahasuar me komunat e tjera.

Performanca e KQZ-së u karakterizua nga raste të ndikimit politik në procesin e saj të vendimmarrjes, si dhe nga tendenca për të interpretuar gjerësisht kompetencat e saj dhe për të vepruar jashtë mandatit të saj, duke rrezikuar paanshmërinë dhe pavarësinë e saj. Ndonëse legjislacioni lejon përfaqësimin domethënës të subjekteve politike të kualifikuara në trupat zgjedhore të nivelit më të ulët, përbërja e tyre e aprovuar u kontestua për shkak se nuk ishte mjaftueshëm përfaqësuese. Gjatë periudhës zgjedhore, KQZ mbajti seanca të rregullta publike dhe përgjithësisht i publikoi vendimet e saj me kohë. Megjithatë, ajo e humbi mundësinë për të shfrytëzuar kanalet e krijuara të komunikimit për të adresuar shqetësimet e palëve të interesuara dhe për t'iu kundërvënë dezinformimit, veçanërisht pas ditës së zgjedhjeve, përmes komunikimit dhe shkëmbimit më efektiv dhe më gjithëpërfshirës të informacionit.

Kapaciteti operacional i administratës zgjedhore u vu në vështirësi për shkak të menaxhimit joadekuat, mungesës së koordinimit në terren si dhe mungesës së personelit të përhershëm dhe atij të përkohshëm. KQZ-ja pati vonesa të konsiderueshme në disa aspekte të përgatitjeve teknike dhe administrative dhe disa vendime i mori me vonesë, duke përfshirë udhëzimet teknike dhe emërimin dhe trajnimin e organeve zgjedhore të nivelit më të ulët. Kjo pati ndikim negativ në efikasitetin dhe afatin kohor të përgatitjeve. Përkundër këtyre sfidave, personeli zgjedhor i caktuar në nivelin komunal dhe të vendvotimeve demonstroi një shkallë të mirë të përkushtimit për të vazhduar me përgatitjet dhe për të menaxhuar mirë operacionet në ditën e zgjedhjeve.

Legjislacioni parashikon disa aranzhime të veçanta të votimit për t'u ofruar votuesve mundësi për të ushtruar të drejtën e tyre për të votuar. Gjithsej 2,670 votues që nuk mund të dalin nga shtëpia, si dhe ata në institucionet e kujdesit shëndetësor, në shtëpitë e të moshuarve dhe objektet penale patën mundësi të votonin përmes kutive mobile të votimit. Për më tepër, 12,898 votues votuan në njërën nga qendrat e votimit të përcaktuara për votim me kusht në mbarë Kosovën. Kosovarët që jetojnë jashtë vendit patën mundësi të regjistroheshin për votim me postë ose personalisht në misionet e përcaktuara diplomatike, për herë të parë në këto zgjedhje. Nga 20,324 që kishin të drejtë, 15,348 votuan personalisht. Në total, KQZ-ja ka marrë 68.715 dërgesa postare me fletëvotime, nga të cilat 63.705 zarfe me fletëvotime janë aprovuar për numërimin e votave dhe 4.898 dërgesa janë refuzuar për arsye të ndryshme. Pas verifikimit të listave të votuesve dhe vlerësimit të dërgesave postare, komisioni evidentoi 921 raste të mundshme të votimit të shumëfishtë.

Të gjithë votuesit me të drejtë vote janë përfshirë automatikisht në listën e votuesve të përpiluar nga komisioni në bazë të të dhënave nga regjistri civil dhe bazës së të dhënave të dokumenteve të identifikimit. Pavarësisht dispozitave për kontestimin e të dhënave të regjistrimit të votuesve gjatë një periudhe të caktuar, qasja e votuesve në listat e votuesve ishte e kufizuar vetëm në të dhënat e

tyre personale, duke kufizuar kështu mbikëqyrjen kuptimplotë nga publiku. Lista përfundimtare e votuesve përmbante gjithsej 2,075,868 votues, përfshirë 104,924 të regjistruar për votim jashtë Kosovës. Ndërsa bashkëbiseduesit e EU EOM-së shprehën një nivel të lartë besimi në aspektin gjithëpërfshirës të listës së votuesve, vazhdon të ketë shqetësime për saktësinë e saj, kryesisht për shkak të mangësive në regjistrimin civil.

Procesi i certifikimit në përgjithësi ishte gjithëpërfshirës, megjithatë u njollos nga mospajtimi i ndikuar politikisht i KQZ-së në lidhje me certifikimin e kandidatëve të LS-së. Të gjitha listat e kandidatëve me më shumë se dy kandidatë që ishin dorëzuar nga subjektet politike për certifikim respektuan kërkesën ligjore për një përfaqësim minimal gjinor. KQZ certifikoi 28 subjekte politike dhe 1,279 kandidatë.

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe votimi në përgjithësi u zhvillua pa probleme. Vëzhguesit e EU EOM-së e vlerësuan pozitivisht procesin e votimit në shumicën e vendvotimeve, duke vënë në dukje se, në përgjithësi, këshillat e vendvotimeve i ndoqën procedurat e parashikuara, ndonëse u vërejt konfuzion dhe jokonsistencë në zbatimin e tyre, duke nxjerrë në pah mangësi në trajnimin e stafit të vendvotimeve. Gabimet lidheshin kryesisht me procedurat e reja për votimin e asistuar dhe verifikimin e gishtave të votuesve për gjurmë të bojës. Për më tepër, fshehtësia e votës u komprometua në disa vendvotime, kryesisht për shkak të mënyrës së aranzhimit të hapësirës, pozicionimit të kabinave të votimit ose kamerave. Procesi i numërimit zbuloi se procedurat nuk ishin kuptuar mjaftueshëm, gjë që u vërtetua nga lëshimet procedurale, përfshirë trajtimin jo të duhur të fletëvotimeve të papërdorura dhe materialeve të tjera të ndjeshme para hapjes së kutive të votimit, zhvillimin njëkohësisht të procedurave të numërimit dhe moskonsistencën në përcaktimin e vlefshmërisë së votave.

Natën e zgjedhjeve, sistemet kritike të TI-së të KQZ-së nuk ishin të disponueshme për një periudhë të zgjatur, duke ndikuar në tabelimin dhe publikimin e rezultateve preliminare dhe në pranimin e materialeve zgjedhore në qendrat komunale të numërimit. Për shkak të problemeve të vazhdueshme teknike, përgatitjes së pamjaftueshme teknike të qendrave të numërimit dhe mungesës së pajisjeve kritike dhe softuerit, numërimi i votave preferenciale në qendrat komunale të numërimit u shty, me disa qendra që e filluan atë me 16 shkurt. Pasi u kapërcye konfuzioni fillestar mbi procedurat, që ishte evident në shumicën e qendrave, performanca e ekipeve të numërimit si dhe procesi u në fund vlerësuan nga vëzhguesit si kryesisht efikase dhe transparente. Disa raste të rivlerësimit të vlefshmërisë së fletëvotimeve nga ekipet e numërimit janë raportuar nga shumica e qendrave komunale të numërimit, duke treguar se këto rregulla nuk ishin kuptuar mjaftueshëm nga ana e këshillave të vendvotimeve dhe se nuk ishin ofruar trajnimet adekuate. Pengesat teknike në sistemin e përpunimit të rezultateve, të kombinuara me informacionin e kufizuar ose, në disa raste, jo të saktë të ndarë nga KQZ-ja, minuan ndjeshëm besimin e publikut në integritetin e procesit të numërimit dhe tabelimit dhe ngritën shqetësime mbi masat e sigurisë kibernetike të KQZ-së.

Peizazhi mediatik i Kosovës është i gjallë dhe i larmishëm, por përballet me sfida të konsiderueshme, duke përfshirë ndarjet e thella etnike dhe kufizimet financiare. Sektori mbeti shumë i fragmentuar, me komunitetet shqiptare dhe serbe që angazhoheshin kryesisht me media të ndara, ndërsa u bënë vetëm përpjekje të kufizuara për të nxitur dialog ndërmjet komuniteteve. Për më tepër, disa media private shfaqën shenja politizimi dhe strukturat e tyre të pronësisë nuk janë plotësisht transparente. Ndërsa mbrojtja kushtetuese mbështet liritë e medias, vazhdon të ketë shqetësime për sfidat me të cilat përballet transmetuesi publik, përfshirë bordin jofunksional, çështjet me pavarësinë editoriale, mosmarrëveshjet pronësore, kufizimet buxhetore dhe sfidat e burimeve njerëzore. Këto kufizime ishin veçanërisht të dukshme në RTK2, kanali i transmetuesit

publik në gjuhën serbe. Gjatë fushatës zgjedhore, për shkak të bllokadës në qeverisjen e saj, KPM-ja dështoi të zbatojë mbikëqyrjen e saj rregullative për shqiptimin e sanksioneve, duke krijuar kështu një situatë të pasigurisë së zgjatur për organizatat mediatike. Megjithatë, transmetuesi publik, RTK, ofroi mbulim kryesisht të barabartë të kandidatëve kryesorë për zgjedhje në kanalin e tij kryesor në gjuhën shqipe, duke pasqyruar angazhimin për raportim të balancuar.

Mbulimi i zgjedhjeve u dominua nga sulmet partiake, akuzat për njëanshmëri të mediave dhe mungesa e mundësive për të krahasuar kandidatët drejtpërdrejt në kanalet kryesore televizive, që u përkeqësua edhe më shumë nga bojkotimi që LVV u bëri tri mediave të mirënjohura private. Ndërsa transmetuesit ofruan debate zgjedhore, shumica nuk arritën të organizonin diskutime të orientuara në politika, duke pasqyruar një kulturë të dobët debati midis konkurrentëve politikë që kufizoi mundësinë e votuesve për të vlerësuar programet e partive. Dispozitat ligjore kontribuan në krijimin e kushteve të barabarta duke rregulluar kohën e transmetimit me pagesë dhe duke siguruar një shpërndarje minimale të kohës së transmetimit falas kur shfrytëzohej mbulimi me pagesë.

Fushata online pasqyroj tonin agresiv të debateve publike dhe tubimeve, por i mungonte përmbajtja, veçanërisht gjatë gjysmës së parë të periudhës së fushatës. Të gjitha partitë politike që garuan në zgjedhje dhe mbi gjysma e kandidatëve zhvilluan fushatë në mediat sociale, kryesisht në Facebook dhe Instagram. Toni i ashpër i fushatës u pasqyrua në mediat sociale përmes videove të ngjarjeve të fushatës, të cilat përbënin një pjesë të madhe të përmbajtjes së postuar nga partitë dhe kandidatët. Heshtja në ditën e zgjedhjeve u thye me disa postime dhe reklama, disa prej të cilave rezultuan me ndëshkime nga PZAP. Mbi 250,000 € u shpenzuan për promovimin e më shumë se 7,000 reklamave lidhur me zgjedhjet në Facebook dhe Instagram, duke përfshirë reklamat nga palët e treta.

Gratë do të përbëjnë 36 për qind të Kuvendit të ardhshëm të Kosovës dhe shumica e tyre janë zgjedhur pa aplikimin e kuotës gjinore. Megjithatë, burrat prapëseprapë dominuan fushatën, duke përbërë një shumicë të konsiderueshme të folësve në ngjarjet e fushatës dhe në debatet televizive. Partitë politike nuk e kanë trajtuar mjaftueshëm pabarazinë gjinore në platformat e tyre dhe në organet qeverisëse siç është e përcaktuar me Ligjin për Barazi Gjinore. Pavarësisht nga dispozitat në LZP-së që inkurajojnë një ekuilibër më të madh gjinor në administratën zgjedhore, gratë përbënin më pak se 30 për qind të anëtarëve në nivel qendror dhe lokal.

Për mungesë të resurseve, subjektet politike joshumicë zhvilluan aktivitete të fushatës të profilit të ulët brenda komuniteteve të tyre. Ata gjithashtu kishin qasje të kufizuara në mediat transmetuese përtej kohës falas të parashikuar me ligj dhe ishin kritikë ndaj përbërjes së këshillave të vendvotimeve, të cilat i konsideronin si jo mjaftueshëm përfaqësuese. Për më tepër, fushata ndërgjegjësuere e KQZ-së për procedurat e votimit në gjuhën turke, boshnjake dhe rome po ashtu u zhvillua me vonesë.

Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor u përball me sfida për shkak të mungesës së qasjes në qendrat e votimit dhe mjeteve ndihmëse, si dhe nga zbatimi jo konsistent i dispozitave të reja në lidhje me votimin e asistuar. Për më tepër, organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara raportuan për mungesë konsultimi nga KQZ-ja dhe komisionet komunale zgjedhore në lidhje me fushatat e edukimit të votuesve dhe regjistrimin e votuesve me nevoja të veçanta.

Rekomandimet me prioritet

- 1. Të forcohen masat mbrojtëse ligjore në lidhje me anëtarët dhe sjelljen e zyrtarëve të zgjedhjeve për të garantuar paanshmërinë dhe pavarësinë e administratës zgjedhore.*
- 2. Të kufizohen dhe specifikohen më tej përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretariatit të KQZ-së dhe komisioneve komunale zgjedhore për të decentralizuar vendimmarrjen e administratës së zgjedhjeve aty ku është e përshtatshme dhe për të siguruar efikasitet dhe veprim me kohë të operacioneve të saj.*
- 3. Të bëhet një verifikim gjithëpërfshirës i pavarur i listës së votuesve, duke përfshirë përmes analizës së brendshme të proceseve të regjistrimit dhe testimit statistikor dhe në terren, në konsultim me palët përkatëse të interesit, për të adresuar shqetësimet mbi saktësinë e saj dhe për të rritur besimin e publikut.*
- 4. Të prezantohen përkufizime të qarta ligjore të termave kyç, duke përfshirë ato që lidhen me gjuhën nxitëse dhe përkufizimin e një 'mbështetësi të subjektit politik' brenda procesit zgjedhor. Të vendosen kritere të qarta për përcaktimin e gjobave proporcionale të zbatueshme për shkëlqet e Kodit të Mirësjelljes nga subjektet politike.*
- 5. Të emërohen të gjithë anëtarët e KPM-së me kohë dhe përmes një procesi përzgjedhës konkurrues dhe transparent.*
- 6. Të krijohet një sistem i besueshëm dhe transparent i menaxhimit të rezultateve me procedura të qarta dhe të verifikueshme për të siguruar përpunim të saktë të të dhënave të rezultateve. Të sigurohet qasje e shpejtë në rezultatet preliminare, duke përfshirë të gjitha të dhënat përkatëse, si p.sh. pjesëmarrja e votuesve, votat e vlefshme dhe të pavlefshme, si dhe formularët e rezultateve të skanuara për vendvotim.*

II. HYRJE

Bashkimi Evropian (BE) dërgoi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EOM) për të vëzhguar zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 në Kosovë pas ftesës nga Presidentja e Kosovës. EOM ishte e pranishme nga 8 janari deri më 27 shkurt 2025.

Misioni u udhëhoq nga Shefja e Misionit, Znj. Nathalie Loiseau, deputete e Parlamentit Evropian nga Franca. EU EOM përbëhej nga një ekip kryesor prej dhjetë ekspertësh të vendosur në Prishtinë dhe 18 vëzhgues afatgjatë të cilët mbërritën më 16 janar dhe u vendosën në të gjitha rajonet e Kosovës. Tridhjetë e gjashtë vëzhgues afatshkurtër ishin të pranishëm nga data 4 deri më 14 shkurt dhe u shpërndanë në mbarë Kosovën.

Për ditën e zgjedhjeve, EU EOM u përforcua me 27 vëzhgues të rekrutuar në nivel vendi nga përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare të BE-së. Në total, EU EOM shpërndau 104 vëzhgues nga të 27 vendet anëtare të BE-së, si dhe nga vendet partnere, Kanadaja, Norvegjia dhe Zvicra. Gjithashtu, një delegacion prej gjashtë deputetësh të Parlamentit Evropian u udhëhoq nga Marta Temido, deputete e Parlamentit Evropian nga Portugalia.

Mandati i misionit ishte të vëzhgonte të gjitha aspektet e procesit zgjedhor dhe të vlerësonte shkallën në të cilën zgjedhjet ishin në përputhje me angazhimet rajonale dhe ndërkombëtare për zgjedhjet, si dhe me legjislacionin e vendit. BE-ja është e pavarur në gjetjet dhe përfundimet e saj. Misioni ndoqi një metodologji të përcaktuar dhe iu përmbajt "Deklaratës së Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve", të miratuar nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara në tetor 2005 që tani përkrahet nga mbi 50 organizata.

III. KONTEKSTI POLITIK

Kosova organizoi zgjedhjet e vitit 2025 pas përfundimit të mandatit të plotë qeverisës. Peizazhi politik në katër vitet e fundit ishte formësuar nga qeveria e *Lëvizja Vetëvendosje* (LVV) dhe kryeministri Albin Kurti, ndërsa partitë kryesore politike në opozitë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK-NISMA) arritën të ruajnë pozitën e tyre të fortë në komuna pas zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Koalicioni qeverisës në largim përbëhej nga 58 deputetë nga grupi parlamentar i LVV-së, së bashku me tetë deputetë që përfaqësonin komunitetet joshumicë, të përbërë nga tre boshnjakë të Kosovës, dy turq të Kosovës, një rom i Kosovës, një ashkali i Kosovës dhe një deputet egjiptian i Kosovës.¹ Më 4 prill 2021, Vjosa Osmani, e cila kishte kandiduar në zgjedhje në listë të përbashkët me LVV-në, ishte zgjedhur Presidente e Kosovës nga Kuvendi.

Qeveria është kritikuar se ka kontribuar në polarizimin e peizazhit politik me partitë opozitare shqiptare të Kosovës dhe ka penguar procesin e normalizimit me komunitetin serb të Kosovës, i cili mbetet shumë i ndikuar nga Serbia. Afirmimi i sovranitetit të Kosovës ka qenë fokusi kryesor i politikave dhe iniciativave të partisë në pushtet. Sovraniteti po ashtu u shfaq si temë kryesore e fushatës së LVV-në, përmbledhur në sloganin e saj kryesor, "Cep më cep". Përpjekja e udhëhequr nga LVV për të parandaluar certifikimin e *Srpska Lista* (SL) të lidhur me Serbinë u pasua nga një intensifikim i retorikës që synonte delegjitimimin e pjesëmarrjes së LS-së në zgjedhje, ku LVV e lidhte LS-në dhe Beogradin me sulmin terrorist në *Banjaskë* në shtator 2023. Më 15 janar, autoritetet e Kosovës ndërmorën një operacion në shkallë të gjerë për të shpërbërë strukturat e operuara nga Serbia në 24 lokacione në komunat në jug të lumit Ibër. Komuniteti ndërkombëtar i kritikoi ato veprime si jo të duhura për procesin e normalizimit të Dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, i lehtësuar nga BE-ja.

Në procesin zgjedhor u pa një politizim i institucioneve kryesore nga partia në pushtet, veçanërisht i KQZ-së dhe Komisionit të Pavarur të Mediave. KQZ-ja u ngatërrua në mosmarrëveshje politike dhe politizoi disa aspekte teknike të procesit zgjedhor. Përpjekja nga anëtarët KQZ-së të emëruar nga LVV për të parandaluar certifikimin e LS-së, dhe bllokimi i shpërndarjes së fondeve publike për partitë politike, vuri presion të konsiderueshëm mbi KQZ-në.

Pjesëmarrja në zgjedhje e gjashtë partive politike serbe të Kosovës shihet si një zhvillim pozitiv, duke çuar në një perceptim të rritjes së pluralizmit politik në këtë komunitet. Gjithsej gjashtë parti politike serbe të Kosovës garuan në zgjedhje, duke përfshirë LS, Për Liri Drejtësi dhe Mbijetesë (SPO), Lëvizja Kombëtare Serbe (SNP), Partia e Serbëve të Kosovës (PKS), Nisma Qytetare për Drejtësi Kombëtare (GINP) dhe Demokracia Serbe (SD). Megjithatë, LS vazhdoi të dominoi

¹ Numri i deputetëve të LVV-së deri në fund të mandatit u ul në 53 pasi disa deputetë u larguan nga partia.

peizazhin politik në komunitetin serb të Kosovës, me presidentin serb Aleksandar Vuçiq që e mbështeti LS-në dhe u bëri vazhdimisht thirrje serbëve të Kosovës që të votonin në numër sa më të madh për kandidatët e tyre.

IV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË MËPARSHME TË EU EOM-SË

Misioni i mëparshëm vëzhgues i BE-së (EU EOM) i vendosur në Kosovë në vitin 2021 për zgjedhjet komunale kishte dhënë 23 rekomandime se si të reformohet procesi zgjedhor për ta sjellë atë plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane dhe për të pasqyruar praktikat më të mira ndërkombëtare. Këto rekomandime përfshijnë, *ndër të tjera*, adresimin e mospërputhjeve, mangësive dhe paqartësive të kornizës ligjore, përmirësimin e saktësisë së listave të votuesve, sigurimin e konsistencës ligjore për rregullat e fushatës zgjedhore, rritjen e transparencës së financimit të fushatës dhe zbatimin e tyre në mënyrë efektive, rregullimin e mediave dhe platformave digjitale të sponsorizuara nga partitë politike, si dhe detajimin e dispozitave për përmirësimin e afateve kohore për kontestet zgjedhore.

Nga 23 rekomandimet e dhëna, nëntë janë zbatuar plotësisht (përfshirë tri nga gjashtë prej atyre prioritare), katër janë zbatuar pjesërisht, tetë nuk janë adresuar; dhe dy rekomandime lidhur me kufizimin e periudhës së fushatës dhe dizajnin e fletëvotimit nuk ishin relevante për zgjedhjet parlamentare. Pas reformës zgjedhore të nisur në vitin 2022, e cila kulmoi me miratimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) në vitin 2023, disa nga ato rekomandime që kërkonin ndryshime në kornizën ligjore janë zbatuar. Përkatësisht, për administrimin e zgjedhjeve ligji fuqizon komisionet komunale zgjedhore të kryejnë aktivitete për edukimin e votuesve, digjitalizon procesin për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës (VjK) dhe përshkruan kritere më të detajuara për pranueshmërinë e kandidatëve.

Për financimin e fushatës, LZP përcakton që Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (“Zyra”) është autoriteti kompetent mbikëqyrës për financimin politik dhe të fushatës dhe përcakton afatet kohore për deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve përkatëse për fushatën, por nuk parashikon raportim të ndërmjetëm. Për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore, LZP ofron një mundësi për të kundërshtuar rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve para certifikimit të tyre dhe zgjat disa nga afatet për paraqitjen dhe marrjen e vendimeve për ankesat.

Dy rekomandime lidhur me mediat për sa i përket reklamimit në portalet e mediave online dhe bashkëpunimin ndërmjet administratës zgjedhore dhe ofruesve kryesorë digjitalë janë adresuar pjesërisht nga LZP. Megjithatë, ato ende nuk janë zbatuar, pjesërisht për shkak të mungesës së rregulloreve dhe resurseve në Komisionin e Pavarur për Media (KPM), derisa ato do të përfitonin edhe nga qartësia e mëtejshme. Një rekomandim tjetër për transparencën mbi pronësinë e mediave është adresuar nga legjislacioni plotësues i KPM-së. Megjithatë, një rekomandim prioritar për emërimin e anëtarëve të KPM-së mbetet pa u adresuar.

Votimi i asistuar u detajua më tej në LZP dhe në Rregulloren e KQZ-së, duke zbatuar plotësisht një rekomandim, por transpozimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ende nuk është përfshirë në Kushtetutë, përkundër një vendimi të qeverisë të vitit 2022.

V. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Një kuadër i ri ligjor për zgjedhjet i përafruar në thelb me standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike u testua, duke zbuluar paqartësi që nuk janë adresuar ende nga legjislacioni plotësues.

a. Ligji për zgjedhjet

Kosova nuk është nënshkruese e asnjë traktati ndërkombëtar, por zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e një numri konventash ndërkombëtare që kanë të bëjnë me zgjedhjet është pranuar në Kushtetutën e vitit 2008.² Përderisa Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) nuk ka juridiksion mbi Kosovën, autoritetet janë të detyruara të interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së.³ Pas anëtarësimit të Kosovës në Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit, i njohur si Komisioni i Venecias, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias i tetorit 2002 zbatohet si referencë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.⁴ Kushtetuta thotë se marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe i zëvendësojnë ligjet e Kosovës dhe aktet e tjera të institucioneve publike. Të drejtat themelore, duke përfshirë të drejtën për të votuar dhe për t'u kandiduar në zgjedhje dhe liritë e shprehjes, tubimit dhe asociimit janë të sanksionuara në Kushtetutë. E drejta për barazi është gjithashtu e elaboruar dhe parashikohen masa afirmative për avancimin e grave, komuniteteve dhe personave me aftësi të kufizuara, por barazia nuk inkurajohet në mënyrë të mjaftueshme në praktikë.

Zgjedhjet parlamentare rregullohen kryesisht me Kushtetutën e vitit 2008 (e ndryshuar në vitin 2020) dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) i vitit 2023, i përplotësuar nga Rregulloret e KQZ-së, të cilat i detajojnë dispozitat e LZP-së. Legjislacioni tjetër që zbatohet përfshin Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2010 (i ndryshuar së fundmi në 2022), Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (LMPDK), Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, ligjet lidhur me mediat, dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kuadri i rishikuar ligjor ofron një bazë të qëndrueshme për mbajtjen e zgjedhjeve të vërteta demokratike, në përputhje të konsiderueshme me standardet ndërkombëtare. Në përgjithësi, ka rregulla të përcaktuara mirë të angazhimit për shumicën e palëve të interesit dhe mekanizma të duhur për zgjidhjen e kontesteve gjatë tërë procesit. Megjithatë, hapat e mëtejshëm mund të sigurojnë përfshirje të plotë, transparencë dhe stabilitet ligjor. Disa boshllëqe ligjore dhe paqartësi në ligj dhe rregullore krijojnë pasiguri në aspektin e të drejtave themelore, veçanërisht sa i përket lirisë së shprehjes, përgjegjësisë financiare dhe mjeteve juridike.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 ishin të parat që u mbajtën sipas LZP-së së ri, që shihet si një moment i rëndësishëm historik, edhe pse procesi i miratimit të ligjit ishte kritikuar si i nxituar dhe

² Neni 22, Kushtetuta. Domethënë, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollat e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

³ Neni 53, Kushtetuta. Megjithatë, meqenëse Kosova nuk është palë në GJEDNJ, nuk ka ndonjë mundësi që një rast të paraqitet në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe mbetet interpretimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut brenda sistemit gjyqësor të Kosovës.

⁴ Më 11 qershor 2014, Këshilli i Ministrave i Këshillit të Evropës aprovoi anëtarësimin e Kosovës në Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias).

jo gjithëpërfshirës, veçanërisht nga shoqëria civile. Ligji i ri i përfshin disa rekomandime të EU EOM-ve të mëparshme për të harmonizuar më tej kuadrin ligjor të zgjedhjeve me standardet ndërkombëtare, përfshirë rritjen e autonomisë financiare të KQZ-së, digjitalizimin e proceseve, krijimin e një autoriteti mbikëqyrës për financimin e fushatës, përfshirjen e dispozitave për të garantuar pluralitetin e mediave dhe dispozita të detajuara për votimin e asistuar. Më tej, ligji promovon një përfshirje më të madhe gjinore duke ofruar stimuj financiarë për subjektet politike, deputetët e të cilëve përfshijnë më shumë se 30 për qind gra. Përtej këtyre rekomandimeve, LZP modifikon sistemin zgjedhor duke rritur numrin e votave preferenciale nga pesë në dhjetë dhe ndryshon formulën për ndarjen e mandateve, përfshin dispozita për fushatën online dhe heq ato që mund të çojnë në tërheqjen arbitrare të akreditimit të vëzhguesve.

Me gjithë këto përmirësime, ligji lë një fushëveprim të gjerë rregullativ për legjislacionin dytësor, ndërkohë që disa dispozita do të mund të përfitonin nga qartësia dhe harmonizimi i mëtejshëm me tekste të tjera legjislative, veçanërisht në lidhje me rregullimin e mediave, barazinë gjinore dhe financimin e fushatës. Disa dispozita teknike të ligjit nuk janë saktësuar, duke lënë kështu hapësirë për paqartësi, ndërsa afatet kohore të rezultateve përfundimtare, ndër të tjera, mund të përfitojnë nga një shtjellim i mëtejshëm. Gjithashtu, këtij kuadri i mungon përcaktimi i termave të rëndësishëm që lidhen me shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët në fushatë, duke lënë hapësirë për interpretim subjektiv.

Rekomandim - Të sigurohet qartësia ligjore duke adresuar paqartësitë dhe mangësitë përmes legjislacionit shtesë të përpunuar mirë, veçanërisht për Kodin e Mirësjelljes në fushatë, emërimin e stafit për administrimin e zgjedhjeve dhe zgjidhjen e kontesteve.

b. Sistemi zgjedhor

120 deputetët e Kuvendit zgjidhen për mandat katërvjeçar në një zonë zgjedhore që përfshin tërë Kosovën. Aplikohet një sistem i përfaqësimit proporcional me listë të hapur dhe votim preferencial për deri në dhjetë kandidatë. Njëqind mandate u ndahen partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme që kanë marrë, me kusht që të kalojnë pragun prej pesë për qind të votave të vlefshme. Njëzet ulëse janë të garantuara për komunitetet joshumicë, duke përfshirë dhjetë për komunitetin serb të Kosovës, tre për komunitetin boshnjak të Kosovës, dy për komunitetin turk të Kosovës dhe nga një për komunitetet goran, rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, si dhe një ulëse për njërin prej tri komuniteteve të fundit që ka numrin më të madh të votave. Ulëset shpërndahen sipas Metodës së Mesatares më të Lartë, duke zbatuar metodën D'Hondt, në vend të formulës Sainte-Laguë, që parashihej në ligjin e mëparshëm.

VI. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Mangësitë në planifikimin dhe koordinimin e brendshëm ndikuan negativisht në zhvillimin e zgjedhjeve dhe mungesa e qasjes në informacionet kyçe e uli besimin e publikut në proces.

a. Struktura dhe përbërja e administratës zgjedhore

Struktura e administratës zgjedhore me tri nivele përbëhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), komisionet komunale zgjedhore (KKZ) dhe këshillat e vendvotimeve (KVV) për çdo vendvotim, si dhe ekipet e numërimit për çdo qendër komunale të numërimit (QKN), të prezantuara rishtazi gjatë këtyre zgjedhjeve.

KQZ-ja është një autoritet i përhershëm i pavarur me kompetenca të gjera rregullative dhe monitoruese, përgjegjëse për organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve. KQZ-ja përbëhet nga

njëmbëdhjetë anëtarë: një kryesues jopartiak dhe dhjetë anëtarë të emëruar nga partitë politike të përfaqësuara në kuvend. Kryesuesi i KQZ-së emërohet nga presidenti nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme (GJS) ose të gjykatës së apelit. Gjashtë anëtarë emërohen nga grupet më të mëdha parlamentare që nuk kanë të drejtë për vende të garantuara dhe katër anëtarë nga deputetët që përfaqësojnë komunitetet joshumicë në Kosovë.⁵ Ndërsa mandati i kryesuesit është shtatë vjeçar, mandatet e anëtarëve të tjerë janë të lidhura me mandatin e legjislaturës.

Pavarësisht nga propozimet politike, legjislati zgjedhor i obligon anëtarët e KQZ-së të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme dhe parashikon disa masa për të garantuar pavarësinë dhe profesionalizmin e tyre.⁶ Megjithatë, EU EOM vërejtë raste të ndikimit politik në procesin e vendimmarrjes së KQZ-së, me anëtarë individualë që vepronin si mbrojtës të interesave të subjektit që i ka propozuar ata, duke rrezikuar pavarësinë dhe paanshmërinë e KQZ-së. Modele të tilla u demonstruan gjatë certifikimit të garuesve në zgjedhje, aprovimit të disbursimit të fondeve publike për partitë politike dhe emërimit të organeve të nivelit më të ulët. EU EOM më tej vërejtë tendenca të përsëritura të përbërjes aktuale të KQZ-së për të interpretuar gjerësisht kompetencat e saj dhe për të vepruar jashtë fushës së mandatit të saj, duke zgjeruar autoritetin e saj vendimmarrës dhe duke ndërhyrë në detyrat e Sekretariatit dhe Zyrës së KQZ-së. Kjo u mundësua për shkak të mungesës së qartësisë në disa dispozita të LZP.

Përveç praktikës më solide në performancën e anëtarëve, pavarësia e KQZ-së mund të rritet nëpërmjet forcimit të masave që rregullojnë sjelljen e tyre dhe duke i përcaktuar qartë kompetencat e KQZ-së dhe duke i kufizuar ato në favor të Sekretariatit të KQZ-së dhe organeve zgjedhore të nivelit më të ulët. Po ashtu mund të zgjerohet grupi i profesionistëve nga të cilët subjektet nominuese i zgjedhin anëtarët e KQZ-s, me qëllimin për të kufizuar përkatësinë politike.

Rekomandim me prioritet – Të forcohen masat mbrojtëse ligjore në lidhje me anëtarësinë dhe sjelljen e zyrtarëve të zgjedhjeve për të garantuar paanshmërinë dhe pavarësinë e administratës zgjedhore.

Përgjegjësitë administrative, organizative dhe teknike të KQZ-së i bart Sekretariati i KQZ-së, i cili është drejtuar nga një ushtrues detyre i kryeshefit ekzekutiv për shkak të pamundësisë së KQZ-së për të caktuar një të ri.⁷ Kapaciteti operacional i administratës zgjedhore dhe aftësia e saj për të përmbushur mandatin u penguan për shkak të mungesës në menaxhim si dhe mungesës së stafit të përhershëm dhe të përkohshëm. Prandaj, KQZ-ja duhet të sigurojë emërimin me kohë të stafit në

⁵ Nga komunitetet joshumicë, një emërohet nga komuniteti serb i Kosovës, një nga komuniteti turk i Kosovës, një nga komuniteti boshnjak i Kosovës dhe një nga komuniteti i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve të Kosovës. Anëtarët aktualë janë emëruar sipas propozimeve politike si në vijim: dy anëtarë të propozuar nga *Lëvizja Vetëvendosje* (LVV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe nga një anëtar të propozuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), *Srpska Lista* (SL), *Vakat*, Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP) dhe Nisma e Re Demokratike për Kosovën (IRDK).

⁶ LZP përfshin masa mbrojtëse kundër ndërprerjes diskrecionale të mandatit të anëtarëve të KQZ-së. Një person mund të shërbejë si kryesues i KQZ-së për jo më shumë se dy mandate. Anëtarët partiakë kufizohen në maksimum tri mandate radhazi në KQZ. Një person nuk mund të shërbejë si anëtar i KQZ-së nëse: është anëtar i kuvendit ose i kuvendit kombëtar ose komunal, është kandidat për një post të zgjedhur publik, është zyrtar i lartë në një parti politike, është anëtar i komisionit publik të zgjedhjeve brenda ose jashtë Kosovës, nuk ka të drejtë vote, është anëtar i një organizate për vëzhgimin e zgjedhjeve, është shkarkuar nga administrata publike për shkelje të ligjit, është dënuar për veprë penale me dënim më shumë se një vit burgim brenda tre viteve të fundit, ose ka qenë zyrtar publik me status të veçantë në pesë vitet e fundit.

⁷ Kryeshefi ekzekutiv (drejtori i Sekretariatit) në të njëjtën kohë ka mbajtur postin e drejtorit të Zyrës.

pozitat kyçe për të mbështetur kapacitetet operacionale në fushat kryesore shumë përpara zgjedhjeve. Duke funksionuar brenda strukturave të KQZ-së, megjithëse gëzon pavarësi funksionale, Zyra e Regjistrimit, Certifikimit dhe Kontrollit Financiar të Subjekteve Politike (“Zyra”) është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e subjekteve politike për pjesëmarrje në zgjedhje dhe monitorimin dhe kontrollin e financave të subjekteve politike.

KKZ-të janë organe të përkohshme të zgjedhjeve me autoritet në territorin e një komune. Të emëruar më 13 shtator 2024, KKZ-të përbëheshin nga pesë deri në nëntë anëtarë.⁸ Ligji i jep kompetenca KKZ-ve, ndër të tjera, për administrimin e përgjithshëm të zgjedhjeve dhe numërimin në QKN, përcaktimin e ambienteve të votimit, përpilimin e listave të personelit zgjedhor dhe mbikëqyrjen e punës dhe trajnimit të tyre. Vëzhguesit e EU EOM-së i vlerësuan KKZ-të si përgjithësisht efikase dhe transparente. Ato rezultuan se kryesisht kishin komisionerë me përvojë të mirë dhe menaxhonin mirë përgatitjet teknike, pavarësisht sfidave të ndryshme. Disa KKZ shprehën pakënaqësi për komunikimin nga KQZ-ja, duke përmendur udhëzimet e vonuara dhe udhëzimet e pamjaftueshme, që shpesh rezultojnë në konfuzion për disa procedura dhe theksuan mungesën e koordinimit në terren, që ndonjëherë pengonte operacionet e tyre. Shumë KKZ shprehën keqardhje për shpërfilljen nga KQZ-ja të propozimeve të tyre në lidhje me emërimin e KVV-së, përcaktimin e ambienteve zgjedhore dhe përzgjedhjen e trajnerëve, duke humbur mundësinë për të përfituar nga njohuritë dhe përvoja lokale. Disa KKZ po ashtu informuan EU EOM-në për mbështetjen e pamjaftueshme nga administratat komunale për sa i përket hapësirës për zyra, transportit dhe nevojave të tjera.

Rekomandim me prioritet – Të kufizohen dhe specifikohen më tej përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretariatit të KQZ-së dhe komisioneve komunale zgjedhore për të decentralizuar vendimmarrjen e administratës zgjedhore aty ku është e përshtatshme dhe për të siguruar efikasitet dhe operacionet të zhvilluara me kohë.

Çdo KVV përbëhet nga pesë anëtarë, me mundësinë e rritjes së numrit të anëtarëve për të pasur një përfaqësim më të gjerë politik dhe etnik në nivel lokal.⁹ Legjislacioni mundëson përfaqësim domethënës të subjekteve politike të kualifikuara në organet zgjedhore të nivelit më të ulët, pa ofruar kritere mjaftueshëm të qarta për shpërndarjen e ulëseve për subjektet politike individuale, duke i dhënë kështu KQZ-së diskrecion të gjerë në përcaktimin e formulës së emërimit. Shpërndarja fillestare nuk arriti të përmbushë plotësisht kriterin ligjor për të pasqyruar rezultatet e zgjedhjeve të fundit parlamentare në nivelin komunal, në favor të disa subjekteve të reja që garojnë.¹⁰

Pas vendimit të PZAP-së, KQZ-ja e rishikoi shpërndarjen e pozitave në KVV dhe në ekipet e numërimit në 11 komuna, duke i ndarë ato kryesisht për subjektet politike të komuniteteve joshumicë. Shumë bashkëbisedues nga parti të ndryshme politike shprehën pakënaqësi për ndarjen

⁸ Secila nga 38 KKZ-të përbëhet nga një kryesues, zyrtari ekzekutiv komunal i emëruar nga KQZ-ja në bazë të përhershme dhe gjashtë anëtarë të emëruar nga subjektet politike të kualifikuara, të përfaqësuara në parlament ose në kuvendet komunale. KQZ-ja mund të vendosë për ndryshimin e numrit të anëtarëve në bazë të përfaqësimit politik të duhur në nivel lokal. Me rastin e emërimit të anëtarëve të KKZ-së, KQZ-ja do të synojë të sigurojë përfaqësim të barabartë të secilës gjini dhe të të gjitha komuniteteve me popullsi të konsiderueshme rezidente në komunën përkatëse.

⁹ Anëtarët e KVV-ve dhe ekipeve të numërimit emërohen nga subjekte politike të certifikuara bazuar në një formulë të përcaktuar nga KQZ-ja, duke reflektuar rezultatet nga zgjedhjet e fundit parlamentare në nivel qendror dhe komunal dhe të dhënat nga regjistrimi i fundit i popullsisë.

¹⁰ Kriteret shtesë ishin certifikimi për të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme dhe të dhënat e popullsisë nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2024.

përfundimtare të pozitive. Kontestet për këto pozita shkaktuan vonesa të konsiderueshme në emërimin dhe trajnimin e KVV-ve dhe ekipeve të numërimit në mbarë Kosovën, që u përkeqësua edhe më shumë për shkak të vështirësive të disa subjekteve politike për të siguruar propozime të mjaftueshme për KVV-të.

Rekomandim – Të përcaktohen kritere të qarta për emërimin e këshillave të vendotimeve dhe ekipeve të numërimit për të siguruar përfaqësim të drejtë dhe të gjerë të subjekteve politike dhe komuniteteve lokale.

b. Administrimi i zgjedhjeve

Pavarësisht se këto ishin zgjedhje të planifikuara në mënyrë të rregullt, gjë që i dha KQZ-së një afat kohor operativ prej mbi pesë muajsh, komisioni pati vonesa të konsiderueshme në disa aspekte të caktuara të përgatitjeve teknike dhe administrative, duke treguar dobësi në planifikimin operativ dhe në proceset e brendshme. Vështirësitë në procesin e prokurimit penguan seriozisht blerjen e pajisjeve teknike për qendrat e numërimit, përgatitjen e materialeve për edukimin e votuesve, si dhe operacionet logjistike për shpërndarjen dhe rikthimin e materialeve zgjedhore, përfshirë votat me postë për votimin jashtë Kosovës. KQZ po ashtu informoi EU EOM-në se kufizimet administrative për rekrutimin e personelit të përkohshëm ulën mundësinë e komisionit për të siguruar nivelet e duhura të stafit, veçanërisht për monitoruesit e fushatës, trajnerët dhe zyrtarët e regjistrimit të të dhënave. Këto rezultuan nga rishikimi i fundit i rregulloreve të brendshme, që synojnë rritjen e profesionalizmit dhe ekspertizës së personelit zgjedhor të përhershëm dhe të përkohshëm duke aplikuar kritere shtesë për kualifikim, të cilat megjithatë nuk korrespondojnë me realitetin e tregut vendor të punës. Rishikimi i këtyre kritereve, duke i përshtatur ato me përgjegjësitë aktuale të kategorive individuale të personelit, do të zgjeronte grupin e aplikuesve të mundshëm. Në planin afatgjatë, KQZ-ja mund të shqyrtojë mundësitë e krijimit të listave të personelit të përkohshëm të trajnuar, duke përfshirë studentë ose specialistë me certifikime profesionale.

Gjatë periudhës zgjedhore, KQZ mbajti seanca të rregullta publike dhe në përgjithësi i kanë publikuar vendimet e tyre me kohë. Megjithatë, disa seanca u reduktuan në vendime që merreshin vetëm me email dhe informacioni për shumicën e çështjeve të diskutuara ishte i kufizuar vetëm në shënime të shkurtra në procesverbal, duke ulur kështu transparencën dhe llogaridhënien e KQZ-së.¹¹ Për më tepër, disa udhëzime dhe vendime u miratuan relativisht vonë në proces, duke ndikuar në efikasitetin dhe kohën e përgatitjeve zgjedhore. Këto përfshinin procedurat e votimit dhe udhëzimet e hollësishme për operacionet dhe procedurat në qendrat komunale dhe qendrore të numërimit. Më tej, përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile tërhoqën vërejtjen për kufizimet në shkëmbimin e informacionit dhe përfshirjen e tyre nga KQZ-ja, krahasuar me ciklet e mëparshme zgjedhore. Gjatë gjithë periudhës zgjedhore, KQZ-ja humbi mundësinë për të përdorur kanalet e saj të krijuara të komunikimit, përfshirë faqen e saj të internetit dhe platformat e mediave sociale, për të përmirësuar qasjen e palëve të interesuara në informacionin me interes publik dhe për të luftuar dezinformatat e herë pas herëshme në lidhje me procesin. Veçanërisht pas ditës së zgjedhjeve, për shkak të problemeve teknike që ndikuan në transmetimin dhe përpunimin e rezultateve zgjedhore, KQZ-ja dështoi të informojë në mënyrë proaktive dhe të plotë publikun mbi natyrën dhe ndikimin e këtyre problemeve në menaxhimin e rezultateve dhe në të gjithë procesin e zhvilluar në QKN.

¹¹ Procesverballi i KQZ-së është në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe.

Rekomandim – Të zhvillohet një strategji gjithëpërfshirëse e komunikimit e KQZ-së dhe të publikohen të gjitha vendimet dhe informacionet përkatëse me interes publik me kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Si rezultat i emërimit të vonuar të KKV-ve dhe ekipeve të numërimit, si dhe aprovimit të vonuar të procedurave të numërimit, programi i trajnimit për personelin zgjedhor u vonua ndjeshëm dhe, në disa raste, sesionet u zhvilluan me nxitim, duke lënë pa shpjeguar në mënyrë të plotë disa aspekte të rëndësishme, përfshirë vlefshmërinë e fletëvotimeve. Në veçanti, trajnimi për procedurat e reja të numërimit të votave preferenciale u mbajt shumë afër ditës së zgjedhjeve, në disa zona vetëm në ditën kur duhej të fillonte numërimi, ndërsa disa ekipe të numërimit morën udhëzime të shkurtra vetëm pak para fillimit të numërimit. Cilësia e sesioneve të trajnimit për stafin zgjedhor të vëzhguara nga EU EOM ishte e ndryshme gjithandej Kosovës. Derisa shumica e seancave ishin informuese dhe interaktive, nganjëherë, temat kryesore si rregullorja e re për votimin e asistuar, rolet e anëtarëve të KVV-ve dhe procedurat e numërimit nuk u trajtuan në mënyrë të njëjtë, duke çuar në zbatimin jokonsistent të tyre në ditën e zgjedhjeve. Vëzhguesit e EU EOM-së gjithashtu vunë re disponueshmëri të kufizuar të materialeve trajnuese në gjuhën serbe dhe cilësi të dobët të përkthimit të atyre materialeve në dispozicion, me terminologji jokonsistente të përdorur, gjë që ndikoi në të kuptuarit e procedurave nga ana e të trajnuarve. Efektiviteti i trajnimit për të gjithë personelin e votimit dhe numërimit mund të rritet duke përdorur modulet e trajnimit në internet të disponueshme gjatë gjithë periudhës zgjedhore.

c. Rregullime të veçanta për votim

Votuesit që nuk mund të marrin pjesë në vendvotimet e tyre të rregullta për arsye shëndetësore, për shkak të gjendjes fizike, mbajtjes, burgimit ose rrethanave të tjera specifike, mund të kenë nevojë të votojnë jashtë vendvotimit duke përdorur një kuti mobile të votimit sipas dispozitave për votuesit me nevoja të veçanta.¹² Brenda periudhës prej 4 janarit deri më 5 shkurt, e zgjatur eventualisht deri më 6 shkurt, votuesit mund të aplikojnë personalisht në KQZ-të e tyre përkatëse ose përmes një platforme online të regjistrimit. Në përputhje me vendimin e KQZ-së, 108 ekipe mobile janë shpërndarë në mbarë Kosovën. Nga 4,060 votues të regjistruar, 2,670 votues hodhën votën e tyre në kutitë mobile të votimit. Sipas vëzhguesve të EU EOM-së, disa votues të regjistruar nuk patën mundësi të votonin për faktin se ekipet mobile nuk mundën të arrijnë tek ata me kohë.

Votuesit e regjistruar në listën përfundimtare të votuesve, të cilët për arsye objektive nuk mundën të votojnë në vendvotimin e caktuar, patën mundësi të votonin në njërën nga qendrat e caktuara për votim me kusht në cilëndo komunë brenda Kosovës. Për këto zgjedhje është krijuar nga një qendër e tillë votimi për secilën komunë. Për të parandaluar votimin e shumëfishtë, votat u vendosën në zarfe sigurie dhe më vonë u numëruan në qendrën e numërimit dhe rezultateve në qendër pas verifikimit të listave të votuesve. Në ditën e zgjedhjeve, shumica e qendrave të votimit me kusht përjetuan probleme teknike kur hynin në platformën digjitale për regjistrimin e votuesve për shkak të problemeve me kredencialet e përdoruesve dhe disa qendra, veçanërisht ato në komunat veriore, vunë në dukje një numër të pamjaftueshëm të fletëvotimeve në raport me numrin e lartë të votuesve që erdhën për të votuar. Sipas vendimit të KQZ-së, u shtypën gjithsej 28,500 fletëvotime për vendvotimet e përcaktuara për votim me kusht, të cilat u shpërndanë në qendrat e votimit në numra

¹² Tri kategori votuesish mund të aplikojnë për votim me kuti mobile: personat me aftësi të kufizuara fizike ose votuesit e mbyllur në shtëpi; votuesit e vendosur në institucione të veçanta (spitale, shtëpi të të moshuarve, burgje ose qendra paraburgimi); dhe votuesit në arrest shtëpiak ose në rrethana të veçanta (për çështje sigurie).

të vlerësuar bazuar në pjesëmarrjen e votuesve që votuan me kusht në komunat përkatëse gjatë zgjedhjeve të fundit.¹³ Nga 12,898 vota të hedhura me kusht, KQZ aprovoi 12,192 për t'i numëruar.

Votuesit që banojnë jashtë Kosovës patën mundësi të merrnin pjesë në zgjedhje pas regjistrimit të suksesshëm për votim jashtë Kosovës. Votuesit kishin tri mundësi për të hedhur votën e tyre: personalisht në misionet e zgjedhura diplomatike të Kosovës, me postë përmes dërgimit të fletëvotimeve në kutitë postare të hapura në vendin e tyre të banimit ose në një kuti postare brenda Kosovës. Votimi me postë u zhvillua nga 9 janari deri më 8 shkurt. Kutitë postare ishin hapur në 22 shtete dhe një në Kosovë.¹⁴ Në total, KQZ-ja mori 68,715 dërgesa postare me fletëvotime. Votat me postë u ruajtën nën vëzhgim në ambientet e Institucionit të Avokatit të Popullit, ku më 9 shkurt, stafi i KQZ-së filloi vlerësimin e tyre për të konstatuar nëse ato ishin dërguar nga votues të regjistruar dhe nëse ishin në përputhje me të gjitha kërkesat. Procesi i verifikimit është vërejtur të jetë efikas dhe i menaxhuar mirë. Pas përfundimit të verifikimit më 24 shkurt, 4,898 dërgesa postare u refuzuan për arsye të ndryshme, sipas rregullave të përcaktuara.¹⁵

Votimi personal jashtë Kosovës u prezantua rishtazi para këtyre zgjedhjeve. Pas regjistrimit, për shkak të numrit të vogël të votuesve në disa lokacione, si dhe për shkak të vështirësive logjistike dhe administrative, KQZ-ja vendosi të anulojë pesë qendra të planifikuara votimi jashtë vendit dhe i udhëzoi votuesit e prekur që të votojnë me postë. Më 8 shkurt, u hapën 43 vendvotime për 20,324 votues me të drejtë vote në përfaqësi diplomatike në 19 vende të huaja, nga të cilët votuan 15,348. KQZ-ja shprehu kënaqësinë me mbarëvajtjen e përgjithshme të votimeve personale jashtë Kosovës, duke e vlerësuar atë si proces të menaxhuar mirë pa ndonjë incident të madh.

d. Edukimi i votuesve

KQZ-ja nisi programin e saj të gjerë të edukimit të votuesve që para shpalljes zyrtare të zgjedhjeve, përmes takimeve personale, materialeve vizuale dhe audio-vizuale në media dhe në internet. Një pjesë e madhe e fushatës informuese kishte në shënjestër votuesit jashtë vendit, duke shpjeguar metodën e re të regjistrimit dhe opsionet se si të votojnë. Mundësia për të ndryshuar caktimin në një vendvotim dhe për të verifikuar të dhënat e regjistrimit të votuesve u shpjegua gjerësisht në disa materiale informuese për votuesit. Fushata zyrtare për edukimin e votuesve mbuloi tema si të drejtat e votuesve, pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, luftimin e gjuhës diskriminuese në bazë gjinore, edukimin mediatik dhe procedurat e ditës së zgjedhjeve. Përderisa KQZ-ja synonte të ofronte më shumë materiale edukative në pesë gjuhë, shumica e materialeve vizuale dhe audio-vizuale ishin kryesisht në dispozicion në gjuhën shqipe dhe serbe. Materialet edukative që shpjegonin se si të shënjohej fletëvotimi në gjuhë të tjera, përfshirë gjuhën boshnjake, rome dhe turke, u shfaqën në platformat shoqërore të KQZ-së pak para ditës së zgjedhjeve. Në aspektin pozitiv, KQZ-ja realizoi fushata informuese për votuesit në gjuhën e shenjave, siç kërkohet me ligj.

Përkundër këtyre përpjekjeve, shumë bashkëbisedues të EU EOM-së e konsideruan të pamjaftueshme fushatën zyrtare të informimit dhe edukimit të votuesve dhe shprehën dyshime mbi

¹³ 38,650 fletëvotime të tjera ishin paraparë për votim me kuti mobile dhe si fletëvotime rezervë.

¹⁴ Votuesit duhej të kishin votuar individualisht (një fletëvotim për një zarf të dërguar) dhe ta kishin postuar zarfin nga vendi ku janë të regjistruar, përndryshe zarfet me vota janë refuzuar. Votuesit në vendet ku nuk ishin hapur kuti postare duhej t'i dërgonin fletëvotimet e tyre në kutinë postare më të afërt me vendin e regjistrimit të tyre.

¹⁵ Këto përfshinin fletëvotimet e dërguara nga votues që nuk ishin regjistruar brenda periudhës së caktuar, dërgesat postare me më shumë se një zarf me fletëvotime, dërgesat postare pa zarfe me fletëvotim, dërgesat postare pa vërtetim regjistrimi, dërgesat postare pa pullë postare, dërgesat postare të dërguara në një vend ndryshe nga vendi i regjistrimit si dhe votat me postë të dërguara nga votuesi më shumë se një herë.

efektivitetin dhe shtrirjen e saj. Kjo, ndër të tjera, mund t'i atribuohet faktit se fushata edukuese u zhvillua kryesisht në media publike dhe në internet. Sipas vëzhguesve të EU EOM-së, fushata zyrtare e informimit nuk ishte aq e dukshme në terren dhe përfshirja e KKZ-ve në edukimin e votuesve mbeti e kufizuar, përkundër përgjegjësisë së tyre të re ligjore në këtë aspekt.

VII. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Shqetësimet për saktësinë e listës përfundimtare të votuesve vazhdojnë me gjithë përpjekjet e autoriteteve të Kosovës për të përmirësuar procesin e regjistrimit civil.

a. E drejta për të votuar

Të drejtën për të votuar e gëzojnë shtetasit të paktën 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve, përveç rasteve kur e drejta e tyre e votës kufizohet me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kufizimet e të drejtës për të votuar zbatohen edhe për personat të cilëve u është hequr aftësia për të vepruar. LZP-ja e re hoqi kriteret për të drejtën e votës që arsyetoheshin në rrethana të veçanta dhe për personat që ishin shpallur të paafte mendërisht me vendim gjyqësor të formës së prerë, gjë që e bën atë të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

b. Procedurat e regjistrimit të votuesve

Sistemi i regjistrimit të votuesve është pasiv dhe i centralizuar, me listën përfundimtare votuese të të gjithë votuesve me të drejtë vote të përpiluar nga KQZ-ja bazuar në të dhënat nga regjistri civil i menaxhuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) dhe në bazën e të dhënave të Departamentit për Lëshimin e Dokumenteve të Identifikimit (DLDI).¹⁶ Më 21 gusht 2024, KQZ aprovoi listën preliminare të votuesve (LPV), e cila përmbante të dhënat e 2,047,149 votuesve.¹⁷ Me ligj, lista e votuesve do të jetë e disponueshme për publikun, edhe jashtë viteve zgjedhore, për një periudhë të përcaktuar për të kundërshtuar të dhënat e regjistrimit të votuesve para zgjedhjeve. Edhe pse LZP-ja lejon që vëzhguesit e akredituar të kenë qasje në LPV sipas kërkesës gjatë periudhës zgjedhore, sipas interpretimit të KQZ-së, kjo dispozitë zbatohet vetëm për periudhën e shqyrtimit dhe kontestimit e cila përfundoi para fillimit të akreditimit të vëzhguesve. Kjo situatë u krijua pasi plani i aktiviteteve të KQZ-së për zgjedhjet e vitit 2025 e kishte caktuar një datë të fillimit të periudhës së akreditimit të vëzhguesve, pavarësisht nga dispozitat e LZP-së që garantojnë të drejtën e vëzhguesve për të përcjellë të gjithë periudhën zgjedhore. Për të siguruar qasje të vëzhguesve në të dhënat e regjistrimit të votuesve dhe mundësinë e tyre për t'i analizuar ato, këto afate duhet të harmonizohen.

LPV u publikua nga KQZ-ja në një platformë elektronike dhe ishte në dispozicion në zyrat e KKZ-së për shqyrtim publik nga data 29 gusht deri më 26 dhjetor 2024. Gjatë kësaj periudhe, votuesit patën mundësi të kërkonin korrigjime të pasaktësive dhe lëshimeve në regjistrimin e tyre, ricaktim në një qendër tjetër votimi brenda komunës ku janë regjistruar, si dhe të kundërshtojnë çdo regjistrim të votuesve që konsiderohet i pasaktë ose i pavlefshëm.¹⁸ Ndërsa LZP ofron mundësinë e kundërshtimit të regjistrimit të një votuesi nga një votues tjetër gjatë periudhës së shqyrtimit

¹⁶ ARC-së i kërkohet t'i japë KQZ-së të dhëna të përditësuara nga regjistri civil të paktën dy herë në vit. Pas shpalljes së zgjedhjeve, ekstraktet nga regjistri amzë janë ofruar nga ARC në baza mujore.

¹⁷ Në krahasim me listën e votuesve për zgjedhjet lokale të vitit 2021, gjithsej 39,665 votues u hoqën pasi u deklaruan të vdekur dhe 8,513 sepse kishin hequr dorë nga shtetësia e Kosovës.

¹⁸ KQZ-ja ka pranuar 17,219 kërkesa për ndryshim të qendrës së votimit, prej të cilave janë miratuar 16,503 dhe 11 kërkesa për përfshirje në listën e votuesve të cilat të gjitha u aprovuan në bazë të dokumentacionit të siguruar.

publik, në praktikë, votuesit patën qasje vetëm në të dhënat e regjistrimit të tyre personal, duke kufizuar mundësitë për një shqyrtim kuptimplotë. KQZ-ja publikoi vetëm të dhëna të ndara për numrin e votuesve të regjistruar sipas komunave dhe qendrave të votimit. Në përputhje me ligjin, subjektet politike të certifikuara dhe grupet e akredituara të vëzhguesve kanë gjithashtu të drejtë të kenë qasje në listën preliminare të votuesve nëpërmjet mjeteve elektronike.

Rekomandim – Të përditësohen dhe publikohen rregullisht të dhënat e regjistrimit të votuesve, të ndara sipas qendrave të votimit, dhe të mundësohet qasja e votuesve në të dhëna mjaftueshëm të detajuara të regjistrimit të votuesve, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave. Të zhvillohet një mekanizëm i qartë dhe i rregulluar mirë për të adresuar pasaktësitë e identifikuara dhe kundërshtimet përkatëse.

Legjislacioni për zgjedhjet kërkon nga KQZ-ja që të sigurojë pastrimin e listave të votuesve, përmes largimit të të dhënave të vjetruara dhe atyre të votuesve të vdekur. Për të verifikuar saktësinë e listës së votuesve dhe për të konfirmuar të drejtën e votuesve për të votuar, KQZ-ja mund të kërkojë informacione nga bazat e të dhënave dhe regjistrat e institucioneve kompetente, si Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Agjencia Kadastrale, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Administrata Pensionale (AP). Pas verifikimit të të dhënave të ofruara nga ASK dhe AP, gjithsej 915 votues që konsideroheshin të vdekur u hoqën nga lista e votuesve para miratimit të LPV-së. Në përputhje me vendimin e KQZ-së, në listën përfundimtare të votuesve nuk janë përfshirë shtetasit mbi 100 vjeç që nuk figurojnë në bazën e të dhënave të DLDI-së. Me informacionet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë larguar 160 persona të cilëve u ishte hequr zotësia ligjore.¹⁹

Më 4 janar, KQZ në mënyrë unanime certifikoi listën përfundimtare të votuesve me gjithsej 2,075,868 votues, një rritje prej 174,888 votuesish krahasuar me zgjedhjet e vitit 2021. Për shkak të migrimit dhe shpërnguljes, lista e votuesve përmban një numër më të madh të të dhënave sesa regjistrimi [i popullsisë] i vitit 2024, i cili përcakton popullsinë rezidente të Kosovës në 1,602,515 banorë.²⁰ Dallimi ndërmjet regjistrimit të votuesve dhe të dhënave të popullsisë mund t'i atribuohet metodologjisë së ndryshme të përpilimit të të dhënave, ku shtetasit e Kosovës që banojnë jashtë vendit u përjashtuan nga regjistrimi i popullsisë edhe pse ata mbeten të regjistruar ligjërisht në regjistrin civil, i cili shërben si bazë për listën e votuesve. Në mungesë të të dhënave zyrtare për diasporën e Kosovës, ARC vlerëson se rreth një milion kosovarë jetojnë jashtë Kosovës, bazuar në numrin e dokumenteve të lëshuara zyrtarisht për kosovarët që jetojnë jashtë vendit.

Me qëllim të përmirësimit dhe promovimit të regjistrimit civil, përfshirë edhe në mesin e grupeve të cënueshme nga komunitetet joshumicë, autoritetet e Kosovës filluan disa fushata informuese dhe zhvilluan disa programe për nxitjen e regjistrimit zyrtar.²¹ Megjithatë, bashkëbiseduesit e EU EOM-së në komunat me shumicë serbe të Kosovës shprehën shqetësime për heqjen e një numri të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës nga regjistri i votuesve për shkak të mangësive të

¹⁹ Sipas KQZ-së, ndërkohë që lista përmbante të dhëna për 251 persona, KQZ-ja nuk mundi të identifikonte si duhet 91 prej tyre për shkak të mungesës së numrit identifikues personal.

²⁰ Raporti i regjistrimit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregon se popullsia e moshës madhore (personat mbi 20 vjeç) përbën pak më shumë se 70 për qind, sipas të dhënave që nuk përfshijnë vlerësimin e popullsisë në katër komunat veriore.

²¹ Për shembull, në nëntor 2024, Ministria e Punëve të Brendshme shpalli një program për legalizimin e regjistrimit civil të atyre që posedojnë vetëm dokumente jo-kosovare, të lëshuar nga data 10 qershor 1999 deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi të MPB-së, brenda periudhës 1 shkurt 2025 dhe 30 prill 2025. Për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, MPB-ja në vitet e fundit ka filluar projekte për regjistrim pa pagesë gjatë muajit prill.

vazhdueshme në regjistrimin e tyre civil. ARC vlerësoi se mbi 90 për qind e popullsisë rezidente serbe të Kosovës është e përfshirë siç duhet në regjistrimin civil të Kosovës.

Përderisa lista e votuesve në përgjithësi konsiderohet si gjithëpërfshirëse nga shumica e palëve të interesuara, vazhdon të ketë shqetësime për listën e votuesve që përmban votuesit e vdekur, kryesisht për shkak të pengesave administrative në sigurimin e provave zyrtare për heqjen e tyre nga lista, me sistemin aktual që bazohet kryesisht në deklarinimin e vdekjeve nga të afërmit dhe duke lejuar kompetenca të kufizuara të institucioneve publike në proces. Për të përmirësuar sistemin e raportimit të vdekjeve dhe për të mbledhur të dhëna për personat e vdekur, ARC dhe KQZ bashkëpunojnë me disa shoqata fetare, kryesisht ato që janë të përfshira në shërbimet e varrimit.

Rekomandim me prioritet – Të bëhet një auditim gjithëpërfshirës i pavarur i listës së votuesve, përfshirë përmes analizës së brendshme të proceseve të regjistrimit dhe testimit statistikor dhe në terren, në konsultim me aktorët relevant për të adresuar shqetësimet mbi saktësinë dhe për të rritur besimin e publikut.

c. Regjistrimi për votim jashtë Kosovës

Votuesit jashtë Kosovës duhej të regjistroheshin paraprakisht qoftë për votim me postë ose personalisht. Gjatë periudhës nga 29 gushti deri më 26 dhjetor 2024, votuesit kishin mundësinë të aplikojnin ose me postë, ose përmes një platforme online, duke aplikuar një masë shtesë sigurie për identifikimin e votuesve me qëllim të parandalimit të regjistrimeve të mundshme të rrejshme dhe paraqitjes së rreme si votues nga persona të tjerë, në përputhje me rekomandimin e EU EOM-së së mëparshme.²² Për këto zgjedhje, KQZ-ja pranoi gjithsej 115,208 aplikime për regjistrim, nga të cilat KQZ aprovoi gjithsej 104.924 votues: 20,416 votues për të votuar personalisht dhe 84,508 votues që zgjedhën votimin me postë²³. Votuesit me të drejtë vote të cilët nuk u regjistruan për votim jashtë Kosovës mbetën në listën e votuesve dhe kishin mundësi të votonin në vendvotimin e tyre të rregullt, ose në qendrën e caktuar për votim me kusht.

VIII. CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE DHE KANDIDATËVE

Procesi përgjithësisht gjithëpërfshirës i certifikimit të kandidatëve u njollos nga votimi i ndikuar politikisht nga KQZ-ja për certifikimin e Srpska Lista.

a. E drejta për të kandiduar

Votuesit e regjistruar kanë të drejtë të kandidojnë për zgjedhje si deputetë të parlamentit. Personave të cilëve u është hequr e drejta e kandidimit me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të PZAP-së, që u është hequr zotësia për të vepruar, që janë dënuar me burgim mbi një vit për vepra të caktuara penale brenda tri viteve të fundit, që nuk kanë paguar gjobën e shqiptuar nga PZAP

²² Çdo aplikim duhej të shoqërohej me një kopje të një dokumenti identifikimi të vlefshëm (letërnjoftim, pasaportë ose patentë shoferi) dhe një foto të votuesit që mban dokumentin përkatës të identifikimit.

²³ Gjithsej 6,872 aplikacione janë hedhur poshtë për shkak të mungesës së fotografisë së votuesit duke mbajtur një dokument identifikues valid, mungesës së një dokumenti identifikues të vlefshëm, mospërputhjes së dokumentit identifikues me aplikuesin, dokumente të palexueshme, ose mungesës së ndonjë dokumenti identifikues të Kosovës. Pastaj, 3,412 aplikacione u anuluan ose me kërkesë të votuesve ose pas verifikimit nga KQZ të shumë votuesve që nuk i përkinin të njëjtës familje e kishin përdorur emailin e njëjtë. Votuesit patën mundësi të dorëzojnë serish aplikacionet në rast të identifikimit të mangësive (për shkak të kësaj, numri i përgjithshëm i aplikacioneve të refuzuara arriti në 13,370).

ose KQZ, ose që nuk i janë bindur urdhrit të PZAP-it, u ndalohej të kandidojnë. Përveç kësaj, të drejtat e kandidimit u kufizohen disa grupeve të caktuara të zyrtarëve publikë, ndërsa disa grupe të tjera të bartësve të funksioneve publike që aspirojnë për kandidaturë duhet të tërhiqen nga pozitat e tyre para certifikimit.

b. Certifikimi i kandidatëve

Për të marrë pjesë në zgjedhje, subjekti politik duhet të certifikohet për atë qëllim nga KQZ-ja. Kandidatët për deputetë mund të propozohen nga partitë politike, koalicionet dhe iniciativat qytetare, ose mund të jenë të pavarur. Të gjitha subjektet zgjedhore që synojnë të marrin pjesë në zgjedhje i nënshtrohen procesit të certifikimit pas dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm.²⁴ Subjektet politike joparlamentare duhet të mbështesin aplikacionet e tyre me nënshkrimet e së paku 1,000 votuesve të regjistruar dhe të paguajnë një tarifë certifikimi prej 1000 €. Votuesit mund të nënshkruajnë në mbështetje të vetëm një subjekti politik pjesëmarrës, gjë që bie ndesh me praktikën e mira ndërkombëtare. Numri i kandidatëve të përfshirë në listat e kandidatëve nuk mund të kalojë numrin maksimal të vendeve që do të ndahen, duke përjashtuar vendet e garantuara, për më shumë se dhjetë për qind, pra 110. Çdo subjekt politik duhet të theksojë në aplikacionin e tij nëse dëshiron të hyjë në garë për të fituar ndonjërin prej ulëseve të garantuara për përfaqësim të komuniteteve joshumicë. Ligji mandaton një përfaqësim minimal prej 30 për qind të secilës gjini në listat e kandidatëve, me një kandidat të secilës gjini të përfshirë në çdo tre kandidatë.

Legjislacioni parasheh një periudhë mjaftueshëm të gjatë për dorëzimin e aplikimeve për certifikim dhe mbledhjen e nënshkrimeve të votuesve në mbështetje të kandidaturave, si dhe u jep mundësi aplikuesve që të korrigjojnë çdo mangësi në dokumentet e dorëzuara brenda pesë ditësh pune nga pranimi i njoftimit. Për këto zgjedhje, periudha e certifikimit zgjati nga 1 shtatori deri më 11 dhjetor 2024. Të gjitha dokumentet e dorëzuara në mënyrë elektronike në një platformë online, u verifikuan nga Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike ("Zyra") e cila rekomandoi që të gjitha aplikimet të certifikohen. Sipas Zyrës, dy subjekteve politike iu kërkuar të dorëzonin sërish listat me nënshkrime mbështetëse për shkak të mungesës së numrit të kërkuar, pas pavlefshmërisë së disa të dhënave për shkak të të dhënave jo të plota dhe nënshkrimeve të dyshuara si të dyfishta. Subjektet e prekura, Opre Roma Kosova (ORK) dhe një koalicion i Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës (PDAK) dhe Lëvizjes për Bashkërendim (LPB) vunë në pikëpyetje metodologjinë e verifikimit dhe kriteret e aplikuara, që i perceptonin si pengesa të panevojshme për certifikimin e tyre. KQZ-ja nuk i publikoi vendimet e saj lidhur me certifikimin e kandidatëve ose rekomandimet përkatëse të Zyrës, duke cenuar kështu transparencën. Të gjitha listat e kandidatëve të dorëzuara me më shumë se dy kandidatë e përmbushnin kërkesën ligjore për një përfaqësim minimal gjinor.

Një proces që përndryshe ishte gjithëpërfshirës i certifikimit të garuesve në zgjedhje u njollos nga mosmarrëveshja e ndikuar politikisht e KQZ-së mbi certifikimin e kandidatëve të LS-së, që Zyra e kishte rekomanduar për aprovim. Ndonëse LZP-ja i jep Zyrës përgjegjësinë për certifikimin e garuesve në zgjedhje, me vendimin e KQZ-së që ka për qëllim të jetë si procedurë administrative për të konfirmuar certifikimin e atyre që përmbushnin kërkesat ligjore, dështimi i KQZ-së për të miratuar një vendim e faktikisht bllokoi procesin. Më 31 dhjetor 2024, PZAP udhëzoi KQZ-në që

²⁴ Edhe pse LZP (neni 12.2.9 dhe 16.3) e parasheh edhe certifikimin automatik të partive politike të regjistruara si garues në zgjedhje, përveç rasteve kur ato nuk kanë arritur të shlyejnë ndonjë gjobë të vendosur nga PZAP ose KQZ ose janë sanksionuar për mosrespektim të rregullores për funksionimin e partive politike (Neni 16.13). Më tej, dispozitat e LZP-së që detyrojnë partitë politike të regjistruara, të cilat nuk synojnë të garojnë në zgjedhje ose synojnë të kërkojnë të certifikohen brenda një koalicioni, që të njoftojnë Zyrën, në praktikë mbeten pa implikime aktuale në proces.

të certifikojë kandidatët e LS-së. Në total, KQZ certifikoi 28 subjekte politike dhe 1,279 garues të tyre që përfaqësonin 20 parti politike, pesë koalicione, dy iniciativa qytetare dhe një kandidat të pavarur.

IX. AMBIENTI I FUSHATËS

Fushatë e qetë dhe dinamike, megjithëse e karakterizuar me retorikë polarizuese, gjuhë të ashpër dhe ndërhyrje të huaja.

Fushata zyrtare zgjedhore 30-ditore filloi më 11 janar, duke përfunduar në orën 07:00 në ditën e zgjedhjeve. Të gjitha ngjarjet e fushatës të vëzhguara nga EU EOM-ja u vlerësuan ose si entuziaste ose të qeta pa ndonjë incident të madh të sigurisë. Vëzhguesit afatgjatë të EU EOM-së vëzhguan 75 ngjarje të fushatës në 22 komuna, përfshirë 23 tubime dhe 38 takime me qytetarë. Vëzhguesit e EU EOM-së nuk vërejtën ndonjë rast të frikësimit apo dhunës. Të gjitha takimet dhe tubimet publike duhej të miratoheshin nga autoritetet komunale dhe policia dhe nuk u vërejtën shqetësime lidhur me këtë procedurë.

Kandidatët raportuan se gëzonin lirinë e tubimit, shprehjes dhe lëvizjes gjatë gjithë fushatës. Subjektet kryesore politike shqiptare të Kosovës, përfshirë LVV-në, LDK-në, PDK-në, AAK-NISMA-n dhe Koalicionin për Familjen, bënë fushatë në mbarë Kosovën, e disa sporadike në veri. LVV, LDK dhe PDK organizuan shumicën e tubimeve të mëdha të fushatës. Aktivitetet derë më derë dhe takimet e vogla që synonin grupe të veçanta votuesish ishin metodat më të shpeshta të fushatës të përdorura nga të gjithë garuesit. Temat kryesore të fushatës ishin zhvillimi ekonomik, arsimi, anëtarësimi në NATO dhe BE, reforma gjyqësore dhe mirëqenia sociale, me LVV që fokusohej në mënyrë të veçantë në sovranitetin e Kosovës. Për garuesit serbë të Kosovës, mesazhet kryesore të fushatës ishin siguria dhe mbrojtja e të drejtave të serbëve brenda Kosovës.

Ndonëse fushata zgjedhore ishte e gjallë pa incidente serioz të raportuara, ajo u karakterizua nga përdorimi i gjuhës negative dhe nxitëse dhe sulmeve të ashpra verbale ndaj kundërshtarëve, shpesh nga LVV, LDK, PDK dhe AAK-NISMA, në ngjarje publike, debate dhe online. Përveç kësaj, është vërejtur ndërhyrja në fushatë edhe nga i dërguari i Shteteve të Bashkuara për misionet speciale, Richard Grenell, i cili kritikoi kryeministrin Albin Kurti se nuk është partner i besueshëm i Shteteve të Bashkuara.²⁵ Mesazhet e fushatës së Koalicionit për Familjen denigronin komunitetin LGBT+ dhe promovonin rolet tradicionale gjinore në shoqëri, nganjëherë duke nxitur urrejtje. Në javët e fundit të fushatës, retorika e ashpër dhe sulmet personale u intensifikuan, duke çuar në ankesa të shumta në PZAP në lidhje me gjuhën e fushatës.²⁶

Shumica e partive u angazhuan në fushata dinamike në internet, me Facebook-un si platformën kryesore, e ndjekur nga Instagram-i dhe TikTok-u. Fushata online ishte pasqyrim i tonit të ashpër të tubimeve dhe debateve, me video nga ngjarjet e fushatës që përbënin një pjesë të madhe të përmbajtjes së postuar.

²⁵ Richard Grenell, i dërguari presidencial i Shteteve të Bashkuara për misionet speciale, postoi në X (ish-Twitter) lidhur me kryeministrin e Kosovës Albin Kurti dhe zgjedhjet me 3 dhe 7 shkurt 2025. Në postimet e tij, Grenell kritikoi qeverinë e Kurtit si “jo të besueshme” dhe tha se “marrëdhëniet nuk kanë qenë kurrë në nivel më ulët”.

²⁶ Mbi 100 ankesa janë parashtruar në PZAP lidhur me gjuhën e përdorur në fushatë

Fushata në komunat e Kosovës me shumicë serbe ishte më e përmbajtur në krahasim me komunat e tjera. Katër nga gjashtë partitë serbe të Kosovës morën pjesë në tri debate të nxehta televizive, ku sulmet verbale dhe retorika nxitëse lanë në hije diskutimet thelbësore. Përveç kësaj, partitë më të vogla u përballën me sfida në fushatë për shkak të resurseve të kufizuara dhe gjobave të vendosura nga PZAP, pasi LVV-ja dorëzoi ankesa të shumta për vendosjen jo të duhur të materialit të fushatës.

Fushata e LS ishte më e spikatura nga partitë serbe të Kosovës, kryesisht përmes mediave të Serbisë dhe mediave të vogla serbe të Kosovës, në të cilat partitë e tjera politike nuk kishin fare, ose kishin qasje shumë të kufizuara. Bashkëbiseduesit shpesh raportuan se anëtarët e LS-së u bënë presion votuesve të cilët varen shumë nga ndihma sociale e Serbisë ose punësimi në institucionet e menaxhuara nga Serbia në komunat serbe të Kosovës. Më 3 shkurt, drejtori i Zyrës për Kosovë dhe Metohi njoftoi se do të shpërndahen nga 22,000 dinarë serb (170 €) në muaj për personat në gjendje të vështirë sociale dhe të papunë, duke filluar me 5,000 veta që do i marrin nga mesi i shkurtit.

Për më tepër, përkrahja e Presidentit Aleksandar Vuçiq për LS, nxitja nga ai e votuesve për të mbështetur këtë parti, si dhe deklaratat e paqarta të Kishës Ortodokse Serbe, përfaqësonin akte ndërhyrjeje në fushatën zgjedhore.

Vëzhguesit e EU EOM raportuan se subjektet politike joshumicë mbajtën tubime të vogla dhe fushata derë më derë brenda komuniteteve të tyre. Mesazhet e fushatës u fokusuan në çështje të cilësisë së jetës, pengesat gjuhësore në arsimin fillor për komunitetin boshnjak, regjistrimin në shkollë për vajzat rome, si dhe politikat e qeverisë ndaj komuniteteve joshumicë.

Ligji mandaton financimin publik për subjektet politike të përfaqësuara në parlament, dhe KQZ-në si përgjegjëse për shpërndarjen e këtyre fondeve. Megjithatë, KQZ e tejkaloi autoritetin e saj duke vënë këtë vendim për votim nga anëtarët e saj lidhur me disbursimin e fondeve për muajin janar dhe shkurt. Për shkak të refuzimit të përfaqësuesve të LVV-së në KQZ për të aprovuar vendimin, garuesit politikë duhej të zhvillonin fushatat e tyre pa këto fonde.

Përveç kësaj, ligji përfshin një dispozitë jo të detyrueshme për alokimin e fondeve publike shtesë për aktivitetet e fushatës për të gjitha subjektet politike të certifikuar.²⁷ Kjo dispozitë nuk u zbatua, duke krijuar një terren të pabarabartë mes garuesve, veçanërisht për subjektet e vogla politike nga komunitetet joshumicë.

Rekomandim – Të bëhet një dispozitë për ta bërë të detyrueshme ndarjen e fondeve publike për të gjitha subjektet politike të certifikuar për të krijuar kushte të barabarta.

Keqpërdorimi i resurseve publike nga shumë garues është raportuar nga vëzhguesit dhe bashkëbiseduesit e EU EOM në nivel qendror dhe komunal. Shumica e ankesave të paraqitura për keqpërdorim të resurseve shtetërore kanë të bëjnë me përdorimin e objekteve publike, kryesisht ndërtesave qeveritare dhe komunale për qëllime të fushatës.²⁸ Megjithatë, gjatë gjithë fushatës,

²⁷ Financimi publik mund të ofrohet për fushatat zgjedhore, nga të cilat 90 për qind ndahen në bazë të numrit të vendeve në Kuvendin e Kosovës, ndërsa pjesa e mbetur prej 10 për qind u ndahet proporcionalisht të gjitha subjekteve politike të regjistruara rishtazi të certifikuar nga KQZ-ja për zgjedhje. Kjo shumë nuk e kalon 0.05 për qind të buxhetit vjetor. Dispozita është bërë jo e detyrueshme me ndryshimin e LFPP të vitit 2013.

²⁸ Rastet e keqpërdorimit të resurseve shtetërore në kundërshtim me Kodin e Sjelljes sipas nenit 36, LZP: për shembull, shih [Vendimet PZAP Nr 55/2025, 61/2025, 63/2025, 69/2025, 84/2025, 89/2025, 145/2025, 181/2025, 259/2025, 259/2025, 2025, 2025 312/2025, 353/2025, 368/2025, 412/2025, 434/2025, 449/2025](#)

“Zyra” në kuadër të KQZ-së nuk monitoroi aktivitetet e fushatës në mënyrë sistematike në të gjitha komunat për shkak të sfidave me rekrutimin dhe paaftësisë institucionale. Vëzhguesit u rekrutuan ose vetëm për gjysmën e periudhës së fushatës, ose nuk u rekrutuan fare, gjë që rezultoi që një pjesë e fushatës zgjedhore të mbetej pa u vëzhguar.

Rekomandim – Të sigurohet monitorimi sistematik dhe efektiv i fushatës zgjedhore duke përfshirë terma adekuatë të referencës dhe procedura të rekrutimit për monitoruesit e fushatës së KQZ-së.

X. FINANCIMI I FUSHATËS

Rregulloret për financimin e fushatës parashikojnë transparencë në të ardhurat dhe shpenzimet e partive politike, financimin publik dhe përcaktojnë kufij të shpenzimeve, por mangësitë, përfshirë mungesën e raportimit të ndërmjetëm dhe mosrregullimin e financimit të palëve të treta, minojnë llogaridhënien.

Financat e partive dhe të fushatës rregullohen me Ligjin e 2010 për Financimin e Subjekteve Politike (LFPP) i ndryshuar për herë të fundit në vitin 2022, me LZP dhe me Rregulloret e KQZ-së.²⁹ Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (“Zyra”) është autoriteti kompetent mbikëqyrës për financimin politik dhe të fushatës.

Financimi publik për aktivitete të rregullta politike është në dispozicion për subjektet politike të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, të ndara çdo vit dhe proporcionalisht me numrin e vendeve të tyre. Mund të sigurohet financim publik shtesë për fushatat zgjedhore, nga të cilat 90 për qind ndahen në bazë të numrit të vendeve në Kuvendin e Kosovës, ndërsa 10% e mjeteve të mbetura ndahen proporcionalisht për subjektet politike të posa regjistruara dhe të certifikuar për zgjedhje nga KQZ.³⁰ Sipas bashkëbiseduesve të EU EOM-së, kjo dispozitë nuk është zbatuar asnjëherë.

Në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare, kuadri ligjor përcakton kufizime në shpenzimet e fushatës. Zyra është përgjegjëse, *ndër të tjera*, për kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe monitorimin dhe kontrollin e financave të subjekteve politike, hetimin e shkeljeve dhe vendosjen e gjobave, përveç raportimit të tyre tek autoritetet përkatëse. Për këto zgjedhje parlamentare shpenzimet e fushatës ishin kufizuar në 2,047,149 €.³¹ LZP-ja përfshinë ndalimin e përdorimit të burimeve ose resurseve të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror apo lokal për të mbështetur subjektet politike në zgjedhje.³²

Të ardhurat e subjekteve politike mund të burojnë nga aktivitetet e tyre si persona juridikë jofitimprurës, pagesa e anëtarësisë në parti dhe donacionet private. Shumica e subjekteve politike i raportuan EU EOM-së se të ardhurat e tyre për fushata kryesisht vijnë nga financimi publik, pagesa

²⁹ Domethënë, Rregullorja e KQZ-së Nr. 06/2024 për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Financiare të Subjekteve Politike dhe Rregulloren e KQZ-së Nr. 07/2024 për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës Zgjedhore dhe Pasqyrat Financiare.

³⁰ Financimi publik për fushatën nuk mund të kalojë 0.05 për qind të buxhetit vjetor. Dispozita është bërë jo e detyrueshme me ndryshimin e LFPP të vitit 2013.

³¹ Vendimi i KQZ-së 01/1242/24 i datës 21 gusht 2024 parasheh që subjektet politike të kenë të drejtë të shpenzojnë €1.00 për votues.

³² Neni 36.3, LZP.

e anëtarësisë dhe donacionet e kufizuara private. Donacionet mund të jenë monetare ose në natyrë, përkatësisht mallra ose shërbime. Ligji nuk parashikon asnjë kufizim konkretisht për të ardhurat rreth periudhës së fushatës, por donacionet për një subjekt të vetëm politik nga individë dhe persona juridikë janë të kufizuara respektivisht në 2,000 € dhe 10,000 €, ndërsa donacionet nga burime të huaja dhe anonime, organizata joqeveritare, bamirëse dhe fetare, ndërmarrje publike dhe kompani private me kontrata të prokurimit publik, janë të ndaluara.³³

LZP modifikoi kërkesat për deklarim financiar të fushatës duke caktuar një periudhë që fillon 90 ditë para zgjedhjeve për të deklaruar të ardhurat dhe shpenzimet përkatëse të subjekteve politike që marrin pjesë në zgjedhje. Afati i fundit për raportimin të hyrave dhe shpenzimeve të fushatës nga subjektet politike caktohet 30 ditë kalendarike pas certifikimit të rezultateve. Nuk ka asnjë kërkesë në ligj për raportimin e ndërmjetëm të të ardhurave dhe shpenzimeve të garuesve gjatë periudhës së fushatës dhe kandidatëve individualë, dhe financimi i fushatës nga palët e treta mbetet i parregulluar, duke kufizuar mundësinë e shqyrtimit publik para ditës së zgjedhjeve që bien ndesh me parimin e transparencës.³⁴ Shpenzimet e pa-raportuara nga palët e treta pakësojnë më tej transparencën dhe llogaridhënien e financimit të fushatës që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.³⁵

Rekomandim – Të zbatohet raportimi i ndërmjetëm dhe zbulimi i të ardhurave të garuesve gjatë periudhës së fushatës. Raportimi përfundimtar duhet të përfshijë të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve individualë dhe subjekteve që bëjnë fushatë për garuesit (palët e treta).

XI. KONTESTET ZGJEDHORE

Gjykim efektiv i ankesave të shumta, megjithatë, kuadri ligjor solid për trajtimin e kontesteve zgjedhore do të përfitonte nga një shtjellim i mëtejshëm.

a. Parashtrësas dhe ankesat dhe forumet përkatëse

Ligji përcakton rregulla të qarta, udhëzime dhe afate të arsyeshme kohore për kontestimet e palëve përkatëse të interesit në lidhje me futjen ose heqjen nga listat preliminare të votuesve, kundër certifikimit të partive dhe kandidatëve, në faza të ndryshme të votimit dhe numërimit, si dhe rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësas (PZAP) është forumi kryesor për gjykimin e kontesteve lidhur me zgjedhjet, përfshirë ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së të parashikuara në mënyrë specifike nga LZP. Vendimet e PZAP-së mund të ankimohen në Gjykatën Supreme (GJS) në rast se gjoba është më e lartë se 5,000 euro ose nëse preken të drejtat themelore. PZAP është organ i përhershëm i pavarur prej 11 anëtarësh të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që aktualisht funksionon me dhjetë gjyqtarë në bazë të Rregullores për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosijes së Ankesave, e rishikuar në vitin 2024.³⁶ PZAP ka

³³ Neni 5 i LFPP dhe Rregullorja e KQZ-së Nr. 7/24.

³⁴ Raportet e ndërmjetme i referohen paraqitjes së burimeve të financimit dhe shpenzimeve gjatë periudhës së fushatës, për t'u dhënë mundësi organeve mbikëqyrëse të adresojnë çdo problem të mundshëm të mundshëm të hasur para ditës së zgjedhjeve.

³⁵ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), neni 25; ICCPR, Komenti i Përgjithshëm 25, para. 20 i Komitetit të të Drejtave të Njeriut; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC), neni 6(2), 7(3) dhe 7(4).

³⁶ LZP ka rritur numrin e anëtarëve të PZAP-së nga gjashtë në 11; dy anëtarë u emëruan vetëm më 24 janar.

hedhur poshtë rastet që ishin jashtë kompetencave të tij dhe i ka referuar 17 raste në KPM, e cila është përgjegjëse për vendosur për ankesat kundër mediave.

b. Parashtrës dhe ankesat parazgjedhore

Që nga fillimi i procesit, PZAP ka marrë mbi 600 raste. Gjatë periudhës parazgjedhore, ankesat kundër vendimeve të KQZ-së i referoheshin krijimit të qendrave të votimit jashtë Kosovës (të parashtruara nga LVV dhe të hedhura poshtë).³⁷ Një ankesë ishte lidhur me certifikimin e subjekteve politike e parashtruar nga LS kundër njoftimit të KQZ-së për refuzimin e certifikimit të saj. PZAP ka lejuar ankesën duke vendosur në favor të ankuesit.³⁸ Certifikimi i më pastajmë i LS-së çoi në një ankesë tjetër nga LVV për mosrespektim të procesit të rregullt të vendimmarrjes së KQZ-së, e cila u hodh poshtë nga GJS për mungesë të bazës juridike.³⁹ Katër ankesa lidhur me mos-shpërndarjen e fondeve publike nga KQZ-ja u hodhën poshtë për mungesë të kompetencës. Ankesat tjera të parashtruara nga subjektet politike të komuniteteve joshumicë kanë të bëjnë me emërimin e stafit të votimit dhe numërimit, ku PZAP udhëzon KQZ-në që të rishqyrtojë formulën e përfaqësimit të aplikuar sipas kriterëve të përcaktuara me ligj. Një tjetër ankesë e paraqitur nga KDTP-ja kundërshtoi dizajnin e fletëvotimit dhe u hodh poshtë pasi ishte parashtruar pas afatit.

Gjatë fushatës u parashtruan rreth 400 ankesa në PZAP për shkelje të kodit të mirësjelljes gjatë fushatës, të cilat rezultuan me gjoba substanciale të shqiptuara ndaj subjekteve politike, veçanërisht për shkelje të përsëritura, në vlerë totale prej rreth €642,000. Shkeljet kryesisht kishin të bënin me vendosjen e materialit të fushatës në vende publike, nxitjen e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes, keqpërdorimin e funksioneve dhe resurseve publike dhe shfrytëzimin e fëmijëve në fushatë. Shumica e rasteve janë paraqitur nga LVV, e ndjekur nga PDK dhe LDK, ndërsa shumica janë paraqitur kundër LVV-së, LDK-së dhe PDK-së. Në disa raste, subjektet politike janë gjobitur më shumë se një herë për të njëjtën shkelje për shkak të dështimit për korrigjimin e saj në mungesë të një urdhri përkatës të PZAP.⁴⁰ Në raste të tjera kur subjektet ndërmorën masa korrigjuese gjatë procedimit, paneli e konsideroi këtë një faktor lehtësues për uljen e gjobës përkatëse.⁴¹ Gjoba u vendosën edhe për subjektet politike për shkelje të kodit të mirësjelljes nga mbështetësit e pretenduar. Kriteret që përcaktonin shumën e gjobave të vendosura nuk ishin gjithmonë të qarta për garuesit, të cilët në disa raste ankoheshin për trajtim të njëanshëm nga PZAP. Për gjobat më të ulëta nën 5,000 € të shqiptuara ndaj subjekteve më të vogla politike me më pak resurse nuk mund të bëhet ankesë, duke i privuar ato nga mjetet juridike efektive.

Rekomandim me prioritet – Të përfshihen përkufizime të qarta ligjore për termat kyç, përfshirë ato që lidhen me gjuhën nxitëse dhe përcaktimin e “përkrahësit të subjektit politik” në procesin zgjedhor. Të vendosen kriteret të qarta për përcaktimin e gjobave proporcionale të zbatueshme për shkeljet e Kodit të Mirësjelljes nga subjektet politike.

c. Parashtrës dhe ankesat pas zgjedhjeve

Gjatë procesit të numërimit janë parashtruar rreth 27 ankesa nga subjektet politike në lidhje me procesin e numërimit në QKN, nga të cilat gjashtë janë aprovuar duke i shpall të vlefshme fletëvotimet e kontestuara, dhe pjesa tjetër u hodhën poshtë si të parakohshme ose u refuzuan për

³⁷ Nëntë ankesa u bashkuan, Vendimi Nr. 1/2024.

³⁸ Vendim i PZAP Nr. 12/2024.

³⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Nr. 60/2024.

⁴⁰ Për shembull, Vendimet e PZAP-së Nr. 459/2025, 347/2025.

⁴¹ Për shembull, Vendimet e PZAP-së Nr. 58/2025, 89/2025, 153/2025, 167/2025, 187/2025, 191/2025, 285/2025, 432/2025.

mungesë të provave. Në disa raste, ankuesit u këshilluan se mund t'i kontestojnë rezultatet përfundimtare kur ato të shpallen nga KQZ.⁴² Pesë nga ankesat në lidhje me procesin e ndjekur në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) u parashtruan nga LVV (3), një kandidat i AAK-së (1) dhe PDAK-LpB (1), për parregullsi të pretenduara gjatë numërimit. Tri u hodhën poshtë, një u refuzua dhe një u miratua duke çuar në rinumërim.⁴³

Përkundër vëllimit të rasteve dhe sfidave me resurset, PZAP shihet se e ka përmbushur mandatin e vet për të vendosur për parashtruesat dhe ankesat gjatë fazave të ndryshme të procesit në mënyrë profesionale dhe në përputhje me afatet ligjore me vendime mjaftueshëm të arsyetuara dhe të publikuara me kohë. Ligji përcakton afate të qarta kohore dhe hapa të artikuluar mirë për shqyrtimin e kontesteve zgjedhore. Megjithatë, për të siguruar siguri juridike, ai do të përfitonte nga një qartësi më e madhe, veçanërisht sa i përket përkufizimit dhe interpretimit të shkeljeve të caktuara, kriterëve për përcaktimin e shumave të gjobave të shqiptuara, si dhe zgjerimit të së drejtës për të ankimuar vendimet në KQZ.

Rekomandim – Të lejohet kontestimi i të gjitha vendimeve ose veprimeve të KQZ-së në kuadër të procesit zgjedhor dhe të ankimohen të gjitha vendimet e PZAP-së në Gjykatën Supreme.

Para shpalljes së rezultateve, GJS-ja kishte pranuar 43 ankesa kundër vendimeve të PZAP-së, prej të cilave 30 ishin hedhur poshtë ose refuzuar duke konfirmuar vendimet e PZAP-së. Gjashtë ankesa janë aprovuar duke shfuqizuar vendimin e PZAP-së dhe shtatë janë aprovuar pjesërisht duke ulur gjobat e shqiptuara në shkallë të parë.

d. Veprat penale në lidhje me zgjedhjet

Kodi Penal përfshin një numër të madh veprash penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet, me një sërë gjobash dhe dënimesh me burg për çështje më të rënda, përfshirë aktet e ryshfetit ose blerjes së votës.⁴⁴ Nuk ka pasur incidente serioze gjatë fushatës apo ditës së zgjedhjeve. Shtatë raste, katër gjatë fushatës dhe dy në ditën e zgjedhjeve arritën në Prokurorinë Publike, të cilat në kohën e shkrimit të raportit ishin ende nën hetim.⁴⁵ Një rast vëzhguar drejtpërdrejt nga vëzhguesit e BE-së dhe i hetuar nga policia në QKN Gjakovë kishte të bënte me gjetjen e një kopjeje të mostrës së fletëvotimit të përdorur për trajnim në kutinë e votimit dhe mospërputhjet midis numrit të nënshkrimeve dhe numrit të votave të hedhura. Asnjë rast i shqyrtuar nga PZAP nuk përmbante elemente të veprës penale, prandaj asnjë nuk është referuar në Prokurori.

XII. MEDIAT

Fushatë dinamike në media pa mbikëqyrje të plotë rregullative, ndërkohë që mungesa e debateve kuptimplota dhe bojkotimet e mediave penguan mundësinë e votuesve për të bërë një zgjedhje të informuar.

⁴² Për shembull, Vendimi i PZAP [Nr. 591/2025](#) (QKN Skenderaj), [Nr. 598/2025](#) (QKN Pejë), [Nr. 599/2025](#) (QKN Prishtinë), [Nr. 600/2025](#) (QKN Gjakovë), [Nr. 603/2025](#) (Pejë). Në bazë të nenit 106.3, LZP.

⁴³ Shih Vendimin A Nr. 623/202. Shih po ashtu Vendimin A Nr. 634/2025.

⁴⁴ Kreu XVIII, Veprat penale kundër të drejtave të votimit, Kodi Penal.

⁴⁵ Dy për shkeljen e fshehtësisë së votës përmes mediave sociale për votimin jashtë Kosovës (neni 215, Kodi Penal), dy për shkeljen e vendimit të lirë të votuesve (neni 215, Kodi Penal) në Mitrovicë dhe dy për pengimin e ushtrimit të të drejtës së votimit (neni 209, Kodi Penal) dhe sulm ndaj personit zyrtar (neni 402, Kodi Penal) in Prishtinë.

a. Mjedisi mediatik

Peizazhi mediatik i Kosovës është pluralist dhe dinamik por i fragmentuar, i formësuar nga ndarjet etnike dhe sfidat institucionale. Shqiptarët e Kosovës, serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera joshumicë kryesisht jetojnë në sfera të ndryshme informacioni, të ndara nga një hendek gjuhësor që shumë pak media përpiqen ta kapërcejnë. Televizioni mbetet burimi kryesor i informimit, me 19 kanale televizive tokësore dhe 45 kablllore, kryesisht që transmetojnë jashtë Prishtinës. Dominojnë transmetuesit privat, edhe pse transmetuesi publik, Radio Televizioni i Kosovës (RTK), luan një rol të rëndësishëm me katër kanale televizive dhe dy stacione të radios. Nga kanalet televizive private, tetë kanë një audiencë të konsiderueshme: RTV21, Kohavizioni (KTV), Klan Kosova, TV Dukagjini, T7, ATV, Kanal 10 dhe TëVë1.

Transmetuesi publik, RTK, është përballur me sfida politike dhe operative, përfshirë shqetësimet për pavarësinë e tij në vitin 2023⁴⁶ dhe një polemikë të vitit 2024 në lidhje me publikimin e një artikulli që pretendonte se disa media në gjuhën shqipe në Kosovë po financoheshin nga Serbia, gjë që çoi në dorëheqjen e udhëheqësve.⁴⁷ Ndryshimet e mëvonshme të rregullave mundësuan emërimin e një ushtruesi të detyrës së drejtorit të përgjithshëm, duke parandaluar një paralizim të operacioneve të RTK-së, por bordit të RTK-së tani i mungon kuorumi, me vetëm katër nga 11 anëtarët e mbetur.⁴⁸ Anëtarët e bordit të RTK-së zgjidhen nga parlamenti me shumicë të thjeshtë votash, duke e bërë që organin e tij qeverisës të varet nga orari i Kuvendit dhe duke e përafruar atë potencialisht me interesat e partisë në pushtet.

Rekomandim – Të sigurohet qëndrueshmëria financiare dhe rritja dhe pavarësia e transmetuesit publik, të ndahet buxheti e tij sipas ligjit dhe të zgjidhen me kohë anëtarët e bordit të tij nga Kuvendi i Kosovës.

RTK1 dhe RTK2 që transmetojnë në gjuhën shqipe dhe serbe janë të detyruara të transmetojnë 15 për qind të programeve të tyre në gjuhët joshumicë. Megjithatë, burimet e kufizuara financiare të RTK2 ndikuan negativisht në cilësinë e programit të saj dhe në kapacitetin e saj për të zhvilluar programe të reja. Kjo çoi në hezitimin e garuesve për t'u përfshirë në përmbajtjen e RTK2 që kishte të bënte me zgjedhjet. RTK2 organizoi tri debate, por LS nuk mori pjesë. Në përgjithësi, garuesit politikë nuk e konsiderojnë RTK2 si platformë të duhur për të përçuar mesazhet e tyre. Përveç kësaj, pesë kanale televizive lokale në gjuhën serbe funksionojnë me mbulueshmëri të kufizuar, duke lënë partitë joshumicë dhe ato serbe pa një kanal transmetues efektiv për të bërë fushatë. Mediat në gjuhën serbe të financuara nga OJQ-të (*KoSSev*, *Radio Kim*, *Radio Kontakt plus*) synonin të ofronin mbulim të balancuar të subjekteve politike serbe të Kosovës bazuar në aktivitetet e tyre, megjithatë, me një fokus të kufizuar në fushatën zgjedhore në përgjithësi.

Rekomandim – Të forcohen stacionet televizive dhe të radios të transmetuesit publik për t'i shërbyer në mënyrë efikase të gjitha komuniteteve joshumicë. Të ofrohet mbështetje financiare,

⁴⁶ Më 23 shkurt 2023, pesë organizata ndërkombëtare të mediave nënshkruan së bashku një letër drejtuar kryeministrit Albin Kurti, duke protestuar kundër emërimit të një aktivisti të partisë në pushtet si drejtor i televizionit publik RTK. Shih letrën [këtu](#).

⁴⁷ Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën 2024 gjithashtu vuri në dukje nevojën për të adresuar shqetësimet në lidhje me llogaridhënien redaktuese dhe pavarësinë e RTK-së.

⁴⁸ BE-ja, në një letër publike të datës 24 dhjetor 2024, i ka bërë thirrje Kuvendit të Kosovës që të zgjedhë anëtarët e bordit të RTK-së dhe KPM-së.

teknike dhe për ngritje të kapaciteteve për të siguruar transmetim cilësor të shërbimit publik me përmbajtje të ndryshme në gjuhën serbe dhe në gjuhët joshumicë.

Rreth 89 radiostacione transmetojnë kryesisht përmbajtje argëtuese në Kosovë dhe luajtën një rol të vogël si burim informimi politik gjatë fushatës.⁴⁹ Në Kosovë nuk ka media të shkruara, pasi mediat e njohura të shkruara kanë kaluar në internet. Mediat lokale kishin ndikim të kufizuar për shkak të audiencës së vogël, kufizimeve financiare dhe hezitimit për të mbuluar çështjet zgjedhore. Vëzhguesit e EU EOM-së raportuan, dhe rezultatet e monitorimit të mediave tregojnë një mbulim të pamjaftueshëm të subjekteve politike joshumicë, ndërsa kandidatët preferuan mediat sociale në vend të mediave tradicionale. Varësia nga fondet komunale ngriti shqetësime për pavarësinë redaktuese, ku interesat politike dhe të korporatave nxisnin autocensurën⁵⁰ për të mbajtur marrëdhënie të preferuara me mbajtësit e pushtetit politik në një treg të kufizuar reklamash.

Gazetarët në përgjithësi ishin të lirë për të mbuluar fushatën; megjithatë, incidentet e pengimit dhe kërcënimeve u shtuan me vazhdimin e fushatës, duke nxitur Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës (AGK) të ngre shqetësime rreth veprimeve dhe retorikës që kishin në shënjestër gazetarët dhe mediat.⁵¹ AGK po ashtu dënoi sulmet verbale ndaj mediave nga kryeministri Kurti dhe zyrtarët e tjerë të LVV-së.⁵² Përfaqësuesit e mediave ia atribuuan armiqësinë në rritje ndaj shtypit përdorimit të gjuhës nxitëse nga anëtarët e partisë LVV gjatë fushatës, e cila nxiste dhunë ndaj mediave.

b. Korniza ligjore për media

Liria e shprehjes garantohej me nenin 40 të Kushtetutës së Kosovës, i cili e përkufizon atë duke përfshirë të drejtën “për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush” me kufizime të mundshme të përcaktuara në nenin 40 (2) të Kushtetutës, duke përcaktuar se kjo liri mund të kufizohet në rastet e nevojshme “për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësisë në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare”. Kushtetuta e Kosovës e garanton “lirinë dhe pluralizmin e mediave” dhe e ndalon censurën.⁵³ E drejta e lirisë së mendimit është e garantuar (neni 24), dhe shpifja dhe diskreditimi dekriminalizohen, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave (LKPM) rregullojnë mediat gjatë fushatës zgjedhore.⁵⁴ LZP parashikon një Kod të Mirësjelljes që do të nxirret nga KPM-ja, i cili do të zbatohet për të gjithë gazetarët, redaktorët, menaxherët e transmetimeve dhe botuesit për të gjitha aspektet e mbulimit dhe reklamimit të fushatës. Kjo kornizë plotësohet me ligje të tjera që mbrojnë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe pavarësinë e

⁴⁹ Nga 89 radiostacione, 58 prej tyre transmetojnë në gjuhën shqipe, 22 në gjuhën serbe, 3 në gjuhën boshnjake, 2 në gjuhën turke, 2 në gjuhën gorane, 1 në gjuhën rome dhe 1 transmeton në shumë gjuhë. Dy stacionet të radios publike (Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2) transmetojnë rreth 15 për qind të programit të tyre në gjuhët jo-shumicë.

⁵⁰ Kosova është renditur në vendin e 75-të nga 180 vende në Indeksin e Lirisë së Shtypit të RSF në vitin 2024, një rënie nga vendi i 56-të në vitin 2023.

⁵¹ Më 25 janar, AGK dënoi pengimin e një ekipi të lajmeve të Nacionale në një tubim të LVV-së në Malishevë, ku gazetarëve ju tha se "Jeni më keq se Serbia!". Më 8 shkurt, persona të panjohur kanë vandalizuar portalin Veriu.info, duke thyer dritaret e objektit të tij. Në ditën e zgjedhjeve, Klan Kosova raportoi nëntë raste në AGK, lidhur me fyerje verbale, ofendime dhe pengesa fizike gjatë raportimit nga qendra të ndryshme të votimit, kryesisht nga përkrahës të LVV-së. "Klan Serbia" dhe komente të tjera fyese në disa raste kërkuan ndërhyrjen e policisë.

⁵² <https://www.agk-ks.org/en/cases/denimi-i-gjuhes-se-zedhenesit-te-vetevendosjes-arlind-manxhuka/>

⁵³ Neni 42 i Kushtetutës.

⁵⁴ Kapitulli VIII (neni 47-53) dhe XVII (neni 107-109), LZP, Ligji Nr. 04/L-044– LKPM, (GZ nr. 5/05.04.2012)

medias.⁵⁵ Një rregullore e re e miratuar në dhjetor 2023 nga KPM-ja synon të rregullojë pronësinë e mediave⁵⁶, transparencën dhe koncentrimin. Megjithatë, në përputhje me dispozitën Kushtetuese që përcakton se “pluralizmi i medias është i garantuar”, nevojitet një standard apo parim ligjor për të udhëhequr një rregullim të tillë. Për më tepër, 44 mediat online, të regjistruara si biznese ose OJQ, janë nënshkruese të Kodit të Etikës, të nxjerrë nga Këshilli i Mediave të Shkruara i Kosovës, një organ vetërregullues.

Ligji i ri kundërthënës për KPM-në, i miratuar më 11 korrik 2024, ka nxitur debat për mungesën e masave mbrojtëse procedurale dhe mekanizmave të vetërregullimit. Ai zgjeron numrin e anëtarëve të bordit të KPM-së në 11, shtrin mbikëqyrjen ndaj mediave online dhe ndalon pronësinë e mediave nga subjektet politike.⁵⁷ U ngritën shqetësime edhe për kriteret e paqarta për bllokimin dhe sanksionimin e përmbajtjeve të dëmshme në internet. Më 19 korrik, partitë opozitare PDK dhe LDK e kontestuan ligjin në Gjykatën Kushtetuese, dhe vendimi nuk është marrë ende. Edhe AGK-ja ka dhënë komente dhe ka kërkuar një opinion publik nga presidentja e Kosovës. Ligji i ri nuk adreson mungesën e mbajtjes me kohë të zgjedhjeve për anëtarë të bordit të KPM-së dhe as politizimin e mundshëm të autoritetit rregullator. Përkundrazi, ai përcakton që kryetari i KPM-së të zgjidhet drejtpërdrejt nga Kuvendi i Kosovës, në kundërshtim me standardet evropiane dhe praktikatat e mira.⁵⁸

Rregullore gjithëpërfshirëse qeverisin mbulimin mediatik të fushatës zgjedhore, siç përshkruhet në Rregulloren Zgjedhore të KQZ-së Nr. 07/2024 dhe rregulloren e KPM-së KPM-2024/03 për Rregullimin e Obligimeve të Ofruesve të Shërbimeve Mediale. Këto rregulla përshkruajnë mbulimin e balancuar me lajme për kandidatët, vendosin kufizime në reklamat politike me pagesë, mandatojnë ofrimin e kohës së transmetimit falas për subjektet që përdorin reklama me pagesë dhe kërkojnë që transmetuesit të dorëzojnë raporte javore në KPM për oraret e tyre të reklamave. LQP po ashtu ndalon mbulimin mediatik të aktiviteteve të fushatës dhe sondazheve të opinionit prej fillimit deri në përfundim të votimit, duke përfshirë rezultatet e sondazheve 24 orë para mbylljes së qendrave të votimit.

KPM-ja monitoroi mbulimin e fushatës sipas planit të saj të veprimit dhe shqyrtoi 102 raste të shkeljeve të mundshme të mediave dhe u ka dërguar njoftime për shkelje të paktën 88 mediave deri më 24 shkurt, por nuk mundi të shqiptojë gjopa për shkeljet e mediave për shkak të mungesës së kuorumit.⁵⁹ Si rezultat, KPM-ja nuk ka qenë në gjendje të zbatojë plotësisht rregullat dhe rregulloret,

⁵⁵ Pra, Ligji nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, Ligji Nr. 04/L-046 për Radio dhe Televizionin e Kosovës, Ligji Nr. 02/L-65 për të Drejtën Civile kundër Shpifjes dhe Fyerjes, Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligji Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve.

⁵⁶ Rregullorja e KPM-së 03.2023 mbi pronësinë dhe koncentrimin e të licencuarve të KPM-së detajon rregullat e pronësisë dhe synon të sigurojë pluralizëm mediatik për të parandaluar koncentrimin e medias. Aktualisht ekzistojnë dy baza të të dhënave mbi pronësinë e mediave publike në Kosovë; një që mbahet nga KPM: <https://regjistri.kpm-ks.org/>, dhe Monitoruesi tjetër i Pronësisë së Medias i krijuar nga BIRN: <https://kosovo.mom-gmr.org/en/>.

⁵⁷ Ndërsa anëtarët e bordit të KPM-së duhet të përfaqësojnë grupe të ndryshme, rritja e numrit të anëtarëve të bordit nuk siguron pavarësi politike apo emërime me kohë nga Kuvendi, siç kritikohet nga organizatat ndërkombëtare.

⁵⁸ Rekomandimi i KiE Rec (2000) 23 I/3 thekson se “Rregullat që qeverisin autoritetet rregullatore për sektorin e transmetimit, veçanërisht anëtarët e tyre, janë një element kyç i pavarësisë së tyre. Prandaj, ato duhet të përcaktohen në mënyrë që t'i mbrojnë nga çdo ndërhyrje, veçanërisht nga forcat politike apo interesat ekonomike.”

⁵⁹ Më 17 janar, KPM-ja ndryshoi Rregulloren e saj të Punës për të lejuar zgjedhjen e një kryesuesi të ri para se mandati i kryesuesit aktual të skadonte më 21 janar. Ky veprim ngriti shqetësime ligjore, ku shoqatat e gazetarëve vendor dhe ndërkombëtarë e denoncuan atë si “ndikim politik”. Instituti i Kosovës për Drejtësi ka ushtruar një padi më 28 janar 2025, duke kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të anulohet ndryshimet në Rregulloren e Punës të KPM-së dhe vendimin për emërimin e kryesuesit të ri të organit rregullator.

dhe mediat u përballën me pasiguri të zgjatur në lidhje me ndëshkimet e mundshme.⁶⁰

Rekomandim me prioritet – Të emërohen të gjithë anëtarët e KPM-së me kohë dhe përmes një procesi të përzgjedhjes konkurruese dhe transparente.

c. Gjetjet e monitorimit të mediave

Kanalet televizive me mbulueshmëri në mbarë Kosovën ishin mediat më aktive që mbulonin fushatën bazuar në oraret e para-planifikuara për fushatën zgjedhore.⁶¹ Rreth gjysma e kohës së transmetimit në kohën kryesore të transmetimit të stacioneve televizive të monitoruara ishte ndarë për përmbajtjet lidhur me zgjedhjet.⁶²

Megjithëse ligji kërkon që mediat që ofrojnë reklama politike me pagesë të ndajnë edhe kohë transmetimi falas, shumë garues nuk e shfrytëzuan këtë dispozitë, duke çuar në një zgjatje të kohës së transmetimit me pagesë në fund të fushatës.⁶³ Për më tepër, përtej reklamave me pagesë, ligji lejon ofrimin e kohës së transmetimit të sponsorizuar, ku transmetuesve u kërkohet të dorëzojnë ditarë javor në KPM për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat.⁶⁴

Bojkoti i LVV-së ndaj mediave private Klan Kosova, Dukagjini dhe T7 ka ngjallur kritika nga shoqatat e gazetarëve në Kosovë dhe në arenën ndërkombëtare. Bojkoti i mediave nga LVV, i kombinuar me debatet që shpesh përfshinin vetëm përfaqësues të një partie, e kufizoi mundësinë e votuesve për të krahasuar drejtpërdrejt kandidatët kryesorë. Përveç kësaj, as LDK nuk mori pjesë në debatet e organizuara nga transmetuesi publik. Fatkeqësisht, nuk u zhvilluan debate midis kandidatëve kryesorë, duke kufizuar aftësinë e votuesve për të bërë një zgjedhje të informuar mbi platformat e kandidatëve dhe premtimet e fushatës.⁶⁵

Media shtetërore RTK1 ka përmbushur detyrimet e saj ligjore dhe ka siguruar mbulim të drejtë të lajmeve për partitë kryesore politike, LVV, PDK, LDK dhe AAK-NISMA.⁶⁶ Partitë e tjera politike përbënin të gjitha së bashku shtatë për qind të mbulimit të përgjithshëm mediatik, duke përfshirë një kandidat të vetëm të pavarur.⁶⁷ Secilit subjekt politik iu ofrua kohë e barabartë me pagesë dhe pa pagesë, siç parashihet me ligj, dhe koha e transmetimit të sponsorizuar kryesisht ishte në formën e mbulimit të tubimeve të fushatës së LVV dhe një nga PDK.

Televizionet private Dukagjini, Klan Kosova dhe T7 i caktuan më shumë kohë PDK-së dhe LDK-së në kohën e përgjithshme të transmetimit dhe më pak LVV-së. ATV gjithashtu i ndau shumicën e kohës së vet të transmetimit për zgjedhjet AAK-NISMA-s dhe PDK-së. Presidentja u mbulua me

⁶⁰ Shumica e shkeljeve të proceduara nga KPM-ja kishin të bënin me përdorimin e gjuhës fyese ose vulgare nga aktorët politikë gjatë fushatës dhe transmetimit në media, me mosidentifikimin e reklamave politike, praninë e fëmijëve në fushatë, mos dërgimin e ditarëve javor në KPM, dhe dhjetë raste për shkeljen e heshtjes zgjedhore në ditën e zgjedhjeve.

⁶¹ Njësia për monitorimin e mediave (MMU) e EU EOM-së monitoroi në mënyrë sasiore dhe cilësore pesë kanale televizive: RTK1 (publik), Dukagjini (privat), Klan Kosova (privat), T7 (privat) dhe ATV (privat) gjatë tërë fushatës zyrtare, nga 11 janari deri më 8 shkurt, gjatë transmetimit në kohën kryesore: ora 18:00-24:00.

⁶² Shih grafikun 1 të Aneksit 2.

⁶³ Koha e shënuar e transmetimit pa pagesë u evidentua vetëm në Klan Kosova gjatë dy ditëve të fundit të fushatës, më 7 dhe 8 shkurt, nga AAK-NISMA, Koalicioni për Familjen, LDK dhe PDK.

⁶⁴ KPM evidentoi shkelje të kërkesës për dorëzimin javor të ditarit në të paktën 47 raste gjatë katër javëve të fushatës.

⁶⁵ Pati njëfarë shqyrtimi jopartiak gazetaresk të politikave të kandidatëve, veçanërisht në emisionin “Debat Pernime” në Dukagjini, ku premtimet zgjedhore sfidohen përmes verifikimit të fakteve në kohë reale.

⁶⁶ Shih Grafikun 6.

⁶⁷ Shih Grafikun 4.

një kohë të papërfillshme në kapacitetin e saj institucional, ndërsa kryeministri dhe anëtarët e qeverisë u shfaqën herë pas here duke bërë fushatë në rolet e tyre zyrtare.⁶⁸

Mbulimi editorial përfshinte intervista me kandidatë, emisione të debatit dhe programe me analistë.⁶⁹ Partitë opozitare shpesh përqendroheshin në kritikimin e partisë në pushtet dhe debateve u mungonte analiza e thellë dhe krahasimi i programeve të partive i bazuar në merita. Toni i mbulimit mediatic në të gjitha kanalet televizive të monitoruara ishte kryesisht neutral ose pozitiv, me raste të komenteve negative nga gazetarët ndaj LVV-së, qeverisë dhe kryeministrit Kurti në Klan Kosova, T7 dhe në dy raste në Debat Plus të Dukagjinit.⁷⁰

Faqet e monitoruara të internetit në gjuhën serbe në përgjithësi i dhanë përparësi LS-së në mbulimin e tyre zgjedhor dhe mbuluan dukshëm më pak partitë opozitare serbe.⁷¹ Kosova Online botoi rreth 450 artikuj për zgjedhjet, në të cilët LS u përmend rreth 70 herë, ndërsa pesë partitë më të vogla politike serbe u përmendën vetëm 1-5 herë.⁷²

XIII. MEDIAT SOCIALE

Fushata online pasqyroj tonin agresiv të debateve publike dhe tubimeve, por i mungonte përmbajtja.

a. Ambienti në rrjete sociale

Shkalla e penetrimit të internetit në Kosovë vlerësohet të jetë mbi 95% dhe rreth gjysma e popullsisë është e pranishme në platformat e mediave sociale. Facebook-u dhe Instagram-i janë platformat më të popullarizuara, me mbi 800,000 dhe 600,000 përdorues secila. TikTok është treta, me një numër gjithnjë e më të madh përdoruesish, duke tejkaluar 500,000. X ka një bazë të vogël përdoruesish në Kosovë, por është i popullarizuar ndër gazetarë, politikanë dhe komentues, kryesisht për t'u angazhuar me audiencë ndërkombëtare.

TV mbetet burimi kryesor i informacionit për kosovarët (82 për qind e kosovarëve), i ndjekur nga mediat sociale (65 për qind) dhe portalet e lajmeve në internet (45 për qind).⁷³ Pandemia e COVID-19 çoi në mbylljen e të gjitha mediave të shkruara në Kosovë dhe mediumet e lajmeve janë kthyer gjithnjë e më shumë drejt mediave sociale për të arritur tek audiencia e tyre. Ngjashëm me mediat tradicionale, komunitetet shqiptare dhe serbe kryesisht jetojnë në sfera të ndara informative, ku ngjarjet shpesh interpretohen nga një këndvështrim etnik. Temat që marrin shumë vëmendje nga

⁶⁸ Më 24 janar, kryeministri Albin Kurti bëri fushatë për projektet e reja për KEK-un dhe termocentralin Kosova A. Ai po ashtu bëri fushatë edhe në Forumin Ekonomik të Davosit, foli për opozitën, derisa e përfaqësonte Kosovën në kapacitetin e tij institucional. Ai gjithashtu u premtoi subvencione studentëve të mjekësisë gjatë fushatës dhe Ministria e Mjedisit dha një tender prej 32 milionë eurosh për banesa sociale, një projekt i premtuar në vitin 2021.

⁶⁹ Shih Grafikun 2.

⁷⁰ Shih Grafikun 5.

⁷¹ Njësia për Monitorimin e Mediave të EU EOM-së monitoroi në mënyrë cilësore uebfaqet e Kosovo Online, TV Most, Kossev, Radio KIM dhe Radio Kontakt Plus.

⁷² Faqja e internetit e TV Most i kushtoi rreth 90 artikuj zgjedhjeve, duke e paraqitur LS-në në rreth 50 artikuj, ndërsa partitë e tjera serbe dhe shqiptare më pak se pesë herë. Kossev i kushtoi rreth 80 artikuj zgjedhjeve, ku më së shumti u përmend LS, 18 herë, ndjekur nga SL me 9 herë, SNP me 7 herë dhe një artikull që përfshinte GI NP-në Rreth 50 artikuj të Radio Kim që lidhen me zgjedhjet përmendën LS-në 9 herë, SD-në 6 herë, SNP-në 3 herë dhe PKS-në 1 herë. Mbulimi i zgjedhjeve nga Radio Kontakt Plus ndoqi një model të ngjashëm.

⁷³ <https://kosovo.mom-gmr.org/en/context/media-consumption/>

një komunitet, në disa raste mungojnë plotësisht ose përmenden vetëm në mënyrë marginale në hapësirën e rrjeteve sociale të komunitetit tjetër.⁷⁴

Krypometër dhe *Hybrid.info*, dy organizata shqiptare të Kosovës, zhvillojnë programe të verifikimit të fakteve, me mbështetjen e BE-së dhe donatorëve të tjerë ndërkombëtarë. Ndërsa ata demaskojnë përmbajtje nga rrjetet sociale dhe artikuj si nga burime shqiptare ashtu edhe serbe, ata publikojnë vetëm në gjuhën shqipe. Rreth 40 keqinformime dhe dezinformime janë demaskuar nga këto dy organizata prej fillimit të janarit deri në ditën e zgjedhjeve, përfshirë 11 hulumtime të rreme të opinionit, të postuara kryesisht në TikTok. Alternativna, një media serbe e lajmeve me bazë në Mitrovicën veriore, gjithashtu bën verifikime rastësore të fakteve për lajmet në serbisht.

Që nga fillimi i janarit e deri me 9 shkurt, RT Balkan dhe Sputnik Srbija të mbështetura nga Rusia kanë publikuar rreth 60 artikuj për zgjedhjet, disa me rrëfime që pretendonin manipulime kundër komunitetit serb. Shumë prej këtyre artikujve janë demaskuar menjëherë nga *Hibrid.info*. Shtrirja e tyre në mediat sociale është e kufizuar nga fakti se ato janë të pranishme vetëm në X, ku postimet e tyre rrallëherë arrijnë të kenë më shumë se 2,000 përdorues.

b. Korniza ligjore për mediat sociale

Të drejtat digjitale në Kosovë rregullohen me Kushtetutë, me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) dhe akte të tjera plotësuese ose nënligjore. Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes dhe pluralizmin e medias, si dhe garanton të drejtat e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave.

Privatësia dhe mbrojtja e të dhënave mbulohen nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (MDHP), i cili deri diku është në përputhje me GDPR. Ligji për MDHP parashikon standarde për marrjen, analizën dhe menaxhimin e të dhënave nga qeveria dhe sektori privat, i cili përcakton rregulla të qarta për mënyrën se si qeveria dhe sektori privat duhet të trajtojnë të dhënat personale. Agjencia e Informacionit dhe Privatësisë (AIP), organi rregullator për mbrojtjen e të dhënave, vetëm kohëve të fundit ka zhvilluar kapacitetet e saj operative, duke kryer 302 inspektime vitin e kaluar dhe duke zgjidhur 707 ankesa në vitin 2024 (nga 97 në 2023). Kosova gjithashtu ka legjisllacion që mbron neutralitetin e rrjetit dhe qasjen e duhur në internet. Një Strategji Kombëtare e Sigurisë Kibernetike është miratuar, por ende nuk është vënë në funksion.

Platformat e funksionojnë kryesisht sipas politikave dhe mekanizmave të tyre rregullues. Megjithatë, përmbajtja si gjuha e urrejtjes ose nxitja e dhunës bie nën juridiksionin e kodit penal, ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, dhe gjatë zgjedhjeve, Kodit të Sjelljes për Subjektet Politike.

c. Gjetjet e monitorimit të mediave sociale

Njësia e Monitorimit të Mediave Sociale gjithsej përcolli afro 900 faqe në media sociale që u takonin partive politike, kandidatëve, mbështetësve, OJQ-ve, mediave dhe institucioneve. Është vlerësuar një mostër prej 5,262 postimesh, të përzgjedhura në bazë të viralitetit të tyre, që vinin nga 246 faqe që u përkisnin partive politike, kandidatëve, katër kandidatëve kryesorë dhe mbështetësve.

Të gjitha subjektet politike garuese dhe mbi gjysma e kandidatëve mbajtën të paktën një llogari në media sociale dhe bën fushatë në mediat sociale me intensitet të ndryshëm. Facebook-u ishte

⁷⁴ Mbyllja e strukturave paralele rreth mesit të janarit dhe vendimi i KQZ-së për përbërjen e VV-ve në disa komuna serbe kanë marrë shumë më tepër vëmendje në mediat sociale serbe. Të njëjtat ngjarje tërhoqën dukshëm më pak interesim në hapësirën e mediave sociale shqiptare.

platforma më e përdorur, pasuar nga Instagrami dhe TikTok-u. LVV-ja, AAK-ja dhe LDK-ja i prezantuan liderët e tyre si “kandidatë për kryeministër”, ndërsa PDK-ja e kishte Bedri Hamzën, kryetarin e Mitrovicës Jugore, si kandidat për kryeministër. Përveç Bedri Hamzës, tre kandidatët e tjerë për kryeministër kanë më shumë ndjekës në rrjetet sociale sesa partitë e tyre.

Fushata në mediat sociale në përgjithësi nuk kishte përmbajtje. Gati tri të katërtat (74 për qind) e postimeve të monitoruara nuk përmbanin ndonjë mesazh specifik. Ato ose promovonin imazhin dhe emrin e partisë ose kandidatit ose pasqyronin ngjarje fizike të fushatës. Pothuajse gjysma e postimeve të monitoruara (41 për qind) përbënin video, zakonisht nga ngjarjet e fushatës, të cilat ndonjëherë përmbanin gjuhën nxitëse të përdorur në mitingje (4,4 për qind e postimeve të monitoruara përmbanin sulme ndaj kundërshtarëve politikë). PZAP ka shqiptuar 38 gjoba, me gjithsej €273,000, për shkelje të Kodit të Sjelljes për Subjektet Politike në mediat sociale gjatë periudhës së fushatës, përfshirë tri gjoba ndaj Koalicionit për Familjen për gjuhën e urrejtjes kundër komunitetit LGBT+. Në ditën e zgjedhjeve, EOM vëzhgoi 15 postime që thyenin heshtjen zgjedhore si dhe gjashtë reklama politike që vazhduan të shfaqeshin edhe pas orës 7:00 të mëngjesit. PZAP po ashtu ka shqiptuar edhe shtatë gjoba për fushatë në rrjetet sociale në ditën e zgjedhjeve.

Reklamat në Facebook dhe Instagram u përdorën gjerësisht nga 12 partitë politike, nga mbi 400 kandidatë dhe nga disa faqe të mbështetësve dhe mediave. Mbi 250,000 € u shpenzuan për promovimin e më shumë se 7,000 reklamave lidhur me zgjedhjet në Facebook dhe Instagram, duke përfshirë reklama nga palët e treta. Mbi dy të tretat e reklamave u shpërndanë te burrat (shih grafikun 11 në Shtojcën 3), me grupmoshën 18-24 që ishte e vetmja me një shënjestrim më të balancuar gjinor, duke sugjeruar se votuesit më të rinj janë më pak të ndikuar nga modelet tradicionale të votimit. Shpenzuesi më i madh individual ishte *Opre Roma Kosova*, i cili shpenzoi mbi €20,000 në reklama por siguroi vetëm 383 vota. PDK kryeson shpenzimet e përbashkëta të partive dhe kandidatëve me €102,785, e pasuar nga LDK me 90,373 € dhe LVV me €34,443. Pesë shpenzuesit kryesorë përbëjnë 97 për qind të totalit, duke theksuar fuqinë e tyre financiare në krahasim me garuesit më të vegjël. 60 faqe mediatike dhe mbështetëse shfaqën rreth 693 reklama politike të palëve të treta, përfshirë 57 reklama negative që përmbanin komente sarkastike mbi nivelin e mbështetjes që gëzojnë kandidatët dhe njerëzit me të cilët shoqërohen, duke i paraqitur në kontekste negative ose mbishkrime insinuate.

Rekomandim – Të bëhet një përpjekje e koordinuar ndërmjet mediave, shoqërisë civile dhe kompanive të teknologjisë për të përforcuar iniciativat ekzistuese për verifikimin e fakteve, për të rritur shtrirjen e tyre duke publikuar përmbajtjen e tyre në gjuhët e komuniteteve joshumicë dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre.

XIV. PJESEMARRJA E GRAVE

Një rekord prej 39 nga 45 gra u zgjodhën drejtpërdrejt në Kuvendin e Kosovës, por dominimi mashkullor i fushatës dhe gjuha nxitëse drejtuar kandidateve femra ishin tipare të rëndësishme të zgjedhjeve parlamentare.

Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë Konventën e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe Konventën e Stambollit, kanë përparësi ndaj

ligjeve të Kosovës.⁷⁵ Barazia gjinore është e sanksionuar në Kushtetutë, LZP (2023) dhe Ligjin për Barazinë Gjinore (2015). Megjithatë, korniza ligjore që rregullon përfaqësimin politik të grave duhet të harmonizohet edhe më shumë.

LZP kërkon që listat e partive për zgjedhjet parlamentare të përbëjnë të paktën 30 për qind të gjinisë më pak të përfaqësuar, duke i detyruar subjektet politike të vendosin një kandidat femër dhe një mashkull në çdo grup prej tre kandidatësh për listë. LZP-ja po ashtu ofron një stimulim financiar për të rritur përfaqësimin e grave duke dedikuar një fond shtesë prej një për qind të shumës së fondeve publike për ta alokuar për subjektin politik për secilin mandat të fituar nga gratë mbi kuotën. Nga ana tjetër, Ligji për Barazinë Gjinore përcakton një kuotë gjinore prej 50 për qind në të gjitha organet legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore.⁷⁶ Për më tepër, ai e përcakton Agjencinë për Barazi Gjinore për të koordinuar zbatimin e dispozitave të ligjit dhe për të siguruar respektimin e ligjeve të Kosovës në Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Neni 14 i ligjit po ashtu kërkon që partitë politike të promovojnë pjesëmarrjen e barabartë të burrave dhe grave brenda organeve të tyre qeverisëse. Organizatat e të drejtave të njeriut kanë avokuar që kuota prej 50 për qind të bëhet standarde, por një vendim i Gjykatës Kushtetuese më 26 dhjetor 2024, ka theksuar se neni 28 i LZP-së për kuotat gjinore është në përputhje me Kushtetutën, duke përcaktuar kuotën e saj si një prag minimal.

Në zgjedhjet e vitit 2025 garuan 443 gra, duke përbërë 34.6 për qind të 1,279 kandidatëve të certifikuar.⁷⁷ Ndonëse kjo është në përputhje me kuotën gjinore prej 30 për qind, ajo paraqet vetëm një rritje të papërfillshme në krahasim me zgjedhjet e mëparshme parlamentare. KQZ-ja nuk publikon të dhëna të ndara sipas gjinisë për regjistrimin e votuesve dhe kandidatëve.

Kuvendi i Kosovës në largim përfshinte 40 gra, një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, ndërsa gratë kryesuan dy nga 14 partitë parlamentare. Në anën pozitive, shtatë nga 14 komisionet parlamentare udhëhiqeshin nga gratë dhe grupi parlamentar i LVV-së, më i madhi në Kuvendin e Kosovës, udhëhiqej nga një grua. Rezultatet e publikuara nga KQZ tregojnë se Kuvendi i ri i Kosovës do të përfshijë 45 gra, 39 prej të cilave janë zgjedhur pa aplikimin e kuotës gjinore, një përmirësim në krahasim me vitin 2021.⁷⁸

Ndërsa garueset nga subjektet kryesore politike ndonjëherë përbënin titujt e ngjarjeve të fushatës, burrat kishin një prani dominuese në mitingje, duke përfaqësuar një shumicë të konsiderueshme të pjesëmarrësve dhe folësve. Rreth 28 për qind e pjesëmarrësve dhe 29 për qind e folësve në 75 mitingjet e vëzhguara nga EU EOM ishin gra. Në anën pozitive, vëzhguesit vërejtën se LVV, PDK, AAK, Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP) dhe Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) zhvilluan aktivitete të fushatës drejtuar grave aktiviste. Disa takime të LVV-së dhe PDK-së po ashtu kishin gratë si folëse kryesore, duke përfshirë Albulena Haxhiun, Ministre e Drejtësisë dhe Vlora Çitakun, ish-ministre e Punëve të Jashtme.

⁷⁵ CEDAW është sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës dhe Kuvendi i Kosovës miratoi një amendament të Kushtetutës në vitin 2020, i cili i jep efekt të drejtpërdrejtë Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - Konventa e Stambollit (CETS Nr.210).

⁷⁶ Neni 6.8.

⁷⁷ Nga subjektet politike shqiptare të Kosovës, lista e kandidatëve të LVV-së kishte përqindjen më të madhe të grave me 37.3 për qind, ndërsa Partia Lëvizja Inovative Turke (YTHP) kishte përqindjen më të madhe të grave nga listat e kandidatëve të komuniteteve joshumicë me 52 për qind.

⁷⁸ Nga 39 femra të zgjedhura para aplikimit të kuotës, 22 janë nga LVV, 5 nga PDK, 4 nga LDK, 3 nga LS, 2 nga AAK, 1 nga KDTP, 1 nga NDS dhe 1 nga SDU. Ndërsa legjislatura në largim e Kuvendit të Kosovës përfshinte 40 gra, në zgjedhjet e vitit 2021 fillimisht u zgjodhën 44 gra, 34 prej tyre pa kuotë.

Diskursi politik, veçanërisht në platformat e mediave sociale dhe televizionet e transmetuara, ishte shpesh armiqësor ndaj grave kandidate që kritikoheshin për pamjen, gjendjen emocionale ose statusin e tyre martesor.⁷⁹ Kandidatet femra kishin më pak resurse se homologët e tyre meshkuj, më pak mbulim mediatik dhe u shfaqën në më pak debate televizive. Sipas monitorimit të EU EOM-së, gratë u paraqitën 14.8 për qind të kohës në orarin kryesor të transmetimit në pesë kanale televizive prej 11 janarit deri më 8 shkurt. Subjektet politike shqiptare të Kosovës u kritikuan edhe nga organizatat e shoqërisë civile për promovimin e një vizioni patriarkal të rolit të gruas në shoqëri në manifestet e tyre të fushatës, duke i konsideruar gratë përmes rolit të tyre riprodhues, në vend që të mbështesin barazinë gjinore në tregun e punës dhe në jetën publike.

Megjithëse LZP përfshin dispozita që inkurajojnë pjesëmarrjen e grave në administratën zgjedhore, ato nuk janë të detyrueshme. Vetëm dy nga 11 anëtarët e KQZ-së janë gra. Gratë po ashtu përbënin 23 për qind të anëtarëve të KKZ-ve, duke përfshirë 16 për qind të kryesuesve, ndërsa EU EOM vërejtë se 28 për qind e anëtarëve të KVV-ve në qendrat e vizituara të votimit ishin gra.

Rekomandim – Të rritet përfaqësimi të grave në institucionet e zgjedhura me votë dhe në administratën zgjedhore duke përcaktuar strategji të fuqishme për rekrutimin dhe promovimin e grave brenda strukturave udhëheqëse të partive dhe në listat e kandidatëve.

XV. PJESËMARRJA E TË RINJVE

Ndonëse nuk ka dispozita ligjore që inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve në politikë, LZP-ja nuk ka asnjë kërkesë moshe për votuesit e regjistruar që dëshirojnë të kandidojnë në zgjedhjet parlamentare. Më shumë se 12 për qind e deputetëve të sapozgjedhur janë nën moshën 35 vjeç.

Sipas regjistrimit të banesave dhe popullsisë të vitit 2024, Kosova ka një popullsi të re me një moshë mesatare prej 34.8 vjeç. KQZ-ja raportoi se 125,852 votues të Kosovës u regjistruan për herë të parë, që përbënte gjashtë për qind të elektoratit. Ndërsa Kushtetuta nuk e përmend të rinjtë si një kategori të mbrojtur, LZP i njeh votuesit për herë të parë si një grup shoqëror të rëndësishëm, të cilit Sekretariati i KQZ-së dhe KKZ-të duhet t'i adresojnë fushata të edukimit për votuesit.⁸⁰ Në aspektin pozitiv, KKZ-të iu drejtuan votuesve të rinj në shkollat e mesme dhe kampuset universitare për të rritur ndërgjegjësimin për procedurat e reja të votimit dhe kërkesat online për ndryshimin e qendrës së votimit.

Ligji për Rininë (2024) është miratuar për të promovuar pjesëmarrjen e të rinjve në politikëbërjen e qeverisë në nivel qendror dhe komunal dhe për të përmirësuar statusin shoqëror dhe cilësinë e jetës së të rinjve. Edhe pse ligji themelon Komisionin Shtetëror të Rinisë, si një mekanizëm koordinues ndër-institucional për zbatimin e politikave sektoriale rinore, bashkë me organet e tjera qendrore dhe vendore, ai ende nuk është zbatuar. Në aspektin pozitiv, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve hartoi një Strategji Shtetërore për Rininë (2024-2032) nga 15 deri në 29 vjeç, e cila kërkon, *ndër të tjera*, që të rritet angazhimi i tyre qytetar dhe përfshin dispozita për matjen e pjesëmarrjes së tyre politike, përfshirë në zgjedhjet lokale dhe parlamentare.

⁷⁹ Për shembull, gjatë një debati në emisionin politik “Compass”, të transmetuar në ATV më 28 janar, kandidati i AAK-NISMA, Gani Bajraktari (Nr. 11) sulmoi personalisht kandidaten e LVV-së Fatmire Kollçaku (nr. 18) dhe e pyeti nëse e kishte kontrolluar “nivelin tiroid” të saj.

⁸⁰ Nenet 68.4 dhe 107.3, LZP (2023).

Ndonëse në LZP nuk ka dispozita që inkurajojnë partitë politike të promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve brenda radhëve të tyre ose në listat e kandidatëve, ligji i lejon votuesit e regjistruar të kandidojnë si kandidatë dhe nuk ka asnjë kusht për moshën. Nga 120 deputetë të sapozgjedhur, 15 (12.5 për qind) janë nën 35 vjeç.⁸¹ Të rinjtë po ashtu përbënin rreth 40 për qind të pjesëmarrësve në ngjarjet e vëzhguara të fushatës, pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrjes së përgjithshme.

XVI. PJESËMARRJA E KOMUNITETEVE JOSHUMICË

Në mungesë të resurseve, subjektet politike joshumicë zhvilluan aktivitete modeste të fushatës brenda komuniteteve të tyre dhe kishin pak kontakte me elektoratin e përgjithshëm të Kosovës.

Kushtetuta e përkufizon Kosovën si shoqëri multi-etnike që përbëhet nga komuniteti shumicë shqiptar (91.7 për qind) dhe komunitetet joshumicë (8.3 për qind), dhe vë theks të rëndësishëm në të drejtat e këtyre komuniteteve joshumicë, veçanërisht duke garantuar 20 ulëse për përfaqësimin e tyre në Kuvendin e Kosovës. Në aspektin pozitiv, 20 nga 28 listat e certifikuara përfaqësonin komunitetet joshumicë dhe katër anëtarë të komuniteteve joshumicë kishin shërbyer në qeverinë në largim.⁸²

Të drejtat e komuniteteve joshumicë mbrohen edhe me LZP, Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë (2008), dhe Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve (2007), i cili garanton status të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare të Kosovës, dhe garanton të drejtën e të gjitha komuniteteve të ruajnë identitetin e tyre gjuhësor dhe të promovojnë përdorimin e barabartë të gjuhëve të Kosovës në sektorin e arsimit, media dhe procedura gjyqësore, mes sektorësh të tjerë.⁸³

Ndonëse liria e tubimit dhe liria e shprehjes në përgjithësi u respektuan gjatë periudhës së fushatës, subjektet politike joshumicë kritikuan mungesën e kushteve të barabarta. Me më pak resurse krahasuar me partitë kryesore shqiptare, subjektet politike joshumicë ishin të detyruara të mbanin kryesisht takime të vogla dhe kontakte derë më derë brenda komuniteteve të tyre, përfshirë në Prizren, Mamushë, Pejë, Dragash, Gjakovë, Obiliq, Fushë Kosovë, Graçanicë, Lipjan, dhe Podujevë ku janë të përqendruar komunitet turke, boshnjake, gorane, agjiptiane, rome dhe ashkali të Kosovës. Vëzhguesit e EU EOM-së vërejtën ngjarje më të mëdha të fushatës të Koalicionit Vakut dhe Partisë Rome të Bashkuar të Kosovës-PREBK (Prizren), KDTP (Gjilan) dhe IRDK (Pejë, Fushë Kosovë dhe Istog).

Edhe pse subjektet politike joshumicë morën pjesë në disa debate televizive, ato kishin qasje të kufizuara në mediat transmetuese përtej kohës së ndarë pa pagesë të përcaktuar me ligj. Në debate morën pjesë garues politikë që i përkisnin të njëjtit komunitet, duke kufizuar kështu shtrirjen e tyre të mundshme. Në RTK1, KDTP u ballafaquan me Partinë Lëvizja Inovative Turke, ndërsa Bashkimi Social Demokrat (SDU), Partia e Re Demokratike dhe *Naša Bošnjačka Koalicija* u

⁸¹ Shtatë deputetë të LVV-së, pesë deputetë të PDK-së, dy deputetë të LDK-së dhe një deputet nga PAI.

⁸² Emilija Redžepi (boshnjake), Nenad Rašić (serb), Fikrim Damka (turk) dhe Elbert Krasniqi (egjiptian).

⁸³ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve ngrit gjuhën turke, boshnjake, rome dhe gorane si gjuhë zyrtare në nivel komunal. Nëse një komunitet jo shumicë, jo-serb përbën së paku 5% të popullsisë në një komunë të caktuar, gjuha e tij fiton statusin e gjuhës zyrtare. Neni 2.3 përcakton se gjuha turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare.

ballafaquan me njëri-tjetrin. Në intervistat kokë më kokë në T7, KTV dhe RTV-Dukagjini morën pjesë edhe Partia e Ashkalinjve për Integrim, PREBK dhe SDU. Mesazhet e fushatës u fokusuan në çështje të cilësisë së jetës, pengesat gjuhësore në arsimin fillor për komunitetin boshnjak, regjistrimin në shkollë për vajzat rome, si dhe politikën e qeverisë ndaj komuniteteve joshumicë. Disa bashkëbisedues vunë në dukje se disa nga këto subjekte politike kishin lidhje të forta me qeverinë e dominuar nga LVV dhe kështu ishin ose të cënueshme ndaj manipulimeve ose të gatshme për të përdorur këtë përparësi të tyre për përfitime zgjedhore.⁸⁴

Përderisa raportuan për marrëdhënie të mira me KQZ-në dhe KKZ-të, disa parti ishin kritike ndaj përbërjes së KVV-ve, të cilat ata i konsideruan të përfaqësuar pamjaftueshëm dhe si rezultat parashtruan ankesa në PZAP.⁸⁵ Fushata e ndërgjegjësimit e KQZ-së për procedurat e votimit në gjuhën turke, boshnjake dhe rome po ashtu u publikua me vonesë, ndërsa materialet trajnuese për anëtarët e KVV-ve nuk ishin në dispozicion në gjuhën turke në komunat e Prizrenit dhe Mamushës, që është në kundërshtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.⁸⁶ Në një shkëputje nga praktikën e kaluar, dizajni i fletëvotimit përfshinte gjuhën shqipe dhe serbe në krye duke lënë jashtë gjuhën turke.

XVII. PJESËMARRJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor u përball me sfida për shkak të mungesës së qasjes në qendrat e votimit dhe mjeteve ndihmëse, si dhe informimit të kufizuar nga KQZ-ja dhe partitë politike.

Legjislacioni që mbështet të drejtat e votimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK) është në fuqi, por nevojiten më shumë dispozita për të promovuar pjesëmarrjen politike. Në vitin 2022, qeveria e Kosovës vendosi të inkorporojë në Kushtetutë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). Gjithashtu, Këshilli i Personave me Aftësi të Kufizuara u krijua në vitin 2021 për të monitoruar zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për të drejtat e PAK dhe për të bashkëpunuar me strukturat qeveritare në promovimin e të drejtave të tyre. Për më tepër, Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Ligji për trajnimin, rikualifikimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar (2009) janë miratuar për të lehtësuar përfshirjen e PAK në tregun e punës dhe në jetën publike. Megjithatë, këto pjesë të legjislacionit nuk janë zbatuar në mënyrë konsekuente dhe nuk ka dispozita në LZP që inkurajojnë partitë politike të promovojnë pjesëmarrjen e PAK në radhët e tyre.

LZP dhe Rregullorja Zgjedhore Nr.9/2024 e KQZ-së përcaktojnë procedurën e regjistrimit, dokumentimit dhe votimit për nevoja dhe rrethana të veçanta në institucione dhe në shtëpi nëpërmjet ekipeve të dedikuara mobile. Sipas KQZ-së, 4,060 kosovarë janë regjistruar si votues me nevoja të veçanta, 2,670 prej të cilëve kanë votuar ditën e zgjedhjeve. KKZ-të janë të mandatuara

⁸⁴ M. 13 janar, gjatë një takimi në Treboviq me Elbert Krasniqin, Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe udhëheqës i Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës (IRDK), Kryeministri Albin Kurti theksoi “Ai që është egjiptian dhe e do *Vetëvendosjen*, u thoni të votojnë numrin 111.”

⁸⁵ Partia Demokratike Turke e Kosovës, Bashkimi Social Demokrat, Partia Unike Gorane dhe Partia e Re Demokratike e Kosovës kanë paraqitur ankesa në PZAP për përfaqësim të pamjaftueshëm në QKN dhe KVV.

⁸⁶ KQZ-ja postoi infografikë mbi procedurat e votimit në gjuhën turke, boshnjake dhe rome në faqen e saj në Facebook më 29 janar. Edhe në RTK1 u transmetuan mesazhe audiovizive për procedurat e votimit në ato gjuhë.

të organizojnë fushata informuese në komunat e tyre përkatëse, duke synuar PAK në mesin e grupeve të tjera të cenueshme. Megjithatë, për dallim nga zgjedhjet e kaluara, organizatat e personave me aftësi të kufizuara raportuan se KKZ-të rrallëherë i kishin konsultuar ato dhe se nuk iu ishte kërkuar të ndihmojnë në regjistrimin e PAK si votues me nevoja të veçanta. Ata po ashtu theksuan se disa votues PAK ose nuk ishin në dijeni se duhej të regjistroheshin në një platformë të dedikuar online ose ishin dekurajuar ta bënë këtë për shkak të mosnjohjes së procedurave të reja, duke sugjeruar për mangësi të mundshme në fushatën e KQZ-së për informim të votuesve. Për më tepër, EU EOM pranoi raportime anekdotike nga organizatat e shoqërisë civile se ekipet mobile të KKZ-së nuk arritën t'i kontaktojnë të gjithë votuesit e regjistruar në ditën e zgjedhjeve. Në aspektin pozitiv, KQZ-ja realizoi fushata informuese për votuesit në gjuhën e shenjave, siç kërkohet me ligj.

Për shkak të përqindjes së lartë të votimit të asistuar të vërejtur në zgjedhjet e mëparshme, LQP-ja përcaktoi kushte shtesë për zgjedhjet e vitit 2025.⁸⁷ Megjithatë, procedurat e reja nuk u zbatuan në mënyrë konsekuente në pothuajse dy të tretat e vendvotimeve të vëzhguara në ditën e zgjedhjeve, ku KVV-të shpesh i lejonin votuesit të ndihmohen pa dokumentacionin e kërkuar, duke neglizhuar regjistrimin e të dhënave të votuesve të asistuar ose arsye për të cilën është kërkuar asistencë. Për më tepër, në disa raste personeli i vendvotimeve lejoi që votuesit e moshuar dhe analfabetë të asistoheshin pa dokumentacion, pasi në raste të tilla marrja e një certifikate mjekësore mund të mos kishte qenë e mundur, ndërsa në raste të tjera këtyre votuesve iu refuzua asistencë. Duke marrë parasysh zbatimin jo konsekuent të procedurave, rregullorja aktuale mund të përfitojë nga sqarimet e mëtejshme.

Ndërsa KQZ-ja raportoi se afër 80 për qind e qendrave të votimit konsideroheshin nga autoritetet komunale si të qasshme, vëzhguesit e EU EOM-së gjetën se më shumë se një e treta nuk ofronin qasje të pavarur për personat me lëvizshmëri të reduktuar. Planimetria e qendrave të votimit shpesh nuk akomodonte personat me aftësi të kufizuara dhe disa vendvotime ndodheshin ndonjëherë në katet e sipërme. Udhëzuesit taktilë për fletët e votimit nuk ishin gjithmonë në dispozicion, ose stafi i vendvotimit nuk ishte i informuar për praninë e tyre (shih seksionin Votimi, numërimi dhe përpilimi i rezultateve). Për më tepër, vëzhguesit e EU EOM-së vlerësuan se pothuajse gjysma e zyrrave të KKZ-së ishin të paqasshme. Duhet bërë përpjekje të koordinuara ndërmjet administratës zgjedhore dhe autoriteteve vendore për të adresuar këto mangësi të kahershme në qasjen në KKZ dhe vendvotime. Meqenëse votuesit mund të kërkojnë të ndryshojnë qendrën e tyre të caktuar të votimit, mund të merret parasysh mundësia për të zgjedhur një qendër votimi ose vendvotim në katin përdhese.

Edhe pse manifestet e fushatës nga partitë kryesore shqiptare të Kosovës përmendën politikën për personat me nevoja të veçanta, ato rrallë iu referuan propozimeve që prekin veçanërisht PAK. Organizatat e shoqërisë civile raportuan se personat me dëmtime në dëgjim nuk ishin në gjendje të ndjekin fushatën për shkak të mungesës së përkthyesve në gjuhën e shenjave në tubimet elektorale. Vëzhguesit e EU EOM-së raportuan gjithashtu se asnjë person me aftësi të kufizuara nuk ka folur në 75 ngjarjet e vëzhguara të fushatës. Për më tepër, misioni identifikoi vetëm dy kandidatë me aftësi të kufizuara në mesin e 1,279 kandidatëve të certifikuar nga KQZ-ja; dhe asnjëri prej tyre nuk u zgjodh.

⁸⁷ Një votues me aftësi të kufizuara mund të asistohet nga një votues tjetër i regjistruar në të njëjtën vendvotim, me përjashtim të anëtarëve të KVV-së dhe vëzhguesve, dhe çdo votues mund të ndihmojë një votues tjetër vetëm një herë. Votuesit e asistuar duhet gjithashtu të paraqesin një certifikatë mjekësore që mbështet pretendimin e tyre për aftësinë e kufizuar dhe të dhënat e tyre duhet të regjistrohen në librin e votimit.

Rekomandim – Të përmirësohet qasja në qendrat e votimit dhe mjetet ndihmëse për t'u mundësuar personave me aftësi të kufizuara të votojnë në mënyrë të pavarur dhe të barabartë me të tjerët. Të ndërtohen marrëdhënie bashkëpunimi me organizatat e personave me aftësi të kufizuara për tua përshtatur iniciativat për edukimin e votuesve kategorive të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.

XVIII. VËZHguesit VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË

Vëzhguesit vendorë të angazhuar e rritën transparencën e fushatës zgjedhore.

Duke kontribuar në transparencën e procesit zgjedhor, legjislacioni zgjedhor parashikon vëzhgimin qytetar, ndërkombëtar dhe partiak të zgjedhjeve dhe përcakton të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve, duke përfshirë parimet e paanshmërisë dhe neutralitetit të tyre.⁸⁸ Ndonëse legjislacioni zgjedhor parashikon vëzhgimin e të gjithë procesit zgjedhor, KQZ e kufizoi periudhën e regjistrimit për akreditim për muajin e fundit para zgjedhjeve, duke mos e harmonizuar atë me afatet e shumë fazave të rëndësishme të procesit zgjedhor, përfshirë shqyrtimin nga publiku të listën preliminare të votuesve dhe periudhën përkatëse të kundërshtimit.⁸⁹ Në aspektin pozitiv, akreditimi zyrtar *de facto* u kërkuar nga administrata zgjedhore vetëm për qasje në ambientet zgjedhore në ditën e zgjedhjeve, dhe vëzhguesit nuk raportuan për asnjë pengesë në punën e tyre.

Në një proces gjithëpërfshirës, KQZ akreditoi 22 organizata vendore, përfshirë Institucionin e Avokatit të Popullit, me gjithsej 1,193 vëzhgues si dhe rreth 18,600 vëzhgues partiakë. Përpjekja më e madhe e vëzhgimit nga shoqëria civile u drejtua nga koalicioni i vëzhguesve Demokracia në Veprim, i cili vendosi vëzhgues afatgjatë për të monitoruar fushatën zgjedhore dhe ambientin parazgjedhor dhe publikoi rregullisht raporte publike mbi gjetjet e tyre për keqpërdorimin e resurseve administrative, si dhe përcjelljen e gjuhës së urrejtjes dhe financimin e fushatës, duke rritur transparencën dhe integritetin e fushatës zgjedhore. Në ditën e zgjedhjeve, koalicioni po ashtu bëri një tabelim paralel të votave bazuar në një mostër prej 500 VV-ve. Sa i përket vëzhguesve ndërkombëtarë, KQZ-ja akreditoi 11 organizata ndërkombëtare, dhjetë misione diplomatike rezidente dhe gjashtë delegacione të organeve të huaja të menaxhimit të zgjedhjeve.

XIX. VOTIMI, NUMËRIMI DHE TABELIMI I REZULTATEVE

Dita e zgjedhjeve ishte transparente dhe e menaxhuar mirë; megjithatë, vonesat në përgatitje, lëshimet procedurale dhe problemet teknike ndikuan negativisht në procesin e numërimit, si dhe në tabelimin dhe transmetimin e rezultateve paraprake.

Dita e zgjedhjeve u vërejt të jetë e qetë dhe në përgjithësi votimi u zhvillua pa probleme, megjithëse vëzhguesit dhe mediat raportuan incidente të izoluar brenda dhe rreth qendrave të votimit. Votimi

⁸⁸ E drejta për të vëzhguar zgjedhjet u akordohet përfaqësuesve të akredituar të organizatave joqeveritare, qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatave ndërkombëtare të angazhuara në fushën e zgjedhjeve dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfaqësuesve të vendeve të huaja dhe përfaqësuesve të subjekteve politike.

⁸⁹ Periudha për akreditimin e vëzhguesve partiakë ishte e hapur nga 30 dhjetori deri më 15 janar, e cila në fund u zgjat deri më 20 janar. Grupet e vëzhguesve jopartiakë patën mundësi të aplikojnë për akreditim prej 30 dhjetorit deri më 25 janar.

u zhvillua në 903 qendra të rregullta të votimit të ndara në 2,533 vendvotime si dhe 38 qendra të votimit me kusht me 56 vendvotime. Ndërsa votimi në përgjithësi u vlerësua pozitivisht nga vëzhguesit e EU EOM-së, disa gabime procedurale, vështirësi në zbatimin e procedurave dolën në pah gjatë fazës së numërimit. Vëzhguesit partiakë ishin të pranishëm në 97 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, ndërsa vëzhguesit qytetarë u raportuan në 23 për qind të tyre. Gratë përbënin 28 për qind të stafit të qendrave të votimit, duke përfshirë 23 për qind të kryesuesve. Rreth 38 për qind e qendrave të votimit nuk ofronin qasje të pavarur për personat me lëvizshmëri të kufizuar dhe 17 për qind e vendvotimeve kishin planimetri të papërshtatshme për këta votues.

PZAP ka pranuar rreth 100 ankesa lidhur me ditën e zgjedhjeve, që kryesisht i referoheshin fushatës në ditën e zgjedhjeve, ndikimit të votuesit dhe parregullsive të supozuara gjatë numërimit në vendvotime. Në shumicën dërrmuese të rasteve, ankesat u hodhën poshtë ose refuzuan, por për ato që u aprovuan, që kryesisht kishin të bënin me fushatën, gjrobat e shqiptuara arritën në rreth 13,500 €. Ankesat për procesin e numërimit në vendvotime që vetëm vinin në dyshim rezultatet pa dokumentuar ndonjë parregullsi të mundshme, u hodhën poshtë si të parakohshme pasi rezultatet ende mund të korrigjoheshin në nivel QKN-së dhe ankuesit u këshilluan të kundërshtonin rezultatet përfundimtare nëse prapë do të ishin të pakënaqur.

a. Hapja dhe votimi

Hapja e qendrave të votimit u vlerësua pozitivisht në 40 nga 43 vendvotime të vëzhguara nga vëzhguesit e EU EOM-së. Shumica e qendrave të votimit të vëzhguara u hapën me kohë, dhe vetëm disa që kishin vonesa të vogla nën 30 minuta për shkak të çorganizimit ose të kuptuarit të pamjaftueshëm të procedurave nga anëtarët e KVV-ve. Ndërsa procedurat u ndoqën në masë të madhe, u vërejtën disa lëshime procedurale, duke anashkaluar kështu masa të rëndësishme për integritetin e procesit, siç është regjistrimi i materialeve zgjedhore të ndjeshme. Qendrat e votimit me kusht raportuan vështirësi me qasjen në platformën e regjistrimit online, duke rezultuar në hapje me vonesë dhe zgjatje të kohës së pritjes për votuesit.

Vëzhguesit e vlerësuan procesin e votimit si të organizuar mirë dhe transparent në 97 për qind të 412 qendrave të votimit të vizituara. Procedurat e votimit në përgjithësi u respektuan. Identiteti i votuesve u verifikua në mënyrë të vazhdueshme përmes dokumenteve të identifikimit dhe votuesit nënshkruan në mënyrë të rregullt listat e shtypura të votuesve. Megjithatë, mungesa e trajnimit të stafit të votimit u evidentuan nga një sërë gabimesh procedurale. Procedurat e reja për votimin e asistuar nuk u zbatuan në mënyrë konsistente në 64 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, ku KVV-të shpesh lejonin votuesit të asistohen pa dokumentacionin e kërkuar ose duke neglizhuar regjistrimin e arsyes së asistencës. Disa KVV informuan vëzhguesit e EU EOM-së se KKZ-të i kishin udhëzuar ata gjatë gjithë ditës që t'i përjashtonin votuesit e moshuar mbi 65 vjet nga kërkesa për të ofruar dokumentacion mjekësor për të mbështetur kërkesat e tyre për asistencë në votim, duke ndikuar më tej në qasjen jokonsistente të KVV-ve.

Si një masë sigurie shtesë, u përdor bojë që nuk shlyhej për të shënuar gishtat e votuesve për të parandaluar votimin e shumëfishtë. Megjithatë, vëzhguesit e EU EOM-së vunë re se gishtat e votuesve nuk u kontrolluan në mënyrë të vazhdueshme për gjurmë boje në 15 për qind të vëzhgimeve. Për më tepër, vëzhguesit e BE-së raportuan se shenja e bojës në gishta mund të hiqej. Në mëngjesin e ditës së zgjedhjeve, KQZ-ja njoftoi vendimin e saj, të miratuar më 8 shkurt, për të lejuar përdorimin e dokumenteve e skaduara të identitetit për identifikimin e votuesve. Për shkak të këtij vendimi të vonuar, disa votues nuk u lejuan të votonin pasi KVV-të nuk ishin plotësisht të dijeni për udhëzimet e reja.

Fshehtësia e votës ishte komprometuar në pesë për qind të vendvotimeve të vëzhguara për shkak të organizimit të vendvotimeve, pozicionimit të kabinave të votimit dhe njerëzve që qëndronin shumë afër kabinave, dhe në 17 për qind të vendvotimeve të vëzhguara për shkak të pozicionimit të kamerës.⁹⁰ Vëzhguesit e BE-së raportuan raste të votimit në grup në katër për qind të qendrave të votimit të vëzhguara. Materialet e pamjaftueshme ose të munguara janë raportuar në 11 për qind të vendvotimeve, përkatësisht formularët e ankesave, fletëvotimet e pamjaftueshme për votim me kusht dhe listat e kandidatëve. KVV-të nuk morën ose nuk ishin në dijeni të pranisë së udhëzuesve taktik të fletëvotimeve për votuesit me shikim të dëmtuar në 45 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. Afishet me udhëzimet e votimit nuk ishin të vendosura në 19 për qind të vendvotimeve. Përveç kësaj, informacioni ishte i disponueshëm kryesisht në gjuhën shqipe. Në lidhje me përdorimin e gjuhëve, vëzhguesit e EU EOM-së vunë re vështirësi në komunikim brenda KVV-ve si dhe me votuesit në disa zona ku janë në përdorim kryesisht gjuhët joshumicë.

b. Mbyllja, numërimi dhe dorëzimi i materialit zgjedhor

Vëzhguesit e BE-së e vlerësuan negativisht procesin e mbylljes dhe numërimit në tetë nga 42 qendrat e votimit të vëzhguara, për shkak të gabimeve procedurale, ndonëse kryesisht u vlerësua si transparent. Kontrollat e përcaktuara të integritetit, si numërimi dhe paketimi i materialeve të papërdorura dhe materialeve të tjera të ndjeshme, nuk u bënë në mënyrë të saktë në afërsisht dy të tretat e vëzhgimeve para fillimit të numërimit. Procedurat e numërimit nuk u zhvilluan sipas radhës së përcaktuar në më shumë se një të katërtën e rasteve ose u kryen njëkohësisht, duke ndikuar negativisht në transparencë. Gjatë numërimit, nuk është përcaktuar vlefshmëria e votave në mënyrë konsistente ose në përputhje me rregullat e vendosura në katër raste dhe një përcaktim i tillë është kontestuar nga disa anëtarë të KVV-së në gjashtë raste. Vëzhguesit e EU EOM-së raportuan nga tetë numërime se KVV-të kishin vështirësi në plotësimin e formularëve të rezultateve si rezultat i moskuptimit të mjaftueshëm të procedurave ose mos zbatimit të duhur të tyre. Në shtatë vendvotime, KVV-të nuk shfaqën publikisht kopjet e formularëve të rezultateve siç kërkohet me ligj.

Natën e zgjedhjeve, sistemet e TI të KQZ-së nuk ishin të disponueshme për një periudhë të gjatë, duke ndikuar në publikimin e rezultateve preliminare dhe pranimin e materialeve zgjedhore në qendrat komunale të numërimit. Pavarësisht sfidave teknike, vëzhguesit e EU EOM-së e vlerësuan fazën e dorëzimit të materialit zgjedhor si transparente dhe efikase. Ambientet për ruajtjen e materialeve ishin kryesisht adekuate për një qëllim të tillë dhe KKZ-të zbatuan siç duhet procedurat e përcaktuara. Vëzhguesit e EU EOM-së raportuan vetëm pak raste ku materialet zgjedhore duhej të hapeshin nga KKZ-të për shkak të paketimit të gabuar.

c. Verifikimi i rezultateve të subjekteve politike dhe numërimi i votave preferenciale

Numërimi i votave preferenciale, i planifikuar fillimisht të fillonte në mëngjesin e 10 shkurtit, u shty për shkak të problemeve të vazhdueshme teknike, përgatitjes së pamjaftueshme teknike të qendrave të numërimit dhe mungesës së pajisjeve dhe softuerëve kritikë në disa QKN. Përfundimisht, numërimi filloi vetëm në katër komuna në pasditen e datës 11 shkurt, dhe QKN-të e tjera filluan gradualisht në ditët në vazhdim, e fundit më 16 shkurt. Megjithatë, gjatë ditëve të para, Platforma digjitale e përdorur për menaxhimin e rezultateve ishte jostabile, me ndërprerje të shpeshta të raportuara. Përveç kësaj, mbulimi i dobët me internet në disa zona i përkeqësoi edhe

⁹⁰ KQZ-ja futi në përdorim videokamera në të gjitha vendvotimet me qëllim që të parandalonte parregullsitë në votim dhe numërim duke regjistruar të gjitha operacionet në vendvotime. Videokamerat e regjistronin procesin vetëm në kartat e memories. Regjistrimet e ruajtura mund të rikthehen nëse kërkohen nga PZAP-i ose nga një gjykatë si provë dhe do të asgjësohen pas një periudhe të caktuar kohore, sipas udhëzimeve të brendshme të KQZ-së.

më shumë problemet teknike, duke rezultuar ndonjëherë në nevojën për të përsëritur numërimin pasi rezultatet e numërimit nuk ishin ruajtur siç duhet në sistem. QKN-të e fundit, në Leposaviq, Prishtinë dhe Pejë, përfunduan numërimin më 21 shkurt.

EU EOM vëzhgoi procesin e numërimit në të gjitha QKN-të. Procedurat e përcaktuara të numërimit përfshinin masa të forta të sigurisë për integritetin e procesit të numërimit dhe tabelimit të rezultateve dhe përfshinin hapa të plotë të verifikimit për rezultatet e përcaktuara nga KVV-të në vendvotime. Kjo në praktikë rezultoi në një rinumërim të plotë të votave në shumicën e rasteve, duke ofruar një mundësi për të korrigjuar gabimet e mundshme gjatë numërimit të bëra nga KVV-të, megjithëse e zgjati ndjeshëm procesin në fund. Ekipet e numërimit fillimisht regjistronin të dhënat nga formularët e rezultateve të përpiluara nga KVV-të dhe, pas verifikimit, përpiluan formularët digjitalë të rezultateve me rezultate të konfirmuara ose të përcaktuara rishtazi për subjektet politike. Më pas, votat preferenciale për kandidatët individualë u përcaktuan dhe u regjistruan në formularë të veçantë digjitalë të rezultateve. Megjithatë, për shkak të problemeve fillestare teknike dhe papërgatitjes së qendrave të numërimit, disa procedura u anashkaluan, përfshirë postimin e rezultateve nga çdo vendvotim në QKN, si dhe përpilimin e rezultateve në nivel komunal, duke ulur transparencën për ata që nuk kishin qasje në QKN.

Fillimisht, vëzhguesit e EU EOM-së raportuan konfuzion rreth procedurave dhe zbatimit të tyre jo konsekuent në shumicën e QKN-ve, por performanca e grupeve të numërimit në shumicën e tyre u përmirësua ndjeshëm me kalimin e kohës. Megjithatë, procesi u vlerësua negativisht deri në fund në QKN-të në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, ku ekipet e numërimit nuk ishin plotësisht të trajnuar paraprakisht, QKN-të nuk ishin plotësisht të vetëdijshme për detyrat e tyre gjatë numërimit, si dhe për shkak të papërgatitjes teknike të qendrave të numërimit.

Vëzhguesit e EU EOM-së e vlerësuan pozitivisht transparencën e procesit të numërimit për të pranishmit, për shkak të transmetimit të operacioneve të numërimit në ekrane, ku shfaqej çdo fletë votimi, si dhe regjistrimi i të dhënave në kohë reale. Në disa raste, mosfunksionimi i kamerave që transmetonin operacionet i pengoi ekipet të vazhdonin me numërimin deri në zgjidhjen e problemeve. Vëzhguesit partiakë ishin të pranishëm në të gjitha QKN-të gjatë gjithë periudhës së numërimit. Procesi u karakterizua kryesisht si i ngadalshëm, por efikas dhe i kujdesshëm. Nga shumica e QKN-ve u raportuan disa raste ku fletëvotimet që ishin vlerësuar si të pavlefshme nga KVV-të u rivlerësuan nga ekipet e numërimit si të vlefshme, ose anasjelltas. Sipas vëzhguesve të EU EOM-së, këto korrigjime janë bërë siç duhet në përputhje me kriteret e vlefshmërisë së fletëvotimeve, duke zbuluar mungesë të kuptimit të mjaftueshëm të këtyre rregullave nga ana e KQV-ve dhe mungesë udhëzimesh të mjaftueshme gjatë sesioneve të trajnimit. Sipas të dhënave të publikuara nga KQZ-ja, vlefshmëria dhe kategorizimi sipas subjekteve politike i rreth 6,300 votave u rivlerësuan nga ekipet e numërimit.

d. Numërimi i votave nga jashtë Kosovës, të votimit me kusht dhe mobil

Pas përfundimit të numërimit në QKN, nga data 26 shkurt deri më 5 mars në QNR u numëruan fletëvotimet e hedhura nga votuesit jashtë Kosovës, fletëvotimet me kusht dhe fletëvotimet e hedhura nga personat e regjistruar si votues me nevoja të veçanta. Aktivitetet në QNR u zhvilluan në praninë e vëzhguesve nga disa subjekte politike. Numërimit i parapriu përpilimi i një liste digjitale të të gjithë votuesve që votuan duke skanuar të dhënat përkatëse në listat e votuesve në letër. Këto u krahasuan me të dhënat e votuesve që zgjodhën ndonjë nga metodat alternative të votimit, në mënyrë që të zbulohet çdo rast i votimit të mundshëm të shumëfishtë. Pas verifikimit të

listave të votuesve si dhe të dërgesave postare, komisioni evidentoi 921 raste të tilla.⁹¹ Sipas rregulloreve, fletëvotimet përkatëse u përjashtuan nga numërimi.

e. Tabelimi dhe publikimi i rezultateve paraprake

KQZ-ja ndau informacione rreth procesit të votimit dhe pjesëmarrjes së votuesve gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve dhe filloi të publikojë rezultatet preliminare të zgjedhjeve në një faqe interneti të dedikuar natën e zgjedhjeve. Megjithatë, për shkak të problemeve teknike në platformën e menaxhimit të rezultateve, faqja e internetit u bë e paqasshme menjëherë pas mbylljes së vendvotimeve. Pastaj, të dhënat për pjesëmarrjen dhe për rezultatet mungonin ose transmetoheshin me vonesë për shkak të mungesës së zyrtarëve për futjen e të dhënave në zona të caktuara. Për të tejkaluar këto vështirësi, QKN-të dhe KQZ-ja iu kthyen përpunimit manual të të dhënave të rezultateve, me tabelimin e rezultateve në nivel qendror bazuar në formularët origjinal të rezultateve ose kopjet e skanuara të dërguara në mënyrë elektronike nga KKZ-të. Sipas KQZ-së, funksionaliteti i plotë i sistemit u rivendos në mesnatën e natës së zgjedhjeve, duke i mundur KQZ-së të rifillojë publikimin e të dhënave për rezultatet preliminare herët në mëngjes më 10 shkurt. Raste të rezultateve matematikisht të pamundura dhe mungesës ose pasaktësisë së të dhënave për pjesëmarrjen u raportuan gjerësisht, duke ngritur shqetësime për parregullsi të mundshme gjatë numërimit.

Më pas, u shfaqën raportime që spekulonin për sulme të mundshme të shpërndara mbi pengimin e shërbimit kundër faqes së rezultateve të KQZ-së, si dhe për infektim me malware të faqes kryesore të internetit të KQZ-së. Sipas vlerësimit të EU EOM-së, faqes së internetit të rezultateve të KQZ-së i mungonin disa veçori bazë të optimizimit, veçanërisht për pajisjet mobile. Performanca e saj nën ngarkesë të lartë u përkeqësua edhe më tej për shkak të mangësive të serverit (i menaxhuar nga Agjencia për Shoqërinë e Informacionit) si dhe konfigurimeve të pasakta të rrjetit dhe të firewall-it. Këto pengesa teknike, në kombinim me mungesën e informacionit të mjaftueshëm të ndarë nga KQZ-ja lidhur me dështimin e sistemit, si dhe mungesa e të dhënave ose të dhënave të pasakta të ngarkuara online, minuan ndjeshëm besimin e publikut në integritetin e procesit të numërimit dhe tabelimit, dhe ngritën shqetësime për masat e sigurisë kibernetike të KQZ-së. Më 11 shkurt, me fillimin e numërimit në QKN-të e para, KQZ-ja u përpoq të siguronte publikun se integriteti i votës ka mbetur i paprekur dhe se rezultatet përfundimtare do të pasqyrojnë me saktësi vullnetin e votuesve. KQZ-ja është përmbajtur nga komentet e mëtejshme mbi natyrën e dështimit të sistemit deri në përfundimin e hetimeve nga autoritetet përkatëse.

Pas përfundimit të numërimit të secilës kuti të votimit në QKN, ekipet e numërimit dorëzuan në mënyrë elektronike formularët e rezultateve si dhe kopjet e tyre të shtypura dhe të nënshkruara. KKZ-ja kreu kontrolle të cilësisë së të dhënave të rezultateve në bazën e të dhënave për të identifikuar dhe shënuar gabimet e mundshme në numërim, përpara se ato të dërgoheshin për tabelimin qendror dhe publikim. Të gjithë formularët e printuar të rezultateve u skanuan dhe u dërguan në KQZ për verifikim; megjithatë, ato nuk u shfaqën në QKN ose nuk u ngarkuan në internet menjëherë pas numërimit.

Si rezultat i vështirësive teknike, KQZ-ja vendosi të krijojë një faqe të re interneti për të publikuar rezultatet preliminare, përfshirë ato për kandidatët individualë, e cila u lëshua në funksion me 20

⁹¹ Sipas KQZ-së, 868 zarfe u përjashtuan nga numërimi pasi votuesit kishin dërguar fletëvotimet më shumë se një herë; në 19 raste, votuesit që kishin dërguar vota me postë kishin votuar edhe në përfaqësi diplomatike dhe 34 votues që kishin votuar me kusht kishin votuar edhe në qendrën e tyre të rregullt të votimit.

shkurt.⁹² Në këtë faqe interneti ishin të disponueshme të dhënat e rezultateve nga vendvotimet, si edhe rezultatet e verifikuara dhe të korrigjuara që ishin numëruar në QNR. Megjithatë, faqja origjinale e internetit mbeti aktive për një kohë të caktuar, me grupe të ndryshme të dhënash, çka mund të shkaktonte konfuzion tek publiku. Pjesëmarrja përfundimtare e votuesve në vendvotimet e rregullta u raportua nga KQZ-ja në 42 për qind, ndërsa pjesëmarrja e përgjithshme ishte 46.6 për qind.

Pas largimit të EU EOM-së, më 10 mars, KQZ-ja vendosi për rinumërimin e rezultateve për 50 vendvotime. Pas pranimit të materialeve zgjedhore dhe rezultateve nga QKN-të, QNR rekomandoi që të rinumërohen rezultatet e zgjedhjeve të 15 vendvotimeve nga komuna të ndryshme të Kosovës për shkak të mospërputhjeve ndërmjet numrit të nënshkrimeve të votuesve në listat e votuesve dhe numrit të fletëvotimeve të gjetura brenda kutive të votimit. Përveç kësaj, materialet zgjedhore të 35 vendvotimeve në komunën e Vushtrrisë u urdhëruan për rinumërim për shkak të mospërputhjeve të identifikuar në rezultate. Gjithashtu, si pasojë e vendimit të PZAP-it në një ankesë, u rinumëruan 1,631 vota përmes postës të cilat ishin shpallur fillimisht të pavlefshme. Rinumërimi rezultoi në rivlerësimin e gjithsej 1,046 fletëvotimeve nga këto si të vlefshme.

Rekomandim me prioritet – Të krijohet një sistem i besueshëm dhe transparent të menaxhimit të rezultateve me procedura të qarta dhe të verifikueshme për të siguruar përpunimin e saktë të të dhënave të rezultateve. Të sigurohet qasje e shpejtë në rezultatet preliminare, duke përfshirë të gjitha të dhënat përkatëse, si p.sh. pjesëmarrja e votuesve, votat e vlefshme dhe të pavlefshme, si dhe formularët e rezultateve të skanuara për vendvotim.

XX. REZULTATET DHE AMBIENTI PASZGJEDHOR

a. Publikimi i rezultateve

Më 15 mars, KQZ-ja publikoi rezultatet përfundimtare pas përfundimit të verifikimit dhe numërimit të votave preferenciale të të gjitha vendvotimeve dhe numërimit të votave me kusht, të personave me nevoja të veçanta dhe të votimit jashtë Kosovës. Partia në pushtet në Kosovë, LVV, e udhëhequr nga Kryeministri Albin Kurti, siguroi 48 ulëse, duke mos e arritur shumicën e plotë. PDK mori 24 ulëse, pasuar nga LDK me 20 ulëse dhe AAK-NISMA me tetë ulëse. LS siguroi nëntë nga 10 ulëset e rezervuara për komunitetin serb të Kosovës, ndërsa një ulëse shkoi për SPO. Nga 10 ulëset e garantuara për komunitetet joshumicë, KDTP mori dy ulëse, ndërsa IRDK, NDS, VAKAT, PREBK, SDU, PLE, PAI dhe JGP të gjitha morën nga një ulëse. LVV dhe LS siguruan përfaqësimin e grave pa qenë nevoja të zbatohet kuota gjinore, me përkatësisht 46 për qind dhe 33 për qind të anëtarëve të zgjedhur që ishin gra. Megjithatë, edhe PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja duhej të zbatonin kërkesat e kuotave gjinore për të siguruar përfaqësim adekuat të grave.

b. Ankesat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve⁹³

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ, subjektet politike dhe kandidatët kishin 48 orë kohë, deri më 17 mars, për të bërë ankesë kundër rezultateve përfundimtare. PZAP, i cili mori gjashtë ankesa: tri nga Kandidati i PDK-së, Petrit Hajdari, duke kërkuar rinumërim të votave në

⁹² <https://rezultatet2025.net/>

⁹³ Burimi: Faqja e internetit e PZAP-së, Zyra e BE-së dhe mediat.

disa VV,⁹⁴ një nga PDAK-LpB që kërkonte anulimin e 211 votave me postë të dhëna për Partinë e Ashkalinjve për Integrim si dhe 108 vota të hedhura nëpër komunat ku pretendohet se nuk kishte komunitet ashkali. Dy ankesa janë bërë nga LVV. PZAP hodhi poshtë të gjitha ankesat si të pabazuara më 19 mars. Në ankesën e LVV-së që kërkonte anulimin e 18,933 votave të dërguara me postë që i kishte marrë LDK-ja dhe kandidatët e saj dhe përsëritja e mëvonshme e procesit të votimit, PZAP vendosi se parashtruesi i ankesës nuk kishte arritur të arsyetojë rastin e tyre për të arsyetuar një kërkesë të tillë dhe për këtë arsye e hodhi poshtë ankesën si të pabazuar.⁹⁵ PZAP po ashtu hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e LVV-së që kërkonte rinumërim në disa vendvotime në Skenderaj, duke pretenduar se kandidati i PDK-së për kryeministër kishte marrë ndërmjet 94 dhe 100 për qind të votave në shumicën e VV-ve, duke përmendur pamundësinë e një forme të tillë votimi.

Tri subjekte politike, PDK, LVV dhe PDAK-LpB, parashtruan ankesë ndaj vendimeve të PZAP në GJS.⁹⁶ GJS i hodhi poshtë të gjitha rastet si të pabazuara, të parat më 24 dhe dy të tjerat më 26 mars përkatësisht brenda afatit të përcaktuar kohor, duke i hapur kështu rrugën KQZ-së për të certifikuar rezultatet. Ndërkohë, më 26 mars, Prokuroria Themelore në Prishtinë autorizoi policinë që të fillojë një hetim për procesin e votimit me postë, pa dhënë detaje të mëtejshme. LVV, e pakënaqur me vendimin e GJS-së, kundërshtoi certifikimin e rezultateve nga KQZ-ja ndërsa çështja e procesit të votimit me postë u referua në Gjykatën Kushtetuese.

c. Zhvillimet paszgjedhore

Më 21 shkurt, një operacion i udhëhequr nga policia e Kosovës mbylli objektet e Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicën e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, të cilat punonin nën sistemin serb, për shkak të dyshimit se në këto institucione ishin kryer “veprime të paligjshme lidhur me procesin zgjedhor”. Përdërisa këto operacione bazoheshin në një urdhër gjykate, ato janë në përputhje me praktikën e mëparshme të Qeverisë për mbylljen e strukturave ekzistuese që ofrojnë shërbime themelore sociale për serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera, pa një marrëveshje alternative të miratuar më parë në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, disa udhëheqës të partive joshumicë boshnjake reagues – Emilija Redžepi shprehu mbështetjen e saj për mandatin e mundshëm të Albin Kurtit për formimin e qeverisë, ndërsa Duda Balje vendosi kushte për mbështetjen e saj, duke përfshirë reformat komunale dhe arsimore.

Tensionet midis LS dhe LVV u përshkallëzuan pas shpalljes së rezultateve përfundimtare. Igor Simić i LS-së akuzoi Albin Kurtin për manipulim të votave për të siguruar një vend për Nenad Rashiqin, duke e quajtur Kuvendin të paligjshëm. Kryeministri Kurti dhe Nenad Rashiqi u përgjigjën me pretendime për ndërhyrje nga Serbia, duke dhënë detaje mbi aktorët dhe metodat e përfshira në përpjekjet për të ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve.

Më 27 mars, pothuajse shtatë javë pas ditës së zgjedhjeve, KQZ certifikoi zyrtarisht rezultatet, me nëntë vota pro dhe dy kundër. Dy anëtarët e emëruar nga LVV e kundërshtuan pa sukses

⁹⁴ Vendimi A Nr. 636/2025 i datës 18.03.2025, ankesa të bashkuara Nr. 636, Nr. 637 dhe Nr. 638 duke i hedhur poshtë si të pabazuara.

⁹⁵ LVV argumentoi se lista e votuesve jashtë vendit përfshinte individë të regjistruar me adresa emaili që ishin përdorur shumë herë.

⁹⁶ Kandidati i PDK-së Petrit Hajdari pretendonte se votat e tij nuk u përputheshin në disa VV, LVV kërkonte anulimin e votave me postë për LDK-në dhe PDAK-LpB kundërshtoi rezultatet e votimit të diasporës në KKR.

certifikimin, duke cekur parregullsi të pretenduara në procesin e votimit me postë dhe duke argumentuar se certifikimi duhet të shtyhet derisa të shteren të gjitha mjetet juridike. Duke refuzuar pranimin e rezultateve të votimit jashtë Kosovës, LVV, pasi kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në procesin e parashikuar nga LZP, shprehu synimin e saj për t'u ankuar më pas në Gjykatën Kushtetuese. KQZ-ja zëvendësoi tre deputetë të zgjedhur, dy nga LDK-ja dhe një nga PDK-ja, të cilët vendosën të mbeten në rolet e tyre si kryetarë komunash në vend se të merrnin mandatet parlamentare.

XXI. REKOMANDIMET

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTIT UCIONI PËRGJ EGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
ORNIZA LIGJORE						
1	15	Megjithatë, hapat e mëtejshëm mund të sigurojnë përfshirje të plotë, transparencë dhe stabilitet ligjor. Disa mangësi ligjore dhe paqartësi në ligj dhe rregullore krijojnë pasiguri në aspekte të të drejtave themelore, veçanërisht sa i përket lirisë së shprehjes, përgjegjësisë financiare dhe mjeteve juridike. [...] Disa dispozitave teknike të ligjit u mungon saktësia, duke lënë kështu hapësirë për paqartësi, ndërsa afatet për shpalljen e rezultateve përfundimtare, ndër të tjera, kanë nevojë për elaborim të mëtejshëm. Gjithashtu, kornizës i mungon përcaktimi i termave të rëndësishëm që lidhen me shkeljet e Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët në fushatë dhe lë hapësirë për interpretim subjektiv.	Të sigurohet qartësi juridike duke adresuar paqartësitë dhe mangësitë përmes legjislacionit sekondar të elaboruar mirë, veçanërisht në lidhje me Kodin e mirësjelljes gjatë fushatës, emërimin e stafit të administratës zgjedhore dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.	Rregulloret/ Vendimet e KQZ-së Rregullorja e PZAP-së nr. 01/2024 për procedurat e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave	KQZ PZAP	Sundimi i ligjit Rezoluta 19/36 e Këshillit të OKB për të Drejtat e Njeriut (A/HRC/RES/19/36, 2012) 16 (c) <i>[Këshilli për të Drejtat e Njeriut]</i> “i bën thirrje shtetit të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të forcuar sundimin e ligjit dhe për të promovuar demokracinë përmes: (c) Sigurimit të një shkalle të mjaftueshme të sigurisë ligjore dhe parashikueshmërisë ... ICCPR, neni 25. ICCPR, HRC GC 25, para. 20: “...Kjo nënkupton që votuesit duhet të mbrohen [...] nga çdo ndërhyrje e paligjshme ose arbitrare në procesin e votimit.” UNCAC, neni 7(4): “Çdo Shtet Palë, [...] do të adoptojë, mirëmbajë dhe forcojë sisteme që nxisin transparencën dhe parandalojnë konfliktet e interesit.”

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTIT UCIONI PËRGJ EGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE						
2	<u>16</u>	Pavarësisht nga emërimet politike, legjislacioni zgjedhor i detyron anëtarët e KQZ-së të ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme dhe parashikon disa masa për të garantuar pavarësinë dhe profesionalizmin e tyre. Megjithatë, gjatë gjithë periudhës parazgjedhore, performanca e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) u përcoll me raste të ndikimit politik në procesin e tij vendimmarrës, si dhe nga tendenca për të interpretuar gjerësisht kompetencat e tij dhe për të vepruar jashtë fushës së mandatit të tij, e lehtësuar nga mungesa e qartësisë në dispozita të caktuara të LZP-së, duke komprometuar paanshmërinë dhe pavarësinë e tij. Përveç praktikës më solide në performancën e anëtarëve, pavarësia e KQZ-së mund të rritet përmes forcimit të masave që rregullojnë sjelljen e tyre dhe potencialisht zgjerimin e grupit të profesionistëve nga të cilët subjektet nominuese i zgjedhin anëtarët e KQZ-së me synimin për të kufizuar përkatësinë politike.	ME PRIORITET Të forcohen garancitë ligjore në lidhje me anëtarësinë dhe sjelljen e zyrtarëve zgjedhorë, për të siguruar paanshmërinë dhe pavarësinë e administratës zgjedhore.	LZP	Kuvendi	Shteti duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për t'i dhënë efekt të drejtave ICCPR, UN HRC Komenti i Përgjithshëm 25, Para. 20: “Duhet të krijohet një autoritet i pavarur zgjedhor për të mbikëqyrur procesin zgjedhor dhe për të siguruar që ai të zhvillohet në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe në përputhje me ligjet e përcaktuara të cilat janë në përputhje me Paktin” Para. 24: “Raportet shtetërore duhet të përshkruajnë kushtet për qasjen në pozitë e shërbimit publik, çdo kufizim që zbatohet dhe proceset për emërimin, ngritjen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin ose largimin nga detyra, si dhe mekanizmat gjyqësorë ose mekanizmat e tjerë të rishikimit që zbatohen për këto procese. Raportet duhet të tregojnë gjithashtu se si plotësohet kërkesa për qasje të barabartë dhe nëse janë përcaktuar masa afirmative dhe, nëse po, në çfarë mase.”

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTIT UCIONI PËRGJ EGJËS	PARIMI/ZOTIMI PËRKATËS NDËRKOMBËTAR
						Qendra e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, të Drejtat e Njeriut dhe Zgjedhjet, para. 101: “Dispozitat e ligjit duhet të sigurojnë që të ketë një strukturë administrative objektive, të paanshme, të pavarur dhe efektive. Kjo kërkon vëmendje të kujdesshme ndaj dispozitave për emërimin, shpërblimin, detyrat, kompetencat, kualifikimet dhe strukturën raportuese të stafit zgjedhor. Në të gjitha nivelet, stafi duhet të jetë i mbrojtur nga paragjykimet dhe presioni politik.” Deklarata e OKB-së për të Drejtën dhe Përgjegjësinë, neni. 11: “Çdokush që, si rezultat i profesionit të tij ose të saj, mund të ndikojë në dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve, duhet t'i respektojë ato të drejta dhe liri dhe të jetë në përputhje me standardet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare të sjelljes ose etikës profesionale.”
3	17	Kapaciteti operativ i administratës zgjedhore ishte i ngarkuar për shkak të mungesës së menaxhimit qendror të duhur si dhe mungesës së personelit të përhershëm dhe të përkohshëm. Ndërsa ligji i jep kompetenca	ME PRIORITET Të kufizohen dhe specifikohen më tej përgjegjësitë e Komisionit Qendror të	LZP Rregullorja e KQZ-së	KA	Shteti duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për t'i dhënë efekt të drejtave Parimet e Këshillit Ekonomik dhe

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
		KKZ-ve në fusha të ndryshme të administrimit dhe përgatitjeve teknike të zgjedhjeve, përfshirja e tyre nga KQZ-ja mbeti e kufizuar. Në përgjithësi, KKZ-të u vlerësuan si efikase dhe transparente, të përbëra kryesisht nga komisionerë me përvojë të mirë. Megjithatë, urdhrat e vonuar dhe udhëzimet e pamjaftueshme nga KQZ-ja, si edhe mungesa e koordinimit në terren në disa raste, penguan funksionimin e tyre. Shumë KKZ shprehën keqardhje për shpërfilljen nga KQZ-ja të propozimeve lidhur me emërimin e KVV-ve, përcaktimin e ambienteve zgjedhore dhe përzgjedhjen e trajnerëve, duke humbur mundësinë për të përfituar nga njohuritë dhe përvoja lokale. Për të adresuar çështjet e identifikuar në lidhje me sjelljen e administratës zgjedhore, autoritetet mund të konsiderojnë edhe miratimin e një akti të ri ligjor për organet e menaxhimit të zgjedhjeve, që rregullon çështjen e anëtarëve të KQZ-së, organizimin e brendshëm, përcaktimin e kompetencave, si dhe kriteret e emërimit në të gjitha nivelet e organeve zgjedhore.	Zgjedhjeve, Sekretariatit të KQZ-së dhe komisioneve komunale zgjedhore për të decentralizuar vendimmarrjen e administratës zgjedhore aty ku është e përshtatshme dhe për të siguruar që operacionet e saj të jenë efikase dhe me kohë.			Social të OKB-së për Qeverisje Efektive për Zhvillim të Qëndrueshëm, E/2018/44-E/C.16/2018/8, Paragrafi 31: “Subsidiariteti: Për të promovuar një qeveri që u përgjigjet nevojave dhe aspiratave të të gjithë njerëzve, autoritetet qendrore duhet të kryejnë vetëm ato detyra që nuk mund të kryhen në mënyrë efektive në nivel më të ndërmjetëm ose lokal.” Rekomandimi i KiE-së CM/Rec (2007)7 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për administrim të mirë: “administrimi i mirë është një aspekt i qeverisjes së mirë; që nuk ka të bëjë vetëm me rregullimet ligjore; se varet nga cilësia e organizimit dhe menaxhimit; se duhet të plotësojë kërkesat e efektivitetit, efikasitetit dhe lidhjes me nevojat e shoqërisë...”
4	17	Legjislacioni mundëson përfaqësim domethënës të subjekteve politike të kualifikuara në organet zgjedhore të nivelit më të ulët, pa ofruar kriteret mjaftueshëm të	Të përcaktohen kriteret të qarta për emërimin e këshillave të vendotimeve dhe	Rregullorja e KQZ-së	KQZ	Praktika e mirë Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias të

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
		qarta për shpërndarjen e ulëseve për subjektet politike individuale, duke i dhënë kështu KQZ-së diskrecion të gjerë në përcaktimin e formulës së emërimit. Shpërndarja fillestare nuk arriti të përmbushë plotësisht kriterin ligjor për të reflektuar rezultatet e zgjedhjeve të fundit parlamentare në nivelin komunal, në favor të disa subjekteve të reja që garojnë, duke çuar në sfida dhe rishqyrtim të më pastajmë të urdhëruar nga PZAP. Përkundër kësaj, shumë bashkëbisedues nga parti të ndryshme politike shprehën pakënaqësi për ndarjen përfundimtare të pozitive.	ekipeve të numërimit për të siguruar përfaqësim të drejtë dhe të gjerë të subjekteve politike dhe komuniteteve lokale.			Këshillit të Evropës, para II.3.1.e: “Partitë politike duhet të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në komisionet zgjedhore ose duhet të jenë në gjendje të vëzhgojnë punën e organit të paanshëm. Barazia mund të interpretohet në mënyrë të rreptë ose në bazë proporcionale.”
5	18	Ndërsa KQZ mbajti seanca publike dhe kryesisht publikoi vendimet e saj me kohë, qasja në informacione të rëndësishme mbeti e kufizuar. Vendimet e publikuara nuk janë gjithëpërfshirëse, nganjëherë mungojnë anekset dhe procesverbalet e seancave, shpeshherë mungojnë detajet për temat e diskutuara, janë në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe. Faqja e internetit e KQZ-së nuk është shumë e përshtatshme ose informuese, me shumë faqe të vjetruara. Veçanërisht pas ditës së zgjedhjeve, me problemet teknike që ndikuan në transmetimin dhe tabelimin e rezultateve të zgjedhjeve, KQZ-ja nuk arriti të informojë	Të zhvillohet një strategji gjithëpërfshirëse të komunikimit të KQZ-së dhe të publikohen të gjitha vendimet dhe informacionet përkatëse me interes publik me kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse.	Nuk kërkohet asnjë ndryshim ligjor	KQZ	Transparenca dhe qasja në informacione ICCPR, UN HRC Komenti i Përgjithshëm Nr. 34,, paragrafi 19: “Për t'i dhënë efekt të drejtës së qasjes në informacion, shtetet palë duhet të vendosin në mënyrë proaktive në domenin publik informacionin e qeverisë me interes publik. Shtetet palë duhet të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar qasje të lehtë, të shpejtë, efektive dhe praktike në një informacion të tillë.”

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTIT UCIONI PËRGJ EGJËS	PARIMI/ZOTIMI PËRKATËS NDËRKOMBËTAR
		publikun në mënyrë proaktive dhe të plotë mbi karakterin dhe ndikimin e çështjeve në menaxhimin e rezultateve dhe progresin e përgjithshëm në proces.				
REGJISTRIMI I VOTUESVE						
6	21	Me ligj, lista e votuesve do të jetë e disponueshme për publikun edhe jashtë viteve zgjedhore, për një periudhë të përcaktuar për të kontestuar të dhënat e regjistrimit të votuesve para zgjedhjeve. Gjatë kësaj periudhe, votuesit mund të kërkojnë të bëhen korrigjime të pasaktësive dhe lëshimeve në regjistrimin e tyre, ricaktim në një qendër tjetër votimi brenda komunës ku janë të regjistruar, si dhe të kundërshtojnë çdo regjistrim të votuesve që konsiderohet i pasaktë ose i pavlefshëm. Ndërsa LZP ofron mundësinë e kontestimit të regjistrimit të një votuesi nga një votues tjetër, në praktikë, votuesit kishin qasje vetëm në të dhënat e regjistrimit të tyre personal, duke kufizuar mundësitë për një shqyrtim kuptimplotë. Garuesit e certifikuar për zgjedhje dhe vëzhguesit e akredituar kanë të drejtë të marrin një kopje të LPV-së. Megjithatë, EU EOM-së pranoi raporte se njoftimet nga palët e interesit në KQZ për të dhëna të vjetruara dhe për votues të vdekur ndonjëherë mbetën të pa	Të përditësohen dhe publikohen rregullisht të dhënat e regjistrimit të votuesve, të ndara sipas vendvotimeve, dhe t'u mundësohet votuesve qasja në të dhëna të mjaftueshme dhe të detajuara të regjistrimit, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Të zhvillohet një mekanizëm i qartë dhe i rregulluar mirë për të adresuar pasaktësitë e identifikuara dhe kundërshtimet përkatëse.	Rregullorja e KQZ-së	KQZ	E drejta universale e votës E drejta dhe mundësia për të votuar ICCPR, neni 25: “Çdo qytetar do të ketë të drejtën dhe mundësinë... Të votojë dhe të zgjidhet në zgjedhje të mirëfillta periodike, të cilat do të jenë me votim të përgjithshëm dhe të barabartë.” Transparenca dhe qasja në informacion ICCPR, UN HRC Komenti i Përgjithshëm Nr. 34, paragrafi 18: “Neni 19, paragrafi 2 përfshin të drejtën e qasjes në informacionin që posedojnë organet publike. Një informacion i tillë përfshin të dhënat e mbajtura nga një organ publik, pavarësisht nga forma në të cilën

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTIT UCIONI PËRGJ EGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
		adresuara. Vetëm numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar nga komunat dhe qendrat e votimit ishin të disponueshëm për publikun.				<i>ruhet informacioni, burimin e tij dhe datën e prodhimit.”</i> Praktika e mirë Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës, para. Para. I.1.2.ii: 1.2.ii “Duhet të ketë përditësim të rregullt (të listave të votuesve), të paktën një herë në vit.” Para. I.1.2.iii: “Regjistrat zgjedhorë duhet të publikohen.”

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
7	22	Lista përfundimtare e votuesve e certifikuar për zgjedhjet parlamentare 2025 përfshinte gjithsej 2,075,868 votues. Për shkak të migrimit dhe zhvendosjes, lista e votuesve përmban një numër më të madh regjistrimesh sesa regjistrimi i popullsisë i vitit 2024, i cili e përcakton popullsinë rezidente të Kosovës të jetë 1,602,515 banorë. Në mungesë të të dhënave zyrtare për diasporën kosovare, Agjencia e Regjistrimit Civil vlerëson se rreth një milion kosovarë jetojnë jashtë Kosovës. Ndërsa dallimi mes të dhënave të regjistrimit të votuesve dhe atyre të popullsisë mund t'i atribuohet metodologjive të ndryshme të përpilimit të këtyre të dhënave, shqetësimet mes palëve të interesit vazhdojnë në lidhje me të dhënat e vjetruara si dhe me regjistrimet e votuesve të vdekur në listën e votuesve, kryesisht për shkak të të metave në regjistrimin civil..	ME PRIORITET Të bëhet një auditim gjithëpërfshirës i pavarur i listës së votuesve, duke përfshirë përmes analizës së brendshme të proceseve të regjistrimit dhe testimit statistikor dhe në terren, në konsultim me palët përkatëse të interesit për të adresuar shqetësimet mbi saktësinë e tyre dhe për të rritur besimin e publikut.	Nuk kërkohet asnjë ndryshim ligjor	KQZ	E drejta universale e votës ICCPR, neni 25: “Çdo qytetar do të ketë të drejtën dhe mundësinë... Të votojë dhe të zgjidhet në zgjedhje të mirëfillta periodike, të cilat do të jenë me votim të përgjithshëm dhe të barabartë.” Shteti duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të garantuar realizimin e të drejtave. ICCPR, neni 2(2): “Aty ku nuk është parashikuar tashmë nga masat ekzistuese legislative ose masa të tjera, çdo shtet palë e këtij Pakti merr përsipër të ndërmarrë hapat e nevojshëm, në përputhje me proceset e tij kushtetuese dhe me dispozitat e këtij Pakti, për të miratuar ligje ose masa të tjera që mund të jetë e nevojshme për të zbatuar të drejtat e njohura në këtë Pakt.”

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
AMBIENTI I FUSHATËS						
8	25	Financimi publik mund të ofrohet për fushatat zgjedhore, nga të cilat 90 për qind ndahen në bazë të numrit të ulëseve në Kuvendin e Kosovës, ndërsa 10 për qind u ndahet proporcionalisht të gjitha subjekteve politike të regjistruara së fundmi e të certifikuara nga KQZ për zgjedhje dhe jo më shumë se 0.05 për qind të buxhetit vjetor. Kjo dispozitë duke mos qenë e detyrueshme nuk është zbatuar asnjëherë, duke krijuar një terren të pabarabartë mes garuesve, veçanërisht për subjektet e vogla politike nga komunitetet joshumicë.	Të bëhet e detyrueshme dispozita për ndarjen e fondeve publike për të gjitha subjektet politike të certifikuara për të krijuar kushte të barabarta për të gjithë.	Dispozita duhet të zbatohet ose të bëhen të detyrueshme me ndryshimin e LFPP	(Kuvendi)	E drejta e barabartë e votës Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës, 2002 (I.2.3.) Barazia e mundësive (a.) <i>Barazia e mundësive duhet të garantohet si për partitë ashtu edhe për kandidatët. Kjo kërkon një qëndrim neutral nga autoritetet shtetërore, veçanërisht në lidhje me: i. fushatën zgjedhore; ii. mbulimin nga media, në veçanti nga mediat publike; iii. financimin publik të partive dhe fushatave.</i>
9	26	Siç parashikohet me ligj, fushata zgjedhore dhe kodi i sjelljes duhet të monitorohen nga autoritetet përkatëse. Megjithatë, gjatë gjithë fushatës, “Zyra” në kuadër të KQZ-së nuk monitoroi aktivitetet e fushatës në mënyrë sistematike në të gjitha komunat për shkak të sfidave të rekrutimit dhe paaftësisë institucionale. Monitoruesit ose u rekrutuan vetëm për gjysmën e periudhës së fushatës ose nuk u rekrutuan fare, gjë që rezultoi me mbetjen e një pjesë të konsiderueshme të fushatës zgjedhore pa u monitoruar.	Sigurimi i monitorimit sistematik dhe efektiv të fushatës zgjedhore duke përfshirë termat e duhura të referencës dhe procedurat e rekrutimit për monitoruesit e fushatës së KQZ-së.	Nuk kërkohet asnjë ndryshim ligjor	KQZ	E drejta e votës e lirë Transparenca dhe qasja në informacione UNCAC neni 7.3. <i>“Çdo shtet palë po ashtu duhet të marr parasysh ndërmarrjen e masave të duhura legislative dhe administrative, në përputhje me objektivat e këtij Pakti dhe në pajtim me parimet themelore të të drejtës vendore, për të rritur transparencën në financimin e</i>

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTIT UCIONI PËRGJ EGJËS	PARIMI/ZOTIMI PËRKATËS NDËRKOMBËTAR
						kandidaturave për pozita publike të zgjedhura dhe, kur është e aplikueshme, në financimin e partive politike.” Neni 7. 4. Çdo Shtet Palë, në përputhje me parimet themelore të ligjit të brendshëm, përpiqet të miratojë, mirëmbajë dhe forcojë sisteme që nxisin transparencën dhe parandalojnë konfliktin e interesit. Paragrafi 7.7 i Dokumentit të Kopenhagës, OSBE, 1990: Të sigurohet që ligji dhe politika publike të funksionojnë për të mundësuar që fushata politike të zhvillohet në një atmosferë të drejtë dhe të lirë, në të cilën veprimi administrativ, dhuna apo kërcënimi nuk i pengojnë partitë dhe kandidatët të prezantojnë lirisht pikëpamjet dhe kualifikimet e tyre, ose të pengojnë votuesit të mësojnë dhe diskutojnë mbi to ose të japin votën e tyre pa frikë nga hakmarrja.

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
FINANCIMI I FUSHATËS						
10	27	LZP modifikon kërkesat për raportimin e shpenzimeve të fushatës duke përcaktuar një pikë fillestare prej 90 ditësh para zgjedhjeve për të raportuar të ardhurat dhe shpenzimet përkatëse të subjekteve politike që marrin pjesë në zgjedhje. Afati i fundit për raportimin të hyrave dhe shpenzimeve të fushatës nga subjektet politike caktohet 30 ditë kalendarike pas certifikimit të rezultateve. Nuk ka ndonjë kërkesë në ligj për raportimin e ndërmjetëm të të ardhurave dhe shpenzimeve të garuesve gjatë periudhës së fushatës dhe kandidatëve individualë dhe financimi i fushatës nga palët e treta mbetet i parregulluar duke kufizuar mundësinë e shqyrtimit publik para ditës së zgjedhjeve.	Të fillohet të aplikohet raportimi i ndërmjetëm dhe publikimi i të ardhurave të garuesve gjatë periudhës së fushatës. Raportimi përfundimtar duhet të përfshijë të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve individualë dhe subjekteve që bëjnë fushatë për garuesit (palët e treta).	LZP, Ligji për Financimin e Partive Politike	Kuven di	Transparenca dhe qasja në informacione Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (2003)4, Neni 13: 13 “Shtetet duhet të kërkojnë nga partitë politike që t’i paraqesin llogaritë [...]rregullisht, dhe të paktën çdo vit, autoritetit të pavarur [...]. Shtetet duhet të kërkojnë nga partitë politike që rregullisht, dhe të paktën çdo vit, të bëjnë publike llogaritë [...] ose së paku një përmbledhje të atyre llogarive.” Paragrafi 256 i Udhëzimeve të Komisionit të Venecias dhe ODIHR 2020 për Rregullimin e Partive Politike: “[...] është me rëndësi që disa forma të rregullimit, me detyrime dhe kufizime të krahasueshme që zbatohen për partitë dhe kandidatët, të zbatohen edhe për palët e treta që janë të përfshira në fushatë, për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie. Palët e treta duhet tu nënshtrohen rregullave të ngjashme për donacionet dhe shpenzime sikurse

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTIT UCIONI PËRGJ EGJËS	PARIMI/ZOTIMI PËRKATËS NDËRKOMBËTAR
						<i>partitë politike për të shmangur situatat kur palët e treta mund të përdoren për të anashkaluar rregulloret për financimin e fushatës.”</i> Parandalimi i korrupsionit/ drejtësia në fushatën zgjedhore ICCPR, neni 25. ICCPR, HRC GC 25, para. 20: “...Kjo nënkupton që votuesit duhet të mbrohen [...] nga çdo ndërhyrje e paligjshme ose arbitrare.” Konventa e OKB kundër Korrupsionit (UNCAC), Neni 6.2: “Çdo Shtet Palë do t’i garantojë organit ose organeve [...] pavarësinë e nevojshme [...] për t’i mundësuar organit ose organeve të kryejnë funksionet e tij ose të tyre në mënyrë efektive dhe të lirë nga çdo ndikim i papërshtatshëm. Duhet të sigurohen burimet e nevojshme materiale dhe personeli i specializuar, si dhe trajnimi që ky personel mund të kërkojë për të ushtruar funksionet e tij.” UNCAC, neni 7(3): “Çdo shtet palë po

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTIT UCIONI PËRGJ EGJËS	PARIMI/ZOTIMI PËRKATËS NDËRKOMBËTAR
						ashtu duhet të marr parasysh ndërmarrjen e masave të duhura legislative dhe administrative, në përputhje me objektivat e këtij Pakti dhe në pajtim me parimet themelore të të drejtës vendore, për të rritur transparencën në financimin e kandidaturave për pozita publike të zgjedhura dhe, kur është e aplikueshme, në financimin e partive politike.” UNCAC, neni 7(4): “Çdo Shtet Palë, [...] do të adoptojë, mirëmbajë dhe forcojë sisteme që nxisin transparencën dhe parandalojnë konfliktet e interesit.”
KONTESTET ZGJEDHORE						
11	<u>28</u>	Gjatë fushatës u parashtruan rreth 400 ankesa në PZAP për shkelje të kodit të mirësjelljes gjatë fushatës, të cilat rezultuan me gjopa substanciale të shqiptuara ndaj subjekteve politike, veçanërisht për shkelje të përsëritura, në vlerë totale prej rreth €642,000. Shkeljet kryesisht kishin të bënin me vendosjen e materialit të fushatës në vende publike, nxitjen e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes, keqpërdorimin e funksioneve dhe resurseve publike dhe shfrytëzimin e fëmijëve në fushatë. Shumica e rasteve janë	ME PRIORITET Të prezantohen përkufizime të qarta ligjore të termave kyç, përfshirë ato që lidhen me gjuhën nxitëse dhe përkufizimin e një 'mbështetësi të subjektit politik' brenda procesit zgjedhor. Të vendosen kritere të qarta për përcaktimin e gjobave	Rregullorja e KQZ-së Rregullorja e KQZ-së Nr. 01/2024 LZP	KQZ PZAP Kuvendi	Sundimi i ligjit E drejta për mjet juridik efektiv DUDNJ, neni 8: “Çdokush ka të drejtë për një mjet juridik efektiv [...]”. ICCPR, neni 2(2): “[...] të miratojë ligje ose masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për t'i zbatuar të drejtat [...]”.

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
		paraqitur nga LVV, e ndjekur nga PDK dhe LDK, ndërsa shumica janë paraqitur kundër LVV-së, LDK-së dhe PDK-së. Në disa raste, subjektet politike janë gjobitur më shumë se një herë për të njëjtën shkelje për shkak të dështimit për ta korrigjuar atë në mungesë të një urdhri përkatës të PZAP-së. Në disa raste të tjera kur subjektet ndërmorën masa korrigjuese gjatë procedurës, paneli e konsideroi këtë një faktor lehtësues duke ulur gjobën përkatëse. Gjopa u vendosën edhe për subjektet politike për shkelje të kodit të sjelljes nga mbështetësit e pretenduar. Kriteret që përcaktonin shumën e gjobave të vendosura nuk ishin gjithmonë të qarta për garuesit, të cilët në disa raste ankoheshin për trajtim të njëanshëm nga PZAP.	proporcionale të zbatueshme për shkeljet e Kodit të Mirësjelljes nga subjektet politike.			ICCPR, neni 19(2): “[...] liria për të parë, marrë dhe dhënë informacion [...]”. ICCPR, neni 2(3)(a)3: “Secili shtet palë [...] zotohet të sigurojë që çdo person, kur t’i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv.”
12	29	Për gjobat më të ulëta se 5,000 € të shqiptuara ndaj subjekteve më të vogla politike me më pak resurse nuk mund të bëhet ankesë, duke i privuar ato nga mjetet juridike efektive. [...] Ligji përcakton afate të qarta kohore dhe hapa të artikuluar mirë për shqyrtimin e kontesteve zgjedhore. Megjithatë, për të garantuar siguri ligjore dhe mund të përfitojë nga qartësia e mëtejshme, veçanërisht në lidhje me përcaktimin dhe interpretimin e shkeljeve të caktuara, kriterëve për përcaktimin e shumës së	Të lejohet që të gjitha vendimet apo veprimet e KQZ-së të mund të kontestohen brenda procesit zgjedhor dhe që të gjitha vendimet e PZAP-it të mund të apelojnë në Gjykatën Supreme.	LZP KQZ Rregullorja e Punës Rregullorja e KQZ-së Nr. 01/2024	Kuven di KQZ	Sundimi i ligjit E drejta për mjet juridik efektiv DUDNJ, neni 8: “Çdokush ka të drejtë për një mjet juridik efektiv [...]”. ICCPR, neni 2(2): “[...] të miratojë ligje ose masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për t’i zbatuar të drejtat [...]”.

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
		gjjobave të shqiptuara dhe zgjerimin e të drejtës për ankim ndaj vendimeve të KQZ-së që nuk parashikohen shprehimisht në LZP.				ICCPR, neni 19(2): “[...] liria për të parë, marrë dhe dhënë informacion [...]”. ICCPR, neni 2(3)(a)3: “Secili shtet palë [...] zotohet të sigurojë që çdo person, kur t’i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv.”
MEDIAT						
13	<u>30</u>	Transmetuesi publik RTK është përballur me sfida politike dhe institucionale përgjatë viteve, përfshirë shqetësimet për pavarësinë e tij. Në vitin 2023 dhe 2024 një polemikë në lidhje me një publikim të një artikulli që pretendonte se disa media në gjuhën shqipe financoheshin nga Serbia, çoi në dorëheqjen e udhëheqësve të RTK-së. Ndërsa RTK-ja arriti të ndryshojë rregullat e saj në lidhje me emërimin e një drejtori të ri të përgjithshëm që mbikëqyr operacionet, bordit të RTK-së i mungon kuorumi, pasi i kanë mbetur vetëm katër nga 11 anëtarët. Organi qeverisës i RTK-së mbështetet në orarin e Kuvendit të Kosovës dhe është i ndjeshëm ndaj ndikimit politik të partisë qeverisëse kur zgjedh anëtarët e bordit të saj me shumicë të thjeshtë dhe cakton buxhetin e tij në	Të sigurohet qëndrueshmëria financiare, rritja dhe pavarësia e transmetuesit publik, të alokohet buxheti e tij sipas ligjit dhe të zgjidhen anëtarët e bordit të tij nga Kuvendi i Kosovës me kohë.	Nuk kërkohet asnjë ndryshim ligjor	Kuveni di	Liria e mendimit dhe e shprehjes Sundimi i ligjit ICCPR, neni 19, Komenti i përgjithshëm 34, para. 16: “Shtetet palë duhet të sigurojnë që shërbimet e transmetimit publik të funksionojnë në mënyrë të pavarur. Veprimet për të garantuar pavarësinë mund të përfshijnë përcaktimin e mandatit të këtyre transmetuesve në ligj dhe sigurimin e garancive legislative të pavarësisë dhe lirisë redaktuese, si dhe sigurimin e financimit në një mënyrë që nuk cenon pavarësinë.” Rekomandimet e Komitetit të

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
		baza vjetore.				Ministrave të Këshillit të Evropës (2012)1, Neni 26.: "...- mediat e shërbimit publik konsultohen për nivelin e financimit të nevojshëm për të përmbushur misionin dhe qëllimet e tyre dhe pikëpamjet e tyre merren parasysh gjatë përcaktimit të nivelit të financimit. Financimi i ofruar është i mjaftueshëm për të përmbushur rolin dhe përgjegjësinë e dakorduar të medias së shërbimit publik, përfshirë ofrimin e sigurisë së mjaftueshme për të ardhmen për të mundësuar një planifikim të arsyeshëm në të ardhmen."
14	30	Transmetuesi publik i mandatuar për të transmetuar në gjuhën shqipe, serbe dhe në gjuhët e tjera joshumicë funksionon me mjete të kufizuara financiare, veçanërisht kanali i tij televiziv që transmeton kryesisht në gjuhën serbe, RTK2. Stacioni televiziv është detyruar të zvogëlojë cilësinë e programeve të tij, shikueshmëria e tij është e ulët, duke rezultuar në hezitimin e konkurrentëve politikë për t'u përfshirë në përmbajtjen e këtij kanali televiziv për zgjedhjet. Pesë kanalet e tjera private televizive në gjuhën serbe gjithashtu operojnë me mbulim të kufizuar, duke lënë partitë	Të forcohen stacionet televizive dhe të radios të transmetuesit publik për t'i shërbyer në mënyrë efikase të gjitha komuniteteve joshumicë. Të sigurohet i mbështetjes financiare, teknike dhe ngritjes së kapaciteteve për të siguruar transmetim cilësor të shërbimit publik me përmbajtje të ndryshme në gjuhën serbe dhe në gjuhët	Ndryshimi i Ligjit për RTK-në	Kuveni	Liria e mendimit dhe e shprehjes Drejtësia në fushatën zgjedhore Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (2018)1, Neni 2.6: "Shtetet duhet të bëjnë përpjekje të veçanta, duke përfituar nga zhvillimet teknologjike, për të siguruar që diversiteti i mundshëm i transmetimit të përmbajtjes mediatike, përfshirë përmbajtjen me interes të përgjithshëm, të jetë i qasshëm për të gjitha grupet e shoqërisë, veçanërisht për ato që mund të kenë nevoja specifike

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
		joshumicë serbe pa një kanal televiziv efektiv të transmetimit për fushatë.	joshumicë.			ose që përballen me situata të pafavorshme ose pengesa për qasjen në përmbajtjen mediatike, siç janë grupet pakicë, refugjatët, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara fizike ose kognitive. Udhëzimet e Talinit për Pakicat Kombëtare dhe Mediat në Epokën Digjitale, OSBE, 2019, neni. I.2: Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të përmbushur detyrimin e tyre pozitiv për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për debat publik të fuqishëm pluralist, në të cilin të gjithë, përfshirë edhe personat që u përkasin pakicave kombëtare, mund të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të shprehin mendimet, idetë dhe identitetet e tyre pa frikë.
15	32	Bordi i KPM-së nuk ishte në gjendje t'i përmbush obligimet e veta ligjore dhe të shqiptojë sanksione për shkak të mungesës së kuorumit në bordin e tij vendimmarrës gjatë fushatës zgjedhore. Mjetet e informimit që shkelin ligjet dhe rregulloret duhet të presin për një periudhë të gjatë pas zgjedhjeve për të mësuar rreth sanksioneve të mundshme.	ME PRIORITET Të emërohen me kohë të gjithë anëtarët e KPM-së përmes një procesi përzgjedhës konkurrues dhe transparent.	Nuk kërkohet asnjë ndryshim ligjor	Kuveni	Sundimi i ligjit Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (2000)23, neni I.1: “Shtetet anëtare duhet të sigurojnë krijimin dhe funksionimin e papenguar të autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit duke hartuar një kornizë të duhur

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
						<i>legislative për këtë qëllim. Rregullat dhe procedurat që rregullojnë ose ndikojnë në funksionimin e autoriteteve rregullatore duhet të afirnojnë dhe mbrojnë në mënyrë të qartë pavarësinë e tyre.”</i> Direktiva (EU) 2018/1808 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, neni 30(4) Shtetet anëtare do të sigurojnë që autoritetet ose organet rregullatore kombëtare të kenë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore dhe fuqi zbatuese për të ushtruar funksionet e tyre në mënyrë efektive dhe për të kontribuar në punën e ERGA-s.”
MEDIAT SOCIALE						
16	36	Krypometër dhe Hybrid.info, dy organizata shqiptare të Kosovës, zbatojnë programe të verifikimit të fakteve, me mbështetjen e BE-së dhe donatorëve të tjerë ndërkombëtarë. Ndërsa ata demaskojnë përmbajtje nga rrjetet sociale dhe artikuj si nga burime shqiptare ashtu edhe serbe, ata publikojnë vetëm në gjuhën shqipe. [...] Alternativna, një medium serb i lajmeve me bazë në Mitrovicën Veriore, gjithashtu bën verifikime rastësore të fakteve për lajmet në gjuhën serbe.	Të zhvillohet një përpjekje e koordinuar midis mediave, shoqërisë civile dhe kompanive të teknologjisë për të forcuar iniciativat ekzistuese të verifikimit të fakteve, për të rritur shtrirjen e tyre përmes publikimit të përmbajtjes së tyre edhe në gjuhët e komuniteteve joshumicë dhe për të	Nuk kërkohet asnjë ndryshim ligjor	Media, OSHC-të, sektori privat, KPM	E drejta e qasjes në informacione ICCPR GC 25, para. 19: “Personat me të drejtë vote duhet të jenë të lirë të votojnë për çdo kandidat në zgjedhje [...] dhe të lirë të mbështesin ose të kundërshtojnë qeverinë, pa ndikim të paligjshëm ose detyrim të çfarëdo lloji që mund të shprehënjë ose pengojë shprehjen e lirë të vullnetit të votuesit. Votuesit duhet të jenë në gjendje të formojnë opinione në mënyrë të

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PËRKATËS NDËRKOMBËTAR
			siguruar qëndrueshmërinë e tyre.			<i>pavarur, pa [...] nxitje ose ndërhyrje manipulative të çfarëdo lloji.”</i> Drejtësia në fushatën zgjedhore ICCPR, GC 25, para. 19: “<i>Votuesit duhet të jenë në gjendje të formojnë opinione në mënyrë të pavarur, pa dhunë apo kërcënim për dhunë, detyrim, nxitje apo ndërhyrje manipuluese të çfarëdo lloji.”</i> Deklarata e Përbashkët OKB, OAS, OSBE për lirinë e shprehjes dhe lajmet e rreme, dezinformim dhe propagandë, neni 3.e: “<i>Shtetet duhet të marrin masa për të promovuar edukimin mediatik dhe digjital, duke i përfshirë këto tema si pjesë e kurrikulës së rregullt shkollore dhe duke u angazhuar me shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesit për të rritur ndërgjegjësimin rreth këtyre çështjeve.”</i> Neni 3.f: “<i>Shtetet duhet të mendojnë edhe për masa të tjera për të promovuar barazinë (...), duke përfshirë qëllimin për të adresuar efektet negative të dezinformimit dhe propagandës.”</i>

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
PJESËMARRJA E GRAVE						
17	38	Gratë do të përbëjnë 37.5 për qind të Kuvendit të ardhshëm të Kosovës dhe shumica e tyre janë zgjedhur pa aplikimin e kuotës gjinore. Megjithatë, partitë politike ende dominohen nga burrat, dhe ato nuk e kanë adresuar mjaftueshëm pabarazinë gjinore në organet e tyre qeverisëse – siç përcaktohet me Ligjin për Barazi Gjinore. Burrat gjithashtu kishin një prani dominuese gjatë periudhës së fushatës, duke përfaqësuar një shumicë të konsiderueshme të folësve në ngjarjet e fushatës dhe debatet televizive. Pavarësisht dispozitave në LZP që inkurajojnë një ekuilibër më të madh gjinor në administratën zgjedhore, gratë përbëjnë më pak se 30 për qind të anëtareve në nivel qendror dhe lokal.	Të rritet përfaqësimi i grave në institucionet e zgjedhura dhe në administratën zgjedhore duke krijuar strategji të fuqishme për rekrutimin dhe promovimin e grave brenda strukturave qeverisëse të partive dhe në listat e kandidatëve.	Nuk kërkohet asnjë ndryshim ligjor	Partitë politike	Pjesëmarrja e grave në çështjet publike Sundimi i ligjit ICCPR, neni 3: “Shtetet palë të këtij Pakti marrin përsipër të garantojnë të drejtën e barabartë të burrave dhe grave për të gëzuar të gjitha të drejtat civile dhe politike të përcaktuara në këtë Pakt.” Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), neni 4, para. 1: “Miratimi nga Shtetet Palë i masave të posaçme të përkohshme që synojnë përshpejtimin e barazisë de facto midis burrave dhe grave nuk do të konsiderohet diskriminim.” CEDAW, Rekomandimi i përgjithshëm Nr. 23, para. 22: “Sistemi i votimit, shpërndarja e ulëseve në Parlament, përzgjedhja e zonës zgjedhore, të gjitha kanë ndikim të rëndësishëm në përqindjen e grave të zgjedhura në Parlament. Partitë politike duhet të përqafojnë parimet e mundësive të barabarta dhe demokracisë dhe të

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
						<i>përpigjen të balancojnë numrin e kandidatëve meshkuj dhe femra.”</i>
PJESËMARRJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA						
18	41	Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor u shoqërua me sfida për shkak të mungesës së qasjes në qendrat e votimit dhe mjeteve ndihmëse, si dhe nga zbatimi jokonsistent i dispozitave të reja në lidhje me votimin e asistuar. Përveç kësaj, organizatat e personave me aftësi të kufizuara raportuan për mungesë të konsultimi nga KQZ-ja dhe KKZ-të në lidhje me fushatat për edukimin e votuesve dhe regjistrimin e votuesve me nevoja të veçanta.	Të përmirësohet qasja në qendrat e votimit dhe mjetet ndihmëse për t'u mundësuar personave me aftësi të kufizuara të votojnë në mënyrë të pavarur në mënyrë të barabartë me të tjerët. Të ndërtohen marrëdhënie bashkëpunimi me organizatat e personave me aftësi të kufizuara për t'ua përshtatur iniciativat për edukimin e votuesve kategorive të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.	Nuk kërkohet asnjë ndryshim ligjor	Autoritetet qendrore Autoritetet komunale KQZ	E drejta dhe mundësia për të votuar ICCPR, neni 25: <i>"Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: b) Të zgjedh dhe të zgjidhet gjatë zgjedhjeve të mirëfillta periodike, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve".</i> CRPD, neni 29: <i>"Shtetet palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuar të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato në mënyrë të barabartë si të tjerët."</i> CRPD, neni 9: <i>"Për të mundësuar që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si të gjithë të tjerët, të kenë qasje në ambientet fizike, në</i>

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
						<i>transport, në informacion dhe komunikim, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në objekte dhe shërbime të tjera të hapura ose të ofruara për publikun, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale.”</i>
VOTIMI, NUMËRIMI DHE TABELIMI I REZULTATEVE						
20	46	Natën e zgjedhjeve, KQZ-ja përjetoi probleme serioze teknike me platformën digjitale të sapo prezantuar për menaxhimin e rezultateve dhe sistemet e saj të TI-së nuk ishin të disponueshme për një periudhë të gjatë, duke ndikuar në tabelimin dhe publikimin e rezultateve preliminare dhe marrjen e materialeve zgjedhore në qendrat komunale të numërimit. Problemet e vazhdueshme teknike dhe jostabiliteti i softuerit çuan në shtyrjen e numërimit të votave preferenciale dhe ndikuan në operacionet në QKN-ve. Si pasojë, faqja e internetit për publikimin e rezultateve preliminare u bë e padisponueshme menjëherë pas mbylljes së qendrave të votimit. Pastaj, janë vërejtur pasaktësi dhe lëshime në të dhënat e transmetuara. Për të kapërcyer problemet teknike, KQZ-ja lëshoi në përdorim një faqe të re interneti më vonë gjatë procesit, duke shfaqur grupe të ndryshme të dhënash për shkak të	ME PRIORITET Të krijohet një sistem i besueshëm dhe transparent i menaxhimit të rezultateve me procedura të qarta dhe të verifikueshme për të siguruar përpunimin e saktë të të dhënave të rezultateve. Të sigurohet qasje e shpejtë në rezultatet preliminare, duke përfshirë të gjitha të dhënat përkatëse, si p.sh. pjesëmarrja e votuesve, votat e vlefshme dhe të pavlefshme, si dhe formularët e rezultateve të skanuara për vendvotim.	Nuk kërkohet asnjë ndryshim ligjor	KQZ	Transparenca dhe qasja në informacione ICCPR, UN HRC Komenti i Përgjithshëm Nr. 34: Para. 18: “Neni 19, paragrafi 2 përfshin të drejtën e qasjes në informacionin që posedojnë organet publike. Informacion i tillë përfshin të dhënat e mbajtura nga një organ publik, pavarësisht nga forma në të cilën është ruajtur informacioni, burimi i tij dhe data e prodhimit.” Para. 19: “Për të zbatuar të drejtën e qasjes në informacion, Shtetet palë duhet të vendosin në mënyrë proaktive në domenin publik informacionin qeveritar që është me interes publik. Shtetet palë duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të siguruar qasje të lehtë, të shpejtë, efektive dhe praktike në një informacion të tillë.”

NR.	FR Faqe	KONTEKSTI	REKOMANDIMI	NDRYSHIMI I SUGJERUAR NË KORNIZËN LIGJORE	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	PARIMI/ZOTIMI PÛRKATËS NDËRKOMBËTAR
		korrigjimeve të bëra pas verifikimit të rezultateve dhe numërimit në QKN, që kishte mundësi të çonte në konfuzion publik. Për më tepër, të dhënat e publikuara të rezultateve nuk përfshinin të gjitha informacionet e rëndësishme, siç është numri i votave të pavlefshme.				Praktika e mirë Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të KiE mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në proceset zgjedhore, neni 5: “Zgjidhjet e TIK-ut duhet të jenë të disponueshme dhe të besueshme. Një zgjidhje e TIK duhet të jetë funksionale, në përputhje me kërkesat dhe supozimet edhe në rast të dështimit të sistemit ose gabimeve nga përdoruesit ose të tjerët, ose në rast të sulmeve. Për më tepër, zgjidhja e TIK duhet të jetë e sigurt. Ajo duhet të ruajë funksionalitetin e tij, pavarësisht nga mangësitë në harduer apo softuer në pjesë të tjera të procesit zgjedhor.”

XXII. ANEKSI 1 – REZULTATET E ZGJEDHJEVE⁹⁷

Numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar	2.075,868
<i>Numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar për votim me postë</i>	84,508* (84,600)
<i>Numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar për votim personal jashtë Kosovës</i>	20,416* (20,324)
Numri i përgjithshëm i votuesve që votuan	966,283
Numri i përgjithshëm i votave të vlefshme (fletëvotime të pranuar)	938,010
Numri i përgjithshëm i votave të pavlefshme (përfshirë fletëvotimet e zbrazëta)	27,433

*Në momentin e certifikimit zyrtar të listës përfundimtare të votuesve më 4 janar 2025. Numrat në kllapa tregojnë votuesit që kishin të drejtë të përdornin njërën nga metodat e votimit jashtë Kosovës (VjK) pas anulimit të disa qendrave të votimit jashtë vendit.

Lista e kandidatëve (sipas renditjes në fletëvotim)	Votat	Përqindja	Mandatet
Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)	4,688	0.50	1
<i>Srpska Lista (SL)</i>	39,915	4.26	9
Partia e Bashkuar Gorane (JGP)	1,734	0.18	1
Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK)	1,350	0.14	1
Partia Liberale Egjiptiane (PLE)	3,251	0.35	1
Demokracia Serbe (SD)	3,271	0.35	--
Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar (PBKDSH)	621	0.07	--
<i>Lëvizja Vetëvendosje! (LVV)</i>	396,787	42.30	
Partia e Re Demokratike (NDS)	4,158	0.44	1
Partia e Serbëve të Kosovës (PKS)	462	0.05	--
Koalicioni Ynë Boshnjak (Nisma Jonë dhe Partia Boshnjake)	1,553	0.17	--
Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës (KDTP)	642	0.07	--
Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI)	2,196	0.23	1
Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	171,357	18.27	20
Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës – Lëvizja për Bashkëpunim (PDAK-LPB)	2,056	0.22	--
Nisma Qytetare për Drejtësi Kombëtare (GI NP)	620	0.07	--
Bashkimi Social Demokrat (SDU)	3,042	0.32	1
Fatmir Bytyqi	191	0.02	--
Koalicioni për Familjen	20,023	2.13	--
Partia Turke e Lëvizjes Inovative (YTHP)	1,800	0.19	--
Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	196,474	20.95	24
Për Liri Drejtësi dhe Mbijetesë (SPO)	4,139	0.44	1
Lëvizja Kombëtare Serbe (SNP)	1,846	0.20	--
Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP)	4,824	0.51	2
Koalicioni <i>Vakat</i>	3,471	0.37	1
<i>Opre Roma Kosova (ORC)</i>	384	0.04	--
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – Nisma Socialdemokrate (AAK-NISMA)	66,256	7.06	8
<i>FJALA</i>	899	0.10	--

⁹⁷ Bazuar në [statistikat e ofruara nga KQZ](#) dhe [Vendimi i KQZ-së nr. 01-727/2025](#) i miratuar më 15 mars 2025.

XXIII. ANEKSI 2 – REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE

EU EOM monitoroi një mostër të mediave transmetuese kombëtare gjatë fushatës zgjedhore 30-ditore. Monitorimi i mediave përfshinte monitorim sasior dhe cilësor të pesë stacioneve televizive, dhe monitorim cilësor të mediave të përzgjedhura online për të vlerësuar pasqyrimin mediatik të fushatës dhe çështje të tjera politike, duke vlerësuar kohën dhe tonin e dedikuar për kandidatët, partitë politike, zyrtarët publikë, ministrat e qeverisë dhe subjektet e tjera me rëndësi politike. Gjithashtu u vlerësua edhe balanca gjinore nëpër mediat e monitoruara. Kjo kontribuoi në vlerësimin e EU EOM-së mbi pjesëmarrjen e grave në jetën politike.

Monitorimi gjithashtu përcolli edukimin e votuesve nga ana e KQZ-së në media. Tërë transmetimi i mbuluar televiziv ishte në gjuhën shqipe, ndërsa mediat online u monitoruan në mënyrë cilësore në gjuhën serbe.

Mostra e monitorimit për mediat audiovizuale përfshinte transmetuesin shtetëror kryesor dhe katër kanale private televizive me shtrirje pothuajse në gjithë vendin:

Pesë kanalet televizive (monitorimi sasior)

RTK1 – Kanali kryesor televiziv publik (rrjet tokësor me mbulueshmëri në tërë vendin, në gjuhën shqipe)
T7 – Kanali televiziv privat (TV kabllor mbulueshmëri në tërë vendin, në gjuhën shqipe)
TV DUKAGJINI - Kanali televiziv privat (TV kabllor me mbulim në tërë vendin, në gjuhën shqipe)
KLAN KOSOVA - Kanali televiziv privat (TV kabllor me mbulueshmëri në tërë vendin, në gjuhën shqipe)
ATV - Kanali televiziv privat, (TV kabllor mbulueshmëri në tërë vendin, në gjuhën shqipe)

Kanalet televizive u monitoruan në mënyrë sasiore nga data 11 janar deri më 8 shkurt në kohën kryesore të transmetimit, çdo ditë nga ora 18:00 deri në orën 24:00. Më 9 shkurt, ditën e zgjedhjeve, mediat u monitoruan në aspektin cilësor për respektimin e heshtjes së fushatës, si dhe gjatë periudhës së numërimit.

Koha totale e ndarë për komunikim politik gjatë kohës kryesore të transmetimit në mediat transmetuese kombëtare

Gjatë periudhës 29 ditore të monitorimit, EU EOM monitoroi gjithsej 870 orë të transmetimit dhe transmetimit të koduar televiziv me gjithsej 371 orë, 28 minuta dhe 16 sekonda.


Si të lexoni grafikët: Grafikët me shtylla/kolona/rrathë paraqesin shpërndarjen e kohës së transmetimit (në përqindje) të ndarë për partitë politike nga çdo media, si dhe tonin e mbulimit (negativ, neutral, pozitiv) të ndarë nga media për garuesit, me kohën bazë të transmetimit në kategoritë përkatëse.

Grafiku 1 – paraqet përqindjen e përmbajtjes politike dhe zgjedhore në mediat transmetuese, të koduara nga Njësia e Monitorimit të Mediave (NJMM).

Volume of political and electoral coverage

11 January till 9 February 18:00 - 24:00

■ POL/ELEC COVERAGE ■ Other




Base Airtime: ATV 53:41:08, Dukagjini 99:43:39, KLAN KOSOVA 89:21:29, RTK1 55:10:55, T7 73:31:05 (Base Airtime - The total amount of television broadcast time coded for each channel)

Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 2 - paraqet formatet e programeve të përdorura në komunikimin politik. Shumica e kanaleve televizive përdorën programe editoriale (ED) që përfshin programe me biseda dhe intervista me aktorë politikë. Debatet politike përfshinin programe të organizuara me më shumë se një parti politike. Vetëm transmetuesi publik ka bërë edukimin e votuesve me materiale të prodhuara nga KQZ.

Share of political and electoral coverage by format

11 January till 9 February 18:00 - 24:00




Base Airtime: ATV 53:41:08, Dukagjini 99:43:39, KLAN KOSOVA 89:21:29, RTK1 55:10:55, T7 73:31:05 (Base Airtime - The total amount of television broadcast time coded for each channel)

Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 3 - paraqet shpërndarjen proporcionale të kohës së transmetimit në të gjitha programet ndërmjet të gjithë kandidatëve gjatë fushatës.

Share of airtime allocated to all candidates

11 January till 9 February 18:00 - 24:00




Base Airtime: ATV 46:31:07, Dukagjini 80:07:46, KLAN KOSOVA 80:32:48, RTK1 40:53:53, T7 61:42:17 (Base Airtime - The total amount of television broadcast time allocated to each individual candidate on each channel)

Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 4 - paraqet pjesën e kohës së transmetimit të ndarë për partitë kryesore politike shqiptare, partitë e tjera politike shqiptare dhe partitë e komuniteteve joshumicë; si partitë serbe, turke, egjiptiane, rome, ashkali dhe gorane në të gjitha programet.

Share of airtime allocated to all parties

11 January till 9 February 18:00 - 24:00



Base Airtime: ATV 48:13:00, Dukagjini 96:35:45, KLAN KOSOVA 85:27:03, RTK1 46:41:00, T7 71:59:04 (Base Airtime - The total amount of television broadcast time allocated to each political party on each channel)


Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 5 - paraqet tonin e mbulimit mediatik të ndarë për kandidatët më të përfaqësuar në programet e transmetuara në orarin e shikueshmërisë më të madhe.

Tone of coverage

11 January till 9 February 18:00 - 24:00

■ Negative ■ Neutral ■ Positive




Base Airtime: Albin Kurti 37:20:08, Bedri Hamza 25:38:31, Lumir Abdixhiku 24:07:40, Ramush Haradinaj 18:10:27, Fatmir Limaj 07:30:17, Memli Krasniqi 06:39:14, Enver Hoxhaj 05:41:11, Lutfi Haziri 05:14:38 (Base Airtime - The total amount of television broadcast time allocated to most featured candidates within prime-time programming on each channel)

Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 6 - paraqet shpërndarjen proporcionale të kohës së transmetimit në lajme ndërmjet aktorëve kryesorë politikë. Këtu përfshihen partitë kryesore politike, Presidentja, Kryeministri dhe ministrat e qeverisë. Partitë e tjera politike u paraqitën në më pak se dy për qind të kohës së transmetimit në mbulimin e lajmeve.

Share of the news coverage by political actors

11 January till 9 February 18:00 - 24:00




Base Airtime: ATV 08:05:24, Dukagjini 03:05:10, KLAN KOSOVA 16:36:28, RTK1 12:09:18, T7 02:46:22 (Base Airtime - The total amount of NEWS broadcast time allocated to the most featured political actors on each channel)

Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 7 - paraqet pjesën e mbulimit me lajme për presidenten dhe kandidatët ashtu siç u paraqitën në lajmet në kohën kryesore.

Share of the news coverage by president and candidates

11 January till 9 February 18:00 - 24:00




Base Airtime: ATV 04:52:44, Dukagjini 02:18:52, KLAN KOSOVA 10:15:11, RTK1 09:09:03, T7 02:00:38 (Base Airtime - The total amount of NEWS broadcast time allocated to the most featured individual political actors on each channel)

Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 8 - detajon të folurit e drejtpërdrejtë të kandidatëve gjatë edicioneve të lajmeve në kanalet televizive. Vetëm RTK1 ndau më shumë se gjysmën e mbulimit të saj në lajmeve për citime direkte të aktorëve të ndryshëm politikë, ndërsa komentet gazetareske dominonin lajmet në kanalet televizive private.

Share of direct speech of the actors in the news coverage

11 January till 9 February 18:00 - 24:00



Base Airtime: ATV 08:32:51, Dukagjini 03:21:25, KLAN KOSOVA 17:14:12, RTK1 12:37:49, T7 03:02:21 (Base Airtime: The total amount of NEWS broadcast time on each channel)


Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 9 - Në tri kanale televizive u organizuan debate politike ku morën pjesë disa parti ose përfaqësues partish. Grafiku i mëposhtëm tregon shpërndarjen proporcionale të kohës së ndarë për aktorë të ndryshëm politikë, të cilët ose morën pjesë në debate, ose u përmendën gjatë debatit.

Political debates

11 January till 9 February 18:00 - 24:00

AAK-NISMA FJALA GOVERNMENT Guxo Koalicioni për Familje LDK LVV PDK
PRIME MINISTER



Base Airtime: ATV 14:11:53, KLAN KOSOVA 1:20:45, RTK1 9:13:53 (Base Airtime - The total amount POLITICAL DEBATE broadcast time allocated to political actors on each channel)


Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 10 - tregon kohën e përgjithshme të transmetimit të ndarë për gratë politike në të gjitha stacionet televizive të monitoruara në transmetimet në orarin kryesor gjatë fushatës.

Actors coverage by gender

11 January till 9 February 18:00 - 24:00

Male Female



Airtime Base: 316:00:10, Direct Speech Base: 228:06:37 (Base Airtime - The total amount of television broadcast time allocated to individual political actors)


Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 11 - ilustron kohën totale të transmetimit të ndarë për femrat dhe meshkujt në secilin kanal televiziv.

Actors coverage by gender

11 January till 9 February 18:00 - 24:00

Female Male



Base Airtime: ATV 48:03:56, Dukagjini 81:13:16, KLAN KOSOVA 81:26:19, RTK1 42:13:52, T7 63:02:47 (Base Airtime - The total amount of broadcast time allocated to individual political actors on each channel)


Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 12 - paraqet shpërndarjen e kohës së transmetimit me pagesë sipas partive politike. Koha e transmetimit me pagesë përfshin reklama politike, video të shkurtra dhe segmente të shkurtra transmetimi me pagesë për mbulim të fushatës.

Paid airtime

11 January till 9 February 18:00 - 24:00

PDK LDK AAK-NISMA Koalicioni për Familje LVV



Base Airtime: ATV 00:16:04, Dukagjini 06:58:37, KLAN KOSOVA 04:50:18, RTK1 00:22:18, T7 07:57:42 (Base Airtime - The total amount of PAID AIRTIME broadcast time allocated to political actors on each channel)


Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 13 - paraqet shpërndarjen e kohës së transmetimit me pagesë për kandidatët meshkuj dhe femra, si dhe për partitë politike (të referuara si Kolektiv) në të gjitha programet.

Paid airtime by gender

11 January till 9 February 18:00 - 24:00

Collective Female Male



Base Airtime: ATV 00:16:04, Dukagjini 06:58:37, KLAN KOSOVA 04:50:18, RTK1 00:22:18, T7 07:57:42 (Base Airtime - The total amount of PAID AIRTIME broadcast time allocated to political actors on each channel)


Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

Grafiku 14 - paraqet shpërndarjen e programeve të sponsorizuara në pesë kanalet televizive, përfshirë mbulimin e tubimeve dhe ngjarjeve të tjera të fushatës.

Sponsored programme

11 January till 9 February 18:00 - 24:00

PDK LVV LDK AAK-NISMA



Base Airtime: ATV 02:13:00, Dukagjini 13:05:20, KLAN KOSOVA 02:16:18, RTK1 03:08:25, T7 03:49:02 (Base Airtime - The total amount of SPONSORED programme broadcast time allocated to political actors on each channel)

Chart: EU EOM Kosovo 2025 • Created with Datawrapper

XXIV. ANEKSI 3 – REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE SOCIALE

EU EOM në Kosovë 2025 përdori qasje dhe teknika të ndryshme dhe plotësuese për të analizuar platformat online dhe për të mbledhur informacione mbi përmbajtjen në internet lidhur me zgjedhjet.⁹⁸ Këto metoda përfshijnë analizën sasiore dhe cilësore të të dhënave, analizën ligjore, takimet me palët përkatëse të interesit dhe bashkëpunimin me anëtarë të ndryshëm të CT dhe LTO.

EU EOM analizoi një grup indikativ llogarish, profilesh, grupesh, faqesh dhe temash me rëndësi mbarëkombëtare, për të parë tendencat kryesore të fushatës në platformat e monitoruara.

Mostra u zgjodh duke marrë parasysh:

- Rëndësinë (matjet e ndërveprimeve në Facebook dhe Instagram, komunikimi në X dhe shikimet në TikTok) dhe ndikimi i mundshëm e faqes/grupit në agjendën dhe diskursin politik (bazuar në vlerësimin cilësor)

⁹⁸ Rrjetet e mesazheve, si WhatsApp, Telegram, Viber ose Messenger nuk përfshihen në fushën e metodologjisë së EU EOM-së për shkak të mbrojtjes së të dhënave dhe çështjeve të privatësisë. Megjithatë, EOM-të mund të përfshijnë informacione përkatëse që vijnë nga organizata të besueshme kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara në monitorimin e platformave dhe rrjeteve online.

- Përmbajtja e faqes (nëse temat e mbuluara nga postimet kishin të bëjnë me çështje sociale, politike dhe elektorale)
- Përkatësia politike e llogarisë, faqes ose grupit

Veglat e përdorura për monitorim dhe mbledhje të të dhënave nga mediat sociale ishin:


- Gerulata – monitorimi i mediave sociale dhe nxjerrja e të dhënave
- Python, Excel – nxjerrja dhe përpunimi i të dhënave
- Meta Ad Library – përcjellja e reklamave politike në Facebook dhe Instagram
- DataWrapper – vizualizimi i të dhënave

EU EOM identifikoi dhe përfshiu në databazën e saj listën e mëposhtme të faqeve të mediave sociale:

	Facebook	Instagram	TikTok	X
Partitë politike	33	16	8	13
Kandidatët	132	384	135	0
Kandidatët për kryeministër	4	4	1	4
Mbështetësit	6	4	23	0
Ndikuesit	3	0	6	15
Mediat	39	5	25	13
OJQ-të	0	11	1	9
Institucionet	14	0	0	4
GJITHSEJ	230	424	198	58

Tabela 1. Llogaritë e monitoruara në mediat sociale

Njësia e Monitorimit të Mediave Sociale përcolli gjithsej 910 faqe në media sociale që u përkisnin partive politike, kandidatëve, mbështetësve, OJQ-ve, mediave dhe institucioneve. Është analizuar përmbajtja e disa postimeve të përzgjedhura, bazuar në viralitetin e tyre (numri i përgjithshëm i ndërveprimeve që kishin). Monitorimi mbuloi të gjithë periudhën e fushatës (prej 11 janarit deri më 8 shkurt) në tri platformat kryesore të mediave sociale të popullarizuara në Kosovë, Facebook, Instagram dhe TikTok. Për më tepër, EU EOM përdori Meta Ad Library për të analizuar reklamën në Facebook dhe Instagram nga garuesit dhe palët e treta.



Grafiku 2. Numri i përgjithshëm i postimeve dhe postimeve të analizuarra për partitë, kandidatët dhe mbështetësit gjatë periudhës së fushatës (gjithsej 5,262 postime të analizuarra)


Kriteret e përzgjedhjes së postimeve të analizuarra:

- Pesë postimet kryesore për nga aspekti i viralitetit për çdo konkurrent politik në Facebook, Instagram dhe TikTok (ditore)
- Pesë postimet më virale për secilin kandidat për kryeministër në të gjitha platformat (çdo ditë)

- 40 postimet kryesore (maksimumi dy postime për kandidat) për pjesën tjetër të kandidatëve shqiptarë dhe 10 postimet kryesore (maksimumi dy postime për kandidat) nga kandidatët joshumicë (çdo ditë)
- 15 postimet kryesore nga faqet e mbështetësve (çdo ditë)

Ambienti në rrjete sociale


Sipas regjistrimit të vitit 2024, Kosova ka një popullsi rezidente prej 1,602,515 banorësh dhe një shkallë të lartë të penetrimit të internetit, e vlerësuar në mbi 95 për qind. Ndërsa qasja në internet në përgjithësi nuk është problem, ndërprerjet e herëpashershme të energjisë gjatë dimrit dhe mbingarkesa e rrjetit mobil mund të ndikojnë në disponueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të internetit.




Grafiku 3. Përdoruesit e mediave sociale në Kosovë

Gjetjet e Njesisë së EU EOM-së për Monitorim të Mediave Sociale

Të gjitha subjektet politike garuese dhe mbi gjysma e kandidatëve kishin të paktën nga një llogari në media sociale dhe bënë fushatë në mediat sociale me intensitet të ndryshëm. Facebook-u ishte platforma më e përdorur, e pasuar nga Instagrami dhe TikTok-u. LVV, AAK dhe LDK i paraqitën liderët e tyre si “kandidatë për kryeministër”, ndërsa PDK-ja për kryeministër kishte Bedri Hamzën, kryetarin e Mitrovicës Jugore. Përveç PDK-së, tre kandidatët e tjerë për kryeministër kishin më shumë ndjekës në rrjetet sociale sesa partitë e tyre.




Grafiku 4. Llogaritë kryesore të partive politike të monitoruara sipas platformave




Grafiku 5. Numri i postimeve dhe ndërveprimeve në llogaritë e kandidatëve për KM

Shumica e postimeve ishin video ose foto, zakonisht nga ngjarjet e fushatës dhe me shumë pak tekst të shkruar. Kjo solli në internet gjuhën e ashpër të fushatës, e cila edhe pse jo sistematike, ishte e pranishme gjatë gjithë fushatës. PZAP ka sanksionuar raste të shumta të gjuhës që ishte në shkelje të Kodit të Sjelljes për Subjektet Politike, por kjo nuk duket të ketë sjellë ndonjë ndryshim.




Grafiku 6. Lloji i postimeve të analizuara

Dy javët e para të fushatës online ishin relativisht të qeta dhe u mungonte përmbajtja, me më pak se 10 për qind të postimeve që promovonin idetë e manifesteve zgjedhore të partive. Kah gjysma e fushatës, partitë politike publikuan programet e tyre dhe filluan t'i promovonin ato. Me rritjen e intensitetit të fushatës në mediat sociale në dy javët e fundit të fushatës, u rrit edhe mbizotërimi relativ i gjuhës nxitëse dhe sulmeve politike, këto të fundit veçanërisht në mesin e partive politike serbe. Një vendim i KQZ-së për përbërjen e këshillave të vendotimeve në komunat me shumicë serbe u prezantua nga disa parti politike serbe ose si përpjekje për të zvogëluar përfaqësimin e komunitetit serb ose si përpjekje për të favorizuar një parti serbe që bashkëpunon me Qeverinë. Megjithatë, këto lloj postimesh nuk u vërejtën në mënyrë sistematike dhe përfaqësojnë 6.54 për qind të postimeve të monitoruara.




Grafiku 7. Mbizotërimi i gjuhës nxitëse, sulmeve politike dhe akuzave për KQZ-në gjatë fushatës zgjedhore



Grafiku 8. Temat e postimeve të analizuara sipas javës

Reklamat në Facebook dhe Instagram u përdorën gjerësisht nga 12 partitë politike, nga mbi 400 kandidatë dhe nga disa faqe të mbështetësve dhe mediave. Mbi €250,000 u shpenzuan për promovimin e më shumë se 7,000 reklamave lidhur me zgjedhjet në Facebook dhe Instagram,

duke përfshirë reklamat negative⁹⁹ nga palët e treta.¹⁰⁰ Pesë parti dominuan me shpenzimet për reklama në media sociale, duke përbërë 97 për qind të shumës totale të shpenzuar. Opre Roma Kosova, shpenzuesi më i madh individual me 20,358 €, ka marrë vetëm 370 vota.









Grafiku 9. Shpenzimi për reklama të partive politike dhe kandidatëve

Reklamat politike nga kandidatës u drejtoheshin në mënyrë disproporcionale meshkujve të moshës 25-54 vjeç. Me përjashtim të reklamave u drejtoheshin votuesve të rinj (18-14 vjeç), të cilët kishin një fokusim më të balancuar gjinor, mbi dy të tretat e përshtypjeve të reklamave u drejtoheshin meshkujve, duke sugjeruar që garuesit i perceptojnë votuesit meshkuj si më të prirë për të votuar ose për të pasur ndikim mbi votat e anëtarëve të tjerë të familjes.

⁹⁹ Reklamat negative përfaqësojnë reklama që synojnë të ulin mbështetjen e një partie ose kandidati, përmes mjeteve të ndryshme, si p.sh., komentet sarkastike mbi nivelin e mbështetjes që gëzojnë kandidatët dhe njerëzit me të cilët ata shoqërohen, duke i paraqitur ata në kontekste negative ose me tekst të pakëndshëm.

¹⁰⁰ Reklamat e palëve të treta përfaqësojnë reklama pro ose kundër një partie ose kandidati që shfaqen nga faqe që nuk janë faqe zyrtare të asaj partie ose kandidati.

Ad impressions by age group and gender




Created with Datawrapper

Rreth 10 për qind e reklamave (693) ishin reklama të palëve të treta që ose promovonin ose sulmonin partitë politike dhe kandidatët e tyre. Rreth 60 faqe të mediave dhe të mbështetësve shfaqën reklama të palëve të treta, jo gjithmonë sipas linjave partiake. Faqet e mediave si GazetaBlic, Jepi Zë, Mitropol, Plus Televizion dhe Veriu.info publikuan reklama për promovimin e kandidatëve nga parti të ndryshme, në atë që duket të jetë më shumë si një shërbim promovimi e jo si manifestim i përkatësisë politike.

Targets of political ads by third parties

Number of third-party ads promoting or attacking the political party or their candidates.



Created with Datawrapper

Grafiku 10. Reklamat e palëve të treta sipas llojit dhe synimit

◀ Grafiku 11. Ndarja e përshtypjeve të reklamave sipas grupmohës dhe gjinisë

